

Mustafa Mahmud

DIALOGU

ME

MIKUN

ATEIST

Logos-A

Dr. MUSTAFA MAHMUD

DIALOGU ME MIKUN ATEIST

Logos-A
Shkup 1996/1416

Titulli në boshnjakishte:

Dijalog sa prijateljem

Përkthyes:

Nexhat Ibrahim, Miftar Ajdini, Muhidin Ahmeti

Redaktor gjuhësor - korrektor:

Fatmire Ajdini - Hoxha

Redaktor teknik:

Urim Poshka

Përgatitja kompjuterike dhe shtypi:

Focus – Shkup

Copyright© by Logos-A 1996

CIP - Katalogizacija vo publikacija Narodna i univerzitetska biblioteka "Kliment Ohridski" – Skopje. 297:211. MAHMUD, Mustafa. Dialogu me mikun ateist / Mustafa Mahmud ; [përkthyen nga boshnjakishtja Nexhat Ibrahim, Miftar Ajdini, Muhidin Ahmeti]. - [botimi 2.]. - Shkup : Logos-A, 1996. - 140 str. ; 20 sm. - (Biblioteka Mendimi islam)

Prevedeno spored: Hivarun me'a Sadiki el-Mulhid. - Bibliografija: str.135-136.

ISBN 9989-601-28-3

PARATHËNIE

PERSONALITETI DHE VEPRA E DR. MUSTAFA MAHMUDIT

Dr. Mustafa Mahmudi u lind në vitin 1921 në Egjipt. Shkollimin fillor dhe të mesëm e kreu në Tantë, kurse shkollimin universitar e mori në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Kajros. I specializoi sëmundjet e mushkërive, duke u bërë njëri ndër ekspertët më të njohur për këtë lloj sëmundjeje në Egjipt. Mirëpo, dëshira për afirmim letrar ishte më e fuqishme, prandaj e lëshoi mjekësinë dhe iu përkushtua studimit letrar, filozofik, sufistik dhe ideor.

Së pari u mor me letërsi; botoi disa vepra të rëndësishme dhe të dalluara letrare, të argumentuara me përsiatje filozofike, kurse të krijuara menjëherë pas rev olucionit në Egjipt në vitin 1952. Botoi edhe disa tregime të shkurta, prej të cilave posaçërisht janë të dalluara: Ushqimi dhe jeta (1953), Zoti dhe njeriu (1955), Apartamenti 7 (1955 dhe 1957), Një grup njerëzish (1962), Era e gjakut (1965) etj. Më vonë botoi disa studime mjaft të rëndësishme, siç janë: Ibli si (1957), Enigma e vdekjes (1958), Enigma e jetës (1967), Bijtë (1961), Ajnshtajni dhe relativiteti (1961) e të tjera. Ai shkroi edhe artikuj me rëndësi të jashtëzakonshme ndër të cilët dallohen: Mbi dashurinë dhe jetën, të cilët janë botuar ndërmjet viteve 1951 - 1955, pastaj Ditari i pasmesnatës i cili u botua në po të njëjtën periudhë, etj. Romanet të cilat i shkruante e pushtnin publikun dhe nxitnin kritikët e mëdhenj. Veçmas janë të dalluara këto romane të tij: E pamundshme (1960), Opiumi (1964), Merimanga (nga fillimi i vitit 1965), Dalja prej tabutit (nga fundi i 1965), Njeriu nën zero (1966). Shkroi edhe pjesë teatrale: Leka i Madh (në verë të vitit 1963), Tronditja (në verë të vitit 1963), Njeriu dhe hija (1964), Goma (dimër 1968), Djalli banon në shtëpinë tonë (1973). Pastaj u botuan disa udhëpërshkrime të rëndësishme të tij: Pylli virgjër

(1963), Shpella në shkretëtirë (1969), Qyteti ose Rrëfimi i udhëtarit (është përmbledhje vëzhgimesh për udhëtimet e tij ndërmjet viteve 1966 dhe 1968). Vepra me titull Ma kanë pranuar në të vërtetë është përmbledhje letrash të zgjedhura të cilat lexuesit ia kanë dërguar në periudhën ndërmjet viteve 1956 - 1959. Zgjedhja prej letrave të lexuesve ndërmjet vitit 1956 dhe 1966 botohet me titullin Problemet e dashurisë. Pastaj u shkruan Pranimet e të dashuruarve (1966) dhe Rruga deri në Qabe (1971). Mustafa Mahmudi botoi edhe disa studime mjaft të rëndësishme të cilat nxitën polemika jashtëzakonisht të mëdha dhe të ashpra. Prej tyre veçanërisht janë të njohura: Kur'ani - tentativë për të kuptuarit bashkëkohor (1969) (në përgatitje edhe në gjuhën shqipe), Peripecitë e mia prej dyshimit deri në besim (1970) (në gjuhën shqipe i botuar në Prishtinë më 1987 dhe i ribotuar në Shkup më 1994 e 1996), Allahu (1972), Djalli sundon (1970), Tevrati (1972), E kam parë Zotin (1973), Shpirti dhe trupi (1973), Dialogu me mikun ateist (1974), Marksizmi dhe Islami (1975), Muhammedi a.s. (1975) e të tjera. Mustafa Mahmudi aktivitetin e tij të gjithanshëm e vazhdoi edhe pas vitit 1975. (Ndonëse nuk kemi ndonjë pasqyrë të saktë të veprave të tij, brenda kësaj dekade ka botuar disa dhe tëra vepra me tematikë religjioze dhe ka incizuar mbi 50 diafilma. N.I.).

Duke e dhënë këtë pasqyrë të shkurtër të veprave të publikuara të Mustafa Mahmudit, kemi pasur për qëllim që lexuesit tanë t'i njoftojmë me këtë shkrimtar, shkencëtar dhe mendimtar bashkëkohor arab me erudicion jashtëzakonisht të madh, rruga jetësore e të cilit është mjaft interesante, që përndryshe më së miri mund të shihet prej zhvillimit ideor të cilin ai e ka kaluar.

ZHVILLIMI IDEOR I DR. MUSTAFA MAHMUDIT

Vështirë është që në një vështrim të këtillë të shkurtër të thuhet tërë ajo që do të duhej të thuhet për zhvillimin ideor të Mustafa Mahmudit. Megjithatë do të përpiqemi t'i shkoqisim së paku tendencat kryesore të këtij zhvillimi, duke i reduktuar këto në katër:

- a) Prej muzikës deri në mjekësi,
- b) Prej aventurës deri në izolim,
- c) Prej dyshimit deri në besim,
- ç) Prej letërsisë deri në filozofi.

Këtu, së paku shkurtimisht, do të përpiqemi të bëjmë fjalë për ka- tër periudhat e zhvillimit, në mënyrë që lexuesit tanë sadopak të njihen me këtë personalitet mjaft interesant të botës bashkëkohore islame.

- a) Prej muzikës deri në mjekësi

Qysh në shkollën fillore, pastaj në të mesmen, Mustafa Mahmudini e tërhiqte muzika. Duke e lexuar dhe dëgjuar Kur'anin frymëzohej me muzikalitetin dhe bukurinë e tij. Kjo e shtyri që një ditë të blejë kitarën dhe të fillojë të mësojë lojën me veglat muzikore. Kitara shpejt iu bë pasion. Nga ana tjetër, prindërit e tij njëmend dëshironin që të birin ta shohin në El Ez'herin e njohur, e pastaj me xhybe dhe ahmedi. Mirëpo, muzikanti i ri i theu të gjitha shpresat e tyre atë ditë kur maturoi dhe shkoi të regjistrohet në fakultet. Pas kthimit prej Kajros, i lajmëroi prindërit se është regjistruar në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Kajros, duke ua bërë me dije se ky vendim i tij është përfundimtar. Ja kështu, Mustafa Mahmudi në një mëngjes shtatori u paraqit në Fakultetin e Mjekësisë në të cilin më vonë diplomoi dhe specializoi.

Askush nuk e dinte se pikërisht studimi i mjekësisë aq fuqishëm do të ndikojë në Mustafa Mahmudin i cili qysh në shkollë të mesme tregonte interesim të madh për ateizmin. Ditë e natë lexonte, shkruante dhe diskutonte. Profesorët e këshillonin që ta lërë mjekësinë dhe t'i kushtohet letërsisë. Të tjerët ia preferonin drejtësinë, derisa të tretët i sugjeronin ta studiojë filozofinë. Duket se vetëm ai e dinte se cila është rruga e tij. Së shpejti u bind se pikërisht mjekësia ia ofronte atë që e dëshironte. Profesorët shpeshherë e gjenin duke qëndruar pranë ndonjë kufome mbi të cilën është bërë autopsia, duke i ndarë dhe analizuar pjesët e saj dhe duke kërkuar përgjigje në pyetjet të cilat shpesh as vetë profesorët nuk i dinin e ndoshta as nuk i kërkonin. Në këtë periudhë Mustafa Mahmudi shkroi disa vepra të cilat paraqesin fillimin e kthesës në jetën e tij, sikur që janë veprat: Enigma e vdekjes, Merimanga e disa të tjera. Kjo për një kohë do ta shpjerë në filozofinë indiane, ku në idenë e inkarnimit do të orvatet të gjejë përgjigje në disa pyetje të cilat e preokuponin. Mjekësisë përsëri i kthehet, duke ia kushtuar tërë qenien e vet. Duke iu falënderuar kësaj, për një kohë relativisht të shkurtër filloi të dominojë në qarqet e mjekësisë në Egjipt, që te shumica nxiti xhelozitë e te disa madje edhe kundërshtim të hapët. Nderi të cilin e gëzonte në vend dhe jashtë vendit, i mundësoi atij udhëtime mjaft të shpeshta në shumë vende të Evropës, Azisë dhe Afrikës.

b) Prej aventurës deri në izolim

Shpirti i shqetësuar dhe të ardhurat e mira e nxisnin në aventura. Disa herë shkoi në Evropë, duke u orvatur të gjejë qetësi në të dhe në qarqet e saja shkencore. Lexon çdo gjë që i vjen në duar, zhvillon diskutime me dijetarët dhe shoqërohet me mendimtarët duke shpresuar se ata do t'i ofrojnë atë që e kërkon dhe për çka hulumton. Mirëpo, mbetet i dëshpëruar pas takimit me ta. Pasqyra të cilën para kësaj e kishte për Evropën filloi papritmas të zbehet e humbet. I pasur në të gjitha dhe egoist sipas natyrës,

detyrohet që më thellë të zhytet në shpirtin e njeriut evropian, veçantia parësore e të cilit është centrizmi ekskluziv. Kjo i hap atij horizonte të reja të cilat do ta shpiejnë në Azi, pastaj në Afrikë, midis një rëzve, ligjeve, shkretëtirës, xhunglës dhe fiseve të tyre. Altruizmi islam në të, gjatë këtyre udhëtimeve do të zhvillojë njohuri madhështore të filantropisë, dashurisë dhe humanizmit. Kudo do të gjurmojë për burimet origjinale të dashurisë ndaj Finitit, Absolutit dhe Burimorit. Për këtë në veprat e tij edhe takohemi me udhëkryqet e të gjitha meridianeve të botës. Pena e tij gazetareske sado që është ekskluzive aq është edhe studioze. Në udhëpërshkrimet, artikujt, veprat dhe punimet e tjera të krijuara në atë periudhë hasim në laramani të pasur të jetës të mbushur me doke, kontraste, tradita, martesë, lindje, varrime dhe me dervishë të të gjitha tarikateve, kombeve dhe sjelljeve. Mustafa Mahmudi tek ato na shpie nëpërmjet të gjitha rrugëve të jetës, pikëllimit, gëzimit, varfërisë, pasurisë, shfrenueshmërisë, tërheqshmërisë dhe shumëngjyrësisë.

Thënë shkurt, pikërisht këtu takohemi me jetën ashtu siç është: e plotë dhe e zbrazët njëkohësisht, jetën e cila e përjetëson aromën, të qajturit dhe të qeshurit e saj. Mustafa Mahmudi arrinë të na e prezentojë këtë me fjalë sikurse artisti që e bën këtë me ngjyra. Në veprat e tij gjejmë mjaft frymë romantike, pasuri realiste dhe shumë këndim simbolik. Këtu Mustafa Mahmudi bën një hap më tej në letërsinë bashkëkohore arabe e cila shquhet me llojllojshmëri, pasuri, ide, ballafaqim, guxim, hieshi, angazhim, humanizëm dhe tradicionalitet.

Pikërisht kjo përvojë e pasur dhe e llojllojshme do t'i konfirmojë Mustafa Mahmudit se jeta dhe vdekja së bashku me materien dhe shpirtin me të vërtetë paraqesin sekretin e Sekretit, dhe se njeriut, sado që të dijë, të posedojë dhe çkado qoftë, megjithatë pak i është dhënë. Ky mësim do të jetë shkak që edhe ai vetë të gjendet në meridianet, binarët dhe hulumtimet e reja ideore, ku të gjitha së

bashku do ta shpiejnë atë në përsiatje të re, në vetmi dhe izolim.

c) Prej dyshimit deri në besim

Mund të pritej që dr. Mustafa Mahmudi në këtë rrëke llojlojshmërisht dhe kundërthëniesh ta humbë veten. Mirëpo, një shikim rreth vetes, në vete dhe jashtë vetes e detyroi që t'i përcaktojë relacionet e veta jetësore të cilat shpiejnë nëpër të gjitha skilat dhe haribdet, mosbesimet dhe besimet, mëkatet dhe pendimet, shfrenimet ideore dhe përcaktimet shpirtërore, dallimet kreative dhe stabiliteti logjik. Dhe kjo rrugë do të jetë rikthyes në tërë jetën e tij. Në tërë këtë ai do ta gjejë vetveten dhe qenien e tij. Kështu do të fillojë faza e re e jetës së tij e cila e tëra do t'i përkushtohet shpirtit, besimit, njeriut dhe ngritjes së tij. E tërë kjo ka ardhur pas leximit, studimit dhe përimtësimit edhe të vetvetes edhe të të tjerëve. Fryt i gjithë kësaj do të jetë vepra e tij me rëndësi Peripecitë e mia prej dyshimit deri në besim të cilën lexuesit tanë kanë mundësi ta lexojnë si botim të veçantë. Është interesant të theksohet se para do kohe kjo vepër u botua edhe në gjuhën frëngjishte në përkthimin e orientalistit të njohur Moro Shartjes, të botuar në Bejrut.

Duke e marrë parasysh se lexuesit tanë, siç tanimë e theksuam, janë të njoftuar me këtë vepër, prandaj edhe nuk do të ndalemi te ajo. Do të theksojmë vetëm se ajo paraqet pasqyrën e zhvillimit shpirtëror të autorit po në atë përmasë në të cilën prezentohen disa vepra të Dekartit, Gazaliut, Spinozës e të tjerëve. Këtu është me rëndësi të theksohet se kjo periudhë e dr. Mustafa Mahmudit prezenton kthimin e tij të singertë, të njëmendtë Kur'anit, i cili krejtësisht do ta shpjerë në binarët, rrugën dhe relacionet e tij. Kjo edhe do të ndikojë që i tëri t'i përkushtohet studimit të njëmendtë të Kur'anit. Si rezultat i kësaj lindi vepra e tij Kur'ani - tentativë për të kuptuarit bashkëkohor, e cila shkaktoi dis- kutime të rrepta në mesin e studiuesve të Islamit, rezultat i së cilës ishte edhe vështrimi shkencor-kritik i kësaj vepre i kur'anologes dr.

Aishe Abdurrahman alias Bintu Shati. Në këtë vepër Mustafa Mahmudi u nis hapave të të observuarit konstruktiv kur'anor, duke i konfirmuar dimensionet e mu'xhizes së Kur'anit dhe predominimin e tij ndaj të gjitha llojeve të kufizimeve, duke i mishëruar në njëmendësinë absolute të cilën mundemi vazhdimisht ta hulumtojmë, por asnjëherë nuk mundemi plotësisht ta zbulojmë. Përveç tjerash, kjo do t'i ndihmojë t'u shmanget të gjitha tendencave tjera ndikuuese, duke u thelluar thellë në sferën e fesë, filozofisë dhe shkencës.

Për shkak të gjithë kësaj që e kemi ekspozuar, mund të themi se letërsia e tij pikërisht edhe e kapërceu rrugën e vet zhvilluese, e cila më në fund u gjet në punimet filozofike siç edhe do ta shohim këtë më vonë.

ç) Prej letërsisë deri në filozofi

Dr. Mustafa Mahmudi së pari konsideronte se nëpërmjet veprës letrare mund të thuhet çdo gjë. Për këtë edhe i përvishet fushës së letërsisë, e cila me të vërtetë edhe i solli famë dhe mirënjohje të madhe. Veprat e tij lexohen në të gjitha anët. Çdonjëra prej tyre gati është shitur. Për to shkruhet, shqyrtohet dhe mendohet. Kur shfaqet ndonjë pjesë e tij teatrale, atëherë nëpër sportele është një rrëmujë e madhe, sepse rinia universitare dëshiron ta shohë, ta ndiejë dhe ta dëgjojë. Besojmë se për këtë arsye vepra e tij letrare është e ngjeshur sa me sensualitetin e altruistit, aq edhe me penetrimin, subtilitetin e filozofit. Ai është letrar dhe filozof i dalluar. Stili i tij është tërheqës, i bukur dhe dinamik. Gjuha e tij është e pasur me figurativitet, simbolikë dhe ide. Dialogjet janë të logjikshme dhe proporcionale. Eskplotimi me mundësitë gjuhësore është shumë i pasur dhe i fuqishëm. Çdo gjë është në lëvizje, hov, zhvillim, ndryshim. Personazhet janë të gjalla, origjinale dhe të zhvillueshme, por edhe të thurura në tërësinë e konceptimit të krijimit të ri letrar i cili imponohet, ndikon, ndërrohet dhe krijon. Këtu mishërohen shpresat për një të nesërme

më të mirë, më humane dhe më të ndjeshme, sepse para së gjithash jemi njerëz. Në gjithë këtë njeriu mund ta shohë edhe mjerimin e vet por edhe shenjtërinë e vet, pavlerësinë dhe autoritetin. E para e shkatërron ndërsa e dyta e ndërron. Në vrapimin e vazhdueshëm për ndërrime dhe gjurmime ai, megjithatë, ka fuqi ta gjejë vetveten, qenien e vet dhe t'i mposhtë problemet të cilat edhe pse origjinale, megjithatë e transformojnë njeriun. Njeriu është i lirë vetëm atëherë kur ka mundësi të përcaktohet, të angazhohet dhe të prodhojë, sepse në tërë atë mishërohet edhe ideja e tij sikur edhe qenia e tij.

Ja, në tërë këtë cikël të ndodhur rreth tij dhe në vetë atë, njeriu, sipas mendimit të dr. Mustafa Mahmudit, është i vlefshëm aq sa vepron, sa është i lirë, sa beson dhe sa është i angazhuar.

Dhe në fund, dëshirojmë të theksojmë se dr. Mustafa Mahmudi është i preokupuar me problemet e njëjta me të cilat është i preokupuar edhe filozofi më i madh bashkëkohor islam, dr. Muhamed El Behij, edhe pse këtyre problemeve u hyjnë nga kënde të ndryshme dhe aspekte të llojlojshme. Neve na mbetet obligimi që të dy, sikur edhe mendimtarët tjerë islamo-arabë, t'i njoftojmë, prezentojmë dhe studiojmë.

Dr. Ahmed Smajllović

Përktheu: Nexhat Ibrahimi

“ALLAHU NUK KA LINDUR AS S’ËSHTË I LINDUR” (KUR’AN)

Miku im është shkolluar dhe ka doktoruar në Francë. Atje, duke u inkadruar në “Rrymën e jetës moderne”, është shoqëruar përveç të tjerëve edhe me hipikët, me ç’rast ka formuar botëkuptim të atillë për botën i cili çdo gjë mohon. Ai dëshiron të polemizojë me ne besimtarët, ndonëse na konsideron naivë, sepse zbulon se ne vetveten e përqeshim duke u mashtruar me iluzione për xhennetin dhe hyritë derisa ëmbëlsitë dhe bukuritë e kësaj bote na shmangen.

Me një rast, me shpoti, më tha:

Ju konfirmoni: Zoti ekziston, duke e mbështetur konfirmimin tuaj në parimin e “shkakësisë” (kausalitetit). Pohoni se: çdo gjë e ndërtuar ka ndërtuesin e vet, çdo gjë e krijuar, krijuesin e vet, çdo gjë ekzistuese, krijuesin e vet; pëlhura e dëshmon endësin, piktura piktorin, gravura gravuesin, kurse kozmosi, sipas kësaj logjike, është dëshmia më e mirë për ekzistimin e Zotit si krijues i tij. Ndërkaq, nëse e pranojmë gjendjen e këtyllë të gjërave, a thua nuk kemi të drejtë që sipas logjikës së njëjtë të shtrojmë pyetjen: kush e krijoi atë Krijues?! A nuk është kjo kurthë për argumentet tuaja?!

I themi atij: Pyetja jote është e gabueshme - në të nuk ka kurrfarë kurthe për pohimin tonë. Ti, së pari, e pranon Krijuesin e pastaj pyet kush e ka krijuar Atë, duke ia nënshtuar Krijuesin ligjeve të cilat dominojnë në botën e krijësave. Kjo sofistika jote i ngjan kukullave të cilat lëvizin me ndihmën e zemberekut - spirales. Po që se kundrohen në rrafshin e lëvizjes së tyre, pason se edhe njeriu, i cili i ka bërë, lëviz sipas parimit të zemberekut. Sikur, me ndonjë rast, të ishte e mundur t’u thuhet atyre se ai lëviz me vetveten, do të përgjigjeshin se kjo është e pamundur, sepse në botën e tyre çdo gjë lëviz me ndihmën e zemberekut. Kështu edhe

ti, i kufizuar dhe i zhytur në botën vetjake ku çdo gjë që ekziston, domosdo parashtron Krijuesin, nuk po arrin të kuptosh se Zoti ekziston vetvetiu.

Filozofi i njohur gjerman Emanuel Kanti në veprën e tij Kritika e mendjes së pastër ka zhvilluar idenë se me mendje nuk mund të përfshihet e verteta e pafund. Sipas natyrës së saj, mendja i arrinë vetëm partikularitë ndërsa është e paaftë të kuptojë të ekzistuarit absolut siç është ekzistimi i Zotit. Ne e kuptojmë Zotin me ndërgjegje (damîr) e jo me mendje (‘akl). Dëshira jonë për drejtësi është dëshmi e ekzistimit të së drejtës, sikur që është etja për ujë dëshmi për ekzistimin e ujit.

Aristoteli shumë më herët ka shtruar një varg të tërë shkaqesh duke thënë: karrigia është nga druri, druri nga trugu, trugu nga fara, kurse fara është nga mbjellësi, që në fund të tregojë se si numërimi i tillë i shkaqeve medoemos shpie tek shkaku i parë. Shkakun i cili nuk ka nevojë për shkak, lëvizësin i cili nuk ka nevojë për lëvizës, krijuesin i cili nuk ka nevojë për krijues, që i përgjigjet të kuptuarit tonë të Allahut xhel-le shanuhu.

Ibni Arebiu konsideron se në pyetjen kush e krijoi Krijuesin aspak nuk duhet përgjigjur. Zoti e dëshmon ekzistimin dhe është jorregjues me ekzistim të dëshmohet Zoti. Drita e dëshmon ditën e jo e kundërta...

Allahu nuk ka nevojë për dëshmi, sepse Ai çdo gjë e dëshmon. Ai vetvetiu është e vërtetë e qartë (el-hakku-l-wâdihi bi dhâtihî). Allahu shfaqet në ligjet, rendin, bukurinë dhe normat, në gje thin e drurit, pendën e palloit, krahun e fluturës, erën e trëndafilin, këngën e bilbilit, lidhshmërinë e yjeve, në simfoninë e kozmosit. Sikur të thonim se e tërë kjo është krijuar rastësisht, do t'i përngjanim njeriut i cili konsideron se me vetë hedhjen e shkronjave në ajër, prej tyre mund të krijohet vargu në të cilin do të gjenim një poezi të Shekspirin, do të thotë poezi pa poet.

Kur'ani na liron nga shkoqitjet e këtilla me një dëshmi mjaft të qartë dhe të saktë:

“Thuaj: Ai Allahu është Një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s’ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë”. (El-Ihlâs, 1-4).

* * *

Miku ynë na pyet me përçmim: E përse thoni se Zoti është Një? Pse mos të jenë disa zotëra me kompetencat e ndara ndërmjet vete?

I përgjigjemi me Kur'an dhe në pajtim me logjikën të cilën edhe vetë e pranon, me logjikën e shkencës: Krijuesi është Një, sepse i tërë kozmosi është i ndërtuar sipas një plani dhe nga një substancë. Nga hidrogjeni përbëhen njëzet e dy elemente të cilat në sistemin e Mendelievit kanë mënyrën e njëjtë të bashkimit dhe derdhjes së fuqisë atomike me të cilën yjet ndriçojnë. Tërë bota e gjallë është e përbërë nga përbërjet e karbonit. Me të djegur ai karbonizohet. Trajtat e tij më të larta, sikur që është bota shtazore, në dukje me dallime të mëdha, tregojnë se në një plan të caktuar të autopsisë bretkosa, lepuri, pëllumbi, krokodili, gjirafa dhe balena kanë arteriet, enët e gjakut, pjesët e zemrës dhe eshtrat e njëjta. Çdo asht këtu ka vendin e vet përkatës atje - krahu te pëllumbi është këmba e përparme tek bretkosat. Eshtrat janë të njëjta me ndryshim mjaft të vogël - në qafën e gjirafës, përkundër gjatësisë së saj, gjejmë shtatë unaza sikur edhe te qafa e iriqit. Sistemi nervor tek të gjithë është i njëjtë. Përbëhet nga truri, palca kurrizore dhe nervat. Sistemi i tretjes me barkun, zorrën dymbëdhjetëgjishtore, zorrën e vogël dhe të madhe, sistemi i shumëzimit me vezoret, anin (uterusin), kanalet e tyre, sistemi i urinës me veshkët, kanalën e urinës, fshikëza e urinës dhe më në fund, autopsia unike tek të gjithë është qeliza. Identik është edhe

përshkrimi i bimës, shtazës dhe njeriut: linden, marrin frymë, shumohen dhe vdesin.

Pse atëherë pas gjithë kësaj do të ishte i çuditshëm pohimi se Krijuesi është Një. Si kjo që I Përkryeri mos të jetë Një - të përkryerit janë të shumtë. Të Përkryerit nuk i nevojitet plotësim tek të tjerët.

Sikur të kishte shumë zota, ata do të ndaheshin: secili do të shkonte me atë që e ka krijuar dhe Toka do të zhdukej.

Allahu xhel-le shanuhu posedon dinjitetin më të lartë dhe gjithëfuqinë absolute, e këto attribute përjashtojnë çfarëdo bashkëpjesëmarrjeje.

* * *

Miku ynë filloi ta përqeshë të kuptuarit tonë të hyjnisë (rububijeh). Ai thotë: Është i çuditshëm ky Zot i cili përzihet në çdo hollësi madje edhe më të voglën: e përudhë bletën që vetes t'ia ndërtojë vendqëndrimin në male, as gjethi nuk bie, e që Ai mos ta dijë, nuk zhvillohen frytet nga sythet e veta, e që Ai mos t'i numërojë, nuk mbarset as që lind femra pa dijen e Tij, rrëshqitja e këmbës në gropë, rënia e mizave në ushqim, ndërprerja e lidhjes telefonike është me dijen e Tij. Nëse nuk ka shi, Ai nuk e ka dhënë, e nëse bie, Ai e dha. A nuk po e angazhoni ju Zotin tuaj me të kuptuarit e tillë madje edhe për hollësitë më të vogla?

Shtruarja e këtillë e pyetjeve nuk na lejon të kuptojmë se a mos për mikun tonë Zoti do të ishte më i denjë për hyjni kur vetveten do ta lironte nga të gjitha këto përgjegjësi dhe thjesht “t’ia kthejë shpinën” kozmosit të cilin e ka krijuar. A thua sipas të kuptuarit të tij do të meritonte respekt zoti i cili është pasiv dhe i pandërgjegjshëm, i cili nuk dëgjon, nuk sheh, nuk përgjigjet dhe nuk kujdeset për krijesat e tij dhe, më në fund, prej nga shtruesit të pyetjeve dituria që të gjykojë se cila gjë është e parëndësishme që

të mos meritojë angazhimin e Zotit, e cila është aq me rëndësi që këtë ta meritojë.

Rënia e insektit në gjellë për shtruesin e pyetjeve është e parëndësishme dhe e pavlerë, por a nuk e ka mbytur mushkaja Lekën e Madh dhe a thua rënia e insektit nuk do të thotë futje e mikrobeve në ushqim dhe helmim i armatës së njerëzve.

Hollësitë më të rëndomta mund të jenë vendimtare për ndodhitë më të mëdha, ndërsa gjërat më të rëndësishme shpesh humben pa zë dhe kurrfarë gjurme. Vetëm Njohësi i të gjithave e di vlerën e vërtetë dhe rëndësinë e çdo gjëje. A thua shtruesi i pyetjeve mund t'i përcaktojë kompetencat e Krijuesit dhe Sunduesit të çdo gjëje! O Zot, i lartësuar je dhe i pastër nga të kuptuarit e tillë!

I denjë për adhurim është vetëm Ai i cili me dijen e Tij e përshkon çdo gjë dhe të cilit nuk i shpëton as sendi më i madh e as më i vogël në qiell dhe në Tokë.

Përktheu: Nexhat Ibrahim

NËSE ALLAHU I KA CAKTUAR VEPRAT E MIA, PËRSE ATËHERË MË THËRRET NË PËRGJEGJËSI?!

Duke menduar se kësaj here s'kam rrugëdalje, miku me dashakeqësi tha:

Pohoni se Zoti e cakton çdo gjë madje edhe veprat tona. Nëse është ashtu, nëse Ai i ka caktuar edhe veprat e mia të këqija, përse atëherë më thërret në përgjegjësi për to? Mos më thuani, sipas traditës suaj, se unë kam të drejtë të zgjedh, sepse s'ka gë- njeshtë më të madhe se kjo. Ju pyes: A mos e kam zgjedhur unë lindjen, gjininë, lartësinë, ngjyrën, vendlindjen time? A lind Die lli dhe a perëndon Hëna sipas zgjedhjes sime? A vjen sipas zgjedhjes sime caktimi im; më befason vdekja dhe më ndodh tragjedia, dhe bëj krim. Përse Zoti më detyron të bëjë diçka, e pastaj për këtë shkak më dënon?! Nëse pohoni se jeni të lirë sepse përveç vullnetit të Zotit keni edhe vullnetin vetjak, a nuk po i përshkruani me këtë bashkëpjesëmarrje dhe reciprocitet të shumë vullneteve?! Përveç kësaj, ç'thoni për ligjet e mjedisit, kushtet dhe domosdoshmërinë për të cilat flasin materialistët historikë?!

I kënaqur me këto pyetje të shkrepura sikur të shtëna (arme), miku u qetësua, i bindur se me to përgjithmonë më ka varrosur. Krejtësisht i qetë ia fillova:

Ke rënë në disa gabime: Veprat tua i janë të njohura Zotit dhe të shkruara në Librin e Tij, por me këtë nuk të janë caktuar detyrimisht. Ato janë caktuar vetëm në dijen e Tij. Kjo caktueshmëri deri diku mund të krahasohet me këtë që vijon: Ti ke njohuri për veprat e birit tënd dhe në to ekziston mundësia që biri yt të bëjë kurvëri. Nëse ai këtë e bën, a mos e ke detyruar ti në këtë ose kjo vetëm është parashtruar dhe ka ndodhur që dituria jote ka qenë e saktë.

Sa u përket fjalëve tua për lirinë dhe mundësinë e zgjedhjes se kjo është vetëm gënjeshtër e kulluar dhe se kjo dëshmon këtë çka nuk e ke zgjedhur lindjen, gjininë, ngjyrën, vendlindjen tënde, se nuk mund të ndikosh në Diellin dhe Hënë; këto tregojnë gabimin tje tër të cilin e ke bërë. Gabimi është në atë që ti lirinë e kupton krejtësisht ndryshe nga ne besimtarët. Ti flet për lirinë absolute dhe po thua pse s'kam mundur veten ta krijoj të bardhë apo të zi, të gjatë apo të shkurtër dhe a është në mundësinë time ta bart Diellin nga vendi i tij apo ta ndalë në orbitën e tij.

Ne kësaj i përgjigjemi: Ti flet për lirinë absolute, lirinë e zotërimit të lirë me kozmosin që i përket vetëm Zotit. Për ne është e vërtetë e vetme: “Zoti yt krijon çka të dojë dhe zgjedh. S’është (e drejtë) e tyre të zgjedhin.” (El-Kasas, 68). Askush nuk ka të drejtë zgjedhjeje në çështjen e krijimit, sepse Zoti xhel- le shanuhu është Ai i cili krijon çka të dojë dhe zgjedh çka të dëshirojë. Zoti i lartmadhëruar nuk do të të ftojë në përgjegjësi për shkak të lartësisë tënde, as që do të të dënojë për shkak se nuk e ke ndalur Diellin në orbitën e tij. Por, fusha e pyetjeve është fushë e ngarkimeve. Ti në këtë fushë je i lirë dhe ata janë kufijtë për të cilët po flasim. Ti je i lirë t’i kultivosh pasionet tua, ta përmbash urrejtjen tënde, t’i kundërvihesh vetvetes, t’i largosh qëllimet e këqija, ndërsa t’i vazhdosh prirjet tua të mira. Ti mund të bëhesh bujar me vetveten dhe pasurinë. Mund të flasësh të vërtetën ose të gënjesh. Mund ta përmbash dorën tënde nga e ndaluara. Mund ta përmbash shikimin tënd nga trupi i të tjerëve. Mund ta përmbash gjuhën tënde nga sulmi, përgojimi dhe intrigat.

Në këtë fushë ne jemi të lirë, dhe vetëm për atë që është brenda saj do të pyetemi dhe do të jemi përgjegjës.

Fjala është për lirinë relative e jo absolute, lirinë e njeriut në planin e obligimeve. Kjo liri është e vërtetë, kurse atë tek ne e dëshmon ndjenja e lindur për të. Ne ndiejmë përgjegjësi, pendim për gabimin e bërë, ndërsa kënaqësi kur bëjmë punë të mirë. Ne në

çdo rast zgjedhim dhe krahasojmë disa alternativa. Madje edhe detyra e parë e arsyes sonë është përcaktimi dhe zgjedhja ndërmjet disa alternativave.

Ne krejtësisht qartë e dallojmë lëvizjen e dorës e cila dridhet nga ethet dhe të dorës e cila shkruan letër, dhe themi se lëvizja e parë është e caktuar, e detyruar, ndërsa lëvizja e dytë e zgjedhur, e lirë. Sikur të mos kemi vullnet të lirë, nuk do të mund as të bënim dallime.

Gjithashtu, këtë liri e dëshmon edhe ndjenja jonë e paaftësisë ta detyrojmë zemrën në diçka me çka ajo s'është e kënaqur. Femrën mundemi me detyrime dhe kërcënim ta shpiejmë në situatë të bëjë çka të dëshirojmë, por me kurrfarë mjetesh detyruese nuk mund ta detyrojmë që në të vërtetë të na dojë. Kjo qartë tregon se Allahu xhel-le shanuhu i ka çliruar zemrat tona nga nënshtrimi i çfarëdo detyrimi, duke i krijuar plotësisht të lira. Për këtë arsye Allahu xhel-le shanuhu e ka bërë qëllimin - nijetin, burim i të cilit është zemra, shtyllë e përgjegjësisë. Besimtari i cili nën presion e blasfemon fenë nuk do t'i përgjigjet Zotit deri atëherë kur me zemër të bëjë blasfemi:

“... Përveç nëse në këtë është i detyruar, kurse zemra e tij është e bindur thellë në besim...” (En-Nahl, 106).

Pikëpamja tjetër e gabueshme e kësaj qëndron në atë që disa njerëz kuptojnë se liria e njeriut është mbi vullnetin e Zotit, dhe duke i akuzuar rekomanduesit e lirisë së Zotit i përshkruajnë bashkëpjesëtarë në urdhërdhënie dhe vendim. Kështu edhe ti, o mik, e ke kuptuar dhe ke folur për vullnetin e shumënumërt, që është, pa dyshim, botëkuptim i gabueshëm. Liria e njeriut nuk ngrihet mbi vullnetin e Zotit. Njeriu është i lirë të bëjë diç që i kundërvihet kënaqësisë së Zotit, por ai nuk mund të bëjë asgjë që i kundërvihet vullnetit të Zotit.

Zoti xhel-le shanuhu na ka dhënë liri që t'i kundërvihemi kënaqë- sisë së Tij në dëmin tonë, por askujt s'i ka dhënë liri që t'i kun- dërvihet vullnetit të Tij. Këtu është ana tjetër e lirisë relative të njeriut. Çdo gjë që ne veprojmë është në kuadër të vullnetit të Zotit, madje edhe atë që e veprojmë e që nuk është në pajtim me kënaqësinë e Zotit dhe me Sheriatin.

Liria jonë është begati nga Zoti dhe shpërblim të cilin Krijuesi na ka dhuruar krejtësisht, pavarësisht nga vullneti jonë. Liria jonë është vetëm vullneti i Tij.

“Dhe ju nuk doni tjetër përveçse çka do Allahu.” (El-Insân, 30). Të flasish për lirinë në këtë kuptim, nuk do të thotë t'i shoqërosh Zotit shok. Liria jonë është e njëjtë me urdhëresat e Tij, vullnetin e Tij dhe caktimet e Tij.

Pikëpamja e tretë e gabueshme e kësaj pyetjeje është të kuptuarit e gabueshëm të caktimit dhe fatit të vullnetit të lirë dhe zgjedhjes së lirë, nga ana e atyre të cilët janë të preokupuar me studimin e këtyre pyetjeve. Ata caktimin dhe fatin e kanë kuptuar se kjo është të detyruarit dhe të shtrënguarit e njeriut në atë çka nuk është në karakterin e tij dhe në natyrën e tij. Të njëjtin gabim e ke bërë edhe ti o mik! Allahu i madhëruar e mohon detyrimin nga ana e vet:

“Nëse kishim dashur, Ne nga qielli do t'ua zbritnim një Shenjë para së cilës ata qafat e tyre do t'i ulnin.” (Esh- SDhoumareâth, ë4n).ia e këtij ajeti është e qartë: ka qenë plotësisht e mundur që njerëzit të detyrohen në besim, por kjo s'është bërë për shkak se Allahu nuk detyron:

“Nuk ka shtrëngim në fe. Rruga e vërtetë qartë dallohet nga ajo lajthitëse.” (El-Bekare, 256).

“Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t’i besonin çka janë në Tokë që të gjithë. A ti do t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?” (Jûnus, 99).

Në ligjshmëritë të cilat i ka dhënë Zoti nuk ka kurrfarë detyrimi. Caktimi dhe fati nuk guxohet të kuptohen si detyrim i njerëzve në diçka çka nuk është në natyrën e tyre. Allahu xhel-le shanuhu i jep secilit atë që është në vetë qëllimin e tij, i dëshiron atë çka ai vetë dëshiron dhe do atë çka ai vetë e do. Të qeverisurit e Zotit është zgjedhja e njeriut, sepse Zoti xhel-le shanuhu e drejton çdo njeri nga ajo nga synon zemra e tij dhe çfarë qëllimi ka:

“Kush dëshiron shpërblimin e Ahiretit, do t’ia shumëfishojmë atë, ndërsa atij kush dëshiron shpërblimin e kësaj bote, do t’ia japim...” (Esh-Shûrâ, 20).

“Zemrat e tyre janë të sëmura, kurse Allahu sëmundjen e tyre edhe më e shton...” (El-Bekare, 10).

“Kurse ata të cilët janë në rrugë të drejtë, Ai edhe më tej do t’i shpjerë...” (Muhammed, 17).

Do ta përmendim edhe ajetin në të cilin Allahu xhel-le shanuhu u drejtohet robërve:

“Nëse Allahu e di se në zemrat tuaja ka diçka të mirë, do t’ju japë më mirë se ajo që është marrë nga ju...” (El-Enfâl, 7A011)-Allahu i lartësuar na e mundëson atë që e kemi zgjedhur në zemrat tona dhe çfarë janë qëllimet tona dhe së këtejmi nuk ka dhunë, detyrim as shtrëngim në diç që nuk është në pajtim me natyrat tona.

“Sa i përket atij që jep dhe ruhet (nuk gabon), dhe atë më të bukurën e konsideron të vërtetë, atij do t’ia lehtësojmë për në lehtësi. Kurse ai që është koprrac dhe ndihet i mëvetësishëm, dhe atë më të bukurën e konsideron gënjeshtër, atij do t’ia lehtësojmë për në vështirësi.” (El-Lejl, 5“-T1i0)n.uk gjuajtje kur gjuaje, por

gjuante Allahu...” (El-Enfâl, 17).

Këtu po identifikohet akti i të gjuajturit të njeriut me gjuajtjen e bërë nga ana e Allahut xhel-le shanuhu, dhe se ekziston vetëm një gjuajtje. Njeriu ka qëllimin, ndërsa Allahu i madhëruar e mundëson realizimin e tij, dhe këtë, nëse është i mirë, me të mirë, kurse nëse është i keq, me të keq. Liria njerëzore nuk ka masë të përhershme por vetëm aftësinë relative, e cila zmadhohet dhe zvogëlohet. Njeriu mund ta rritë lirinë e vet me shkencë: me ndihmën e zbulimeve dhe risive të ndryshme ai ka arritur ta pushtojë Tokën, ta ngadhënjë hapësirën dhe të çlirohet nga prangat e kohës. Duke i zbuluar ligjet në natyrë njeriu ka arritur që të zotërojë me to dhe që vetes ato t’ia nënshtrojë: ka zbuluar si ta ngadhënjë ngrohtësinë, ftohtësinë, errësirën dhe kështu e ka rritur lirinë e vet në planin e aktivitetit të tij. Shkenca pra, është mjet i zgjerimit të kufijve të lirisë së njeriut.

Mjeti i dytë është feja. Të drejtuarit Zotit dhe kërkimi i ndihmës së tij, gjithashtu i zgjeron kufijtë e lirisë dhe këtë mjet e kanë përdorur të gjithë Të dërguarit e Zotit dhe ithtarët e tyre. Sulejmani (a.s.) i ka nënshtuar xhinnët, ka zotëruar me erën dhe ka folur me zogjtë, të gjitha këto me përkrahjen dhe ndihmën e Zotit; Musa (a.s.) e çau detin; Isa (a.s.) i ngjallte të vdekurit, i shëronte të verbërit, të zgjebosurit dhe të verbërit. Lexojmë, gjithashtu, për evlijatë - dashamirët e Zotit - të cilëve u mbulohet Toka dhe u zbulohen sekretet, të rëndomtëve të paarrtshme.

Të gjitha këto janë shkallët e lirisë të ngritura mbi liritë mesatare njerëzore, të cilat ata i kanë arritur me përpjekjet më të larta në të drejtuarit e tyre Allahut xhel-le shanuhu dhe të shprehurit e dashurisë ndaj Tij. Atyre u janë dhuruar pjesët e diturisë sekrete. Dituria paraqitet sërish. Mirëpo, këtë herë kjo është dituria e te-savvufit - misticizmit (el-’ilm-ul ledûnij). Ç’ështëjën e zgjedhjes së lirë dhe vullnetit jo të lirë Ebu Hamid El-Gazaliu e shtron dhe e shkoqit shkurt dhe thjesht me dy fjali:

“Njeriu është i lirë në atë që ka dituri” dhe “Nuk është i lirë në atë që nuk ka dituri”.

Me këtë ai mendon se sa më shumë që të zgjerohet dituria e tij, zgjerohet njëkohësisht edhe sfera e lirisë së tij, qoftë dituria e tij objektive apo dituri mistike (ledunij).

Mendimtarët materialistë gabojnë kur pohojnë se njeriu është rob i domosdoshmërisë historike, duke parë në të vetëm nyjen në zingjirin e ndodhive shoqërore-ekonomike, plotësisht të nënshtrur- ar ligjeve të ekonomisë dhe lëvizjes së shoqërisë.

Nocionin të cilin ata pa lodhje e përsërisin, sikur ai të ishte ligj, “domosdoshmëri e konfliktit klasor”(hatmijet-us-sira-it-tabe- kijj), është i gabueshëm në shkoqitjen shkencore, sepse nuk ka domosdoshmëri në sferën njerëzore, por më së shumti që ka, janë gjasat dhe mundësitë dhe në këtë edhe qëndron dallimi ndërmjet njeriut dhe dhëmbëzave, mjeteve dhe trupave materialë. Është e mundur të parashihet të zënit e Diellit në minutë dhe sekondë, kurse është e mundur të parashihet edhe lëvizja e tij në ardhmëri. Mirëpo, është e pamundur të dihet çka fsheh njeriu në qëllimet e tij, ç’do të bëjë nesër ose pasnesër. Kjo është e pamundur të dihet përveç nëpërmjet mundësisë, probabilitetit dhe hamendjes dhe këtë, me kusht të posedimit të të dhënave të mjaftueshme për sjelljen e vendimit.

Sa u përket pohimeve të materialistëve për ndikimin e mjedisit dhe shoqërisë, dhe se njeriu nuk e jeton jetën e tij të pavarur, të mëvetësishme, u përgjigjemi se ndikimi i mjedisit dhe shoqërisë si kundërveprim lirisë individuale, konfirmon domethënien dialektike të kësaj lirie, sepse liria individuale konfirmohet vetëm në të ballafaquarit me kundërveprimet; nëse nuk ka kundërveprim në lirinë e njeriut, atëherë ai edhe s’është i lirë, nëse liria kuptohet në kuptimin e vërtetë, sepse nuk ekziston kurrfarë pengese të cilën duhet mposhtur dhe të vërtetohet nëpërmjet saj

liria jonë.

Përktheu: Nexhat Ibrahimi

PSE ALLAHU KRIJOI TË KEQEN?

Miku vazhdoi më tej:

Si mund të thoni se Zoti juaj është i përkryer, bujar, mëshirues, fisnik, i butë, kurse i ka krijuar të gjitha këto të këqija në botë: sëmundjen, pleqërinë, vdekjen, tërmetet, vullkanet, mikrobet infektuese, helmën, thatësitë, ftohtësinë, kancerin i cili nuk po i kursen as fëmijët e as pleqtë? Nëse Zoti është dashuri, bukuri dhe mirësi, si e krijoi atëherë urrejtjen, shëmtinë dhe të keqen?! Problemi të cilin e inicioi pyetja e mikut është ndër problemet fundamentale të filozofisë, shpjegimi i të cilit i ka ndarë shkollat dhe mendimet.

Në këtë përgjigje: Zoti është i mëshirueshëm dhe i mirë. Ai nuk ka urdhëruar të veprohet keq, por nga mençuria Ai nuk e pamundësoi atë.

“... Thuaj: Allahu nuk urdhëron të bëni amoralitet. A po flisni për Allahun atë që nuk e dini? Thuaj: Zoti im urdhëron drejtësi...” (El-’Arâf, 28-29).

Allahu urdhëron vetëm drejtësi, dashuri, mirësi, falje dhe atë çka është e mirë dhe kënaqet vetëm me të mirën dhe të këndshmen. Por, pse atëherë e lëshoi kriminelin të bëjë krim, vrasësin të vrajë, vjedhësin të vjedhë? Për arsye se ka dëshiruar të jemi të lirë dhe të gjykojmë pa kurrfarë ndikimi. Ndërsa liria paraqet mundësinë për të gabuar, përndryshe nuk do të quhej liri! Zgje - dhja e lirë është ndërmjet mosdëgjimit dhe dëgjimit.

Ka qenë në mundësinë e Allahut që të gjithëve të na bëjë të mirë dhe të na detyrojë në dëgjueshmëri, që do të nënkuptonte të marrurit e lirisë së të zgjedhurit.

Sipas dëshirës dhe urtësisë së Zotit, liria me dhembje është më fisnike për njeriun se sa robëria me fat. Për këtë arsye edhe është lënë mundësia e të gabuarit!

Shikimi korrekt dhe objektiv na zbulon se e mira në ekzistencën e përgjithshme është parim, kurse e keqja përjashtim. Shëndeti është bazë, kurse sëmundja përjashtim. Ne kohën më të madhe të jetës e kalojmë në shëndet. Sëmundja rrallë na godet. Ashtu është edhe me tërmetin i cili zgjat disa minuta në jetën e Tokës me miliona vjet. Këtu është edhe me luftërat dhe katastrofat. Të gjitha këto janë shtangime të shkurtra në jetën e popujve ndërmjet periudhave të gjata të paqes.

Praktikisht, çdo gjë e ka anën e mirë të saj. Sëmundja nxit ruajtjen e shëndetit, dhembja është burim i qëndresës, këmbënguljes dhe gatishmërisë për sakrificë. Tërmetet janë marrje frymë, lirim i shtypjes së brendshme të rruzullit tokësor, të cilët e ruajnë sipërfaqen e saj nga shpërthimi. Vullkanet nxjerrin pasuri të fshehta xehesh dhe e mbulojnë sipërfaqen e Tokës me llavë të plleshme. Luftërat i lidhin popujt. Nga kjo lidhje vargore u krijuan edhe Kombet e Bashkuara edhe Këshilli i Sigurimit, si instanca më të larta botërore, të cilat i zgjidhin kontestet ndërkombëtare. Penicilini, atomi, aeroplanët raketorë, raketat janë zbuluar duke iu falënderuar luftërave. Helmi i gjarprit e përmban kundërhelmin më efikas. Nga mikrobet bëhen vaksinat. Pozitat të cilat i kemi tash nuk do të na takonin sikur të ishin gjallë gjyshërit tanë. E keqja në kozmos është sikur hija në fotografi; nëse i afroresh të duket se është gabimi dhe mungesa e fotografisë, por, nëse fotografinë e vështron nga largësia e duhur, do të zbulosh se ajo është e domosdoshme dhe se hija ka detyrë të dorës së parë në formimin estetik të fotografisë.

A do të mund të dinim ç'është shëndeti sikur të mos ishte sëmundja? Të mirën e njohim duke iu falënderuar të shëmtuarës, pozitës natyrore duke iu falënderuar jonatyrores. Në këtë kuptim janë edhe fjalët e Ebu Hamid El-Gazaliut të madh: “Mospërkryerja e kozmosit është përkryerja e tij, sikur që është edhe shtrembërimi i harkut drejtësia e tij, sepse, në të kundërtën, nuk do të mund ta hedhte shtizën”.

Domethënia tjetër e vështirësive dhe dhembjeve është zbulimi i natyrës së vërtetë të njerëzve. Sikur të mos ishte vështirësia, të gjithë njerëzit do të ishin të njëjtë, bujaria do të varfërohej, kurse lufta do ta humbte ëmbëlsinë e sulmit.

Ky është provim për çdonjërin prej nesh para vetes dhe para Zotit të madhëruar.

Kjo botë nuk është gjë tjetër veçse një kaptinë romani, i cili ka disa kaptina, kurse vdekja nuk është fundi i tregimit por fillimi i tij. Nuk është korrekte të japim gjykimin për dramën në bazë të vetëm një akti të saj, sikur që është jokorrekte ta hedhim poshtë një vepër, sepse faqja e parë e saj nuk na kënaq. Gjykimi korrekt bëhet tek në fund.

Dhe, më në fund, me çka e konpenson tërë këtë miku. A mos po kërkon ai jetë pa vdekje, pa sëmundje, pa pleqëri, pa të meta, pa ndihmë, pa kufizim, pa pikëllim dhe pa dhembje. A nuk po kërkon përkryerjen absolute, ndonëse përkryerja absolute i përket vetëm Zotit. I përkyer është vetëm Një dhe i Vetmi, do të thotë se miku nuk do të jetë i kënaqur derisa ai personalisht të bëhej zot, e kjo është përçmim i vetvetes. Ai dhe të pakënaqurit e ngjashëm me të vetëm na bëjnë të qeshemi. Ata dëshirojnë që jeta të bëhet parajsë, por, ç'kanë bërë që të bëhet ashtu? Me çka miku ynë është i denjë të bëhet zot. Gjyshja ime ka qenë më e mençur se doktori i doktoruar në Francë kur thjesht tha:

“E mira është nga Zoti, kurse e keqja nga vetë ne”.

Këto fjalë të pakta e përkufizojnë dhe e sqarojnë gjithë problemin. Zoti e ka dhënë erën dhe lumin, por kapiteni i anijes e ngarkon me njerëz dhe e ngarkon me mall, dhe kur anija fundoset e shanë Zotin dhe e mallkon fatin. Çfarë mëkati ka Zoti në këtë! Ai e dha ujin në të cilin anija do të lundrojë edhe era e cila anijen do ta lëvizë, por nefsi dhe pangopësia njerëzore të mirën e shndërruan në të keqe.

Sa urtësi dhe mençuri kanë fjalët:

“E mira është nga Zoti, kurse e keqja nga vetë ne!”.

Përktheu: Nexhat Ibrahimi

ÇFARË ËSHTË MËKATI I ATIJ TEK I CILI NUK KA ARRITUR KUR'ANI?

Pas një të menduari të gjatë miku ynë, vazhdoi duke e theksuar çdo fjalë të pyetjes së re:

Mirë! - Çfarë është mendimi juaj për njeriun deri te i cili nuk ka arritur Kur'ani as ndonjë libër tjetër i Shpalljes së Zotit, as që i ka ardhur I dërguar i Zotit? Çfarë është mëkati i tij? Ç'do të ndodhë me të në Ditën e dhënies së llogarisë, për të cilën ju flitni?

I thashë atij:

Së pari më lejo të japë shenjë në supozimin e gabuar të pyetjes sate. Zoti xhel-le shanuhu qartë thotë se askujt nuk ia ka ndaluar Mëshirën e Tij, Shpalljen e Tij, Fjalët e Tij dhe Ajetet e Tij:

“Dhe nuk ka pasur popull të cilit nuk i ka ardhur ai i cili ka qortuar (tërhequr vërejtjen).” (El-Fâtir, 24).

“Ne mesiguri çdo populli i kemi dërguar nga një Të dërguar.” (En-Nahl, 36).

Pejgamberët e përmendur në Kur'an nuk janë Të dërguarit e vetëm të Zotit. Përveç tyre ka pasur me mijëra të tjerë për të cilët nuk dimë asgjë. Zoti xhel-le shanuhu për këtë i thotë Muhammedit (a.s.):

“... Për disa prej tyre të kemi rrëfyer e për disa nuk të kemi rrëfyer.” (El-Mu'minûn, 78).

Allahu frymëzon çdo gjë, madje edhe bletën:

“Zoti yt e ka frymëzuar bletën: Bëni vetes shtëpi nëpër male dhe lisa dhe në ato që njerëzit i ndërtojnë.” (En-Nahl, 68).

Nganjëherë Shpallja vjen në formë të librit të cilin e sjell Xhibrili, nganjëherë në formë të dritës e cila penetron në zemrën e njeriut, nganjëherë në formë “të të hapurit” të kraharorit për të vërtetën, nganjëherë në formë të urtësisë, të të kuptuarit dhe të vërtetës, kurse nganjëherë në formë të nënshtrimit, frikës dhe frikërespektit. Çdonjëri që nuk tregohet i shurdhër ndaj Shpalljes, pavarësisht nga mënyra me të cilën ajo arriti tek ai, do të shpërblehet nga Zoti xhel-le shanuhu. Sa u përket atyre të cilët nuk duan të dëgjojnë dhe me zemër të ndiejnë, atyre s’u ndihmojnë as librat as pejgamberët sadoqoftë që të jenë.

Allahu thotë se mëshirën ia ndanë kujt të dojë dhe për këtë askujt nuk i përgjigjet.

Nganjëherë Zoti, nga mençuria që vetëm Ai e di, e dënon dikë, kurse dikë e falë, duke e pranuar besimin e tij më të dobët. Kush prej nesh di mbase vetëm një shikim i njeriut më të rëndomtë i drejtuar me respekt dhe frikë të Zotit, është shpëtues dhe më i pranuar se falja jonë.

Studimi më i ri i formave primitive të religjiozitetit të bashkësive më të vjetra njerëzore, tregon se edhe ato kanë pasur Të dërguar dhe libra qiellorë sikur libri ynë.

Në fisin Mau-Bau është zbuluar besimi në një zot, të cilin ata e quajnë “Mugaj” dhe të cilin e përshkruajnë se është një, nuk ka lindur as që është i lindur, askush s’është i barabartë as i ngja - shëm me Të, se nuk shihet dhe se nuk mund të kuptohet, përveç nëpërmjet veprave dhe krijimeve të Tij, se Ai është Krijues, Furnizues, i Mëshirshëm, Dhurues, i shëron të sëmurët, i ndihmon fatkeqët, jep shiun, i pranon lutjet. Për rrufenë thonë se është thika e Tij, kurse bubullima është trokëllima e këmbëve të Tij. A nuk është ky Mugaji sikur edhe Zoti ynë? Prej nga këtyre kjo dije përveç nëse në historinë e tyre nuk ka qenë I dërguari dhe transmetuesi i asaj që i është shpallur, dhe se koha me këtë mësim ka

bërë ndryshimin.

Në fisin Nijam-Nijam gjejmë gjithashtu besimin në një zot, të cilin e quajnë “Mubil”. Në pyellin virgjër, siç besojnë ata, çdo gjë lëviz sipas vullnetit të Tij. Ai me rrufe i gjuan njerëzit e këqij, ndërsa të mirët i shpërblen me furnizim, bekim dhe sigurim.

Në fisin Shejlak besojnë në një zot të cilin e quajnë “Xhok”, ndër- sa e përshkruajnë se fshehet dhe paraqitet, se është në qiell dhe në çdo vend. Ai është krijuesi i çdo gjëje.

Në fisin Denka besojnë në një zot me emrin “Nijalok”. Kjo fjalë do të thotë: Ai i cili është në qiell, i cili është më i larti.

Si t'i quajmë të gjitha këto besime, a mund të themi për to se janë diç tjetër përveç vetë Islami.

A mos janë këto diç tjetër pos Shpalljes të cilën e kanë transmetuar Të dërguarit nga këta popuj gjatë historisë së tyre.

Feja është një:

“Mesiguri ata që kanë besuar, e edhe ata që kanë qenë hebrenj, të krishterë ose sabejë - ata që i kanë besuar Allahut dhe botës tjetër dhe kanë bërë vepra të mira - vërtet i pret shpërblimi prej Krijuesit të tyre, për ata nuk ka as frikë as pikëllim.” (El-Bekare, 62).

Madje edhe sabejët, të cilët e kanë adhuruar Diellin si njërin prej shenjave të Zotit kurse të cilët kanë besuar në Një Zot, Ditën e gjykimit, ringjalljen, dhënien e llogarisë dhe kanë bërë vepra të mira, do të kenë shpërblim te Zoti xhel-le shanuhu.

Pikëpamjet e mëshirës së Zotit janë të ndryshme. Dikush lindet i verbër, derisa të tjerët lindin me të pamur. Ata të cilët kanë jetuar në kohën e Musaut (a.s.) kanë parë me sytë e tyre se si ai me një goditje të shkopit të tij e çau detin. Bashkëkohësit e Isaut (a.s.) kanë qenë dëshmitarë se si ringjallë ai të vdekurin. Sa na përket

neve, ne për këto ndodhi dimë vetëm atë që e kemi dëgjuar, kurse të dëgjohet nuk është e njëjtë çka edhe të shihet, as që është i barabartë ai që sheh dhe ai që dëgjon. Përveç kësaj, besimi ose jobesimi nuk janë të kushtëzuar me mu'xhize. Kokëfortët dhe mendjemëdhenjtë i kanë parë mu'xhizet e të dërguarve të tyre dhe se edhe më tepër kanë thënë se ato janë “gënjeshtër”.

Nuk ka dyshim se deri te miku ynë, doktori i shkencës, kanë ardhur që të tre librat qiellorë: Tevrati, Inxhili dhe Kur'ani, e ky i fundit në gjuhën e tij amtare, e me këtë vetëm shtohet ashpërsia me të cilën ai futej në këto polemika. Nga shkaqet dhe rrugët e vërteta në diskutimin autentik, miku iku në situatën e cila s'është e tij, duke pyetur për njeriun abstrakt të cilit nuk i ka ardhur I dërguar dhe deri te i cili nuk ka depërtuar Kur'ani as ndonjë libër tjetër qiellor, me qëllim që të gjejë jopërkryeshmërinë e drejtësisë hyjnore dhe mangësitë e saj.

Së këndejmi ai edhe pyet: Përse aspektet e Mëshirës Hyjnore janë të ndryshme? Përse Zoti dikujt i lejon t'i shohë shenjat e Tij kurse të tjerëve vetëm të dëgjojnë për to?

I përgjigjemi se kjo mbase nuk do të ishte mëshirë por dënim. A nuk u ka thënë Allahu xhel-le shanuhu ithtarëve të Isaut (a.s.) të cilët kanë kërkuar t'ua dërgojë sofrën nga qielli:

“Allahu tha: Unë do t'ua zbresë atë, por ai që e mohon edhe pas kësaj prej jush, atëherë unë do ta dënoj me një dënim me çfarë askënd në botë nuk do ta dënoj.” (El-Mâide, 1K1j5o)ë. shtë kështu për arsye se për atë i cili pas pamjes së mu'xhi- zes nuk beson, dënimi ashpërsohet dhe rritet. Lum për atë kush besoi pamjen e mu'xhizes, kurse mjerë për atë kush e pa por nuk besoi! Kur'ani në duart tua është dëshmi dhe vërejtje, ndërsa në Ditën e llogarisë do të jetë dënim

Mosekzistimi i dëshmisë së qartë për eskimezët e viseve polare, mund të jetë lirim, falje dhe mëshirë në Ditën e dhënies së lloga-

risë, njëlloj sikur që vetëm një shikim i tyre i mbushur me respekt dhe frikë të devotshme në një çast të jetës së tyre mund të jetë i mjaftueshëm që te Zoti të pranohen si besimtarë të singertë.

E pse Zoti xhel-le shanuhu është më i mëshirshëm ndaj dikujt, kjo i përket urtësisë së Tij:

“Ai ka ditur ç’ka në zemrat e tyre, andaj ka zbritur qetësi mbi ta, dhe do t’i shpërblejë me një fitore të afërt.” (El-Fet’h, 1D8ij)a. e Zotit mbi ne dhe zemrat tona zgjatë më tepër se fillimi ynë fizik në mitrat e nënave, kur shpirtrat tanë kanë qenë rreth Arshit, dhe se ndër ne ka asish të cilët janë mbuluar rreth dritës së Tij, ndërsa ka edhe asish të cilët janë larguar prej Tij, duke u kënaqur me ato me të cilat Ai i krijoi, dhe duke harruar në bukuritë e Krijuesit të Tij. Për këtë arsye edhe meritojnë shkallë më të ulët në Ditën e dhënies së llogarisë dhe më pas. Kështu flasin ata të cilët shohin.

Atë që ne e shohim gjatë jetës sonë të shkurtër në këtë botë nuk është e tëra. Vetëm I Gjithëdijshmi e di urtësinë e çdo dhembjeje dhe fatkeqësie. Çdo gjë që shohim e ka kuptimin e vet, por ne nuk mund ta kuptojmë domethënien dhe mençurinë e tërë ekzistuese, sepse kjo mundësi nuk i është dhënë askujt.

Ndoshta për këtë shkak edhe ekziston bota tjetër, dita në të cilën do të vihen kandarët e vërtetë dhe kur I Gjithëdijshmi do të na lajmërojë për ate për çka jemi ndarë.

Në fund, miku im, do të të qetësoj me fjalën kryesore të të vërtetës, në të cilën Zoti xhel-le shanuhu shprehimisht thotë:

“Dhe asnjë popull Ne nuk e kemi dënuar derisa nuk i kemi dërguar pejgamber.” (El-Isrâ, 15).

Do të më lejosh të të tregoj edhe për diçka shumë të çuditshme në pyetjen tënde. Në shikim të parë ajo zbulon keqardhjen tënde ndaj atij të cilin drita kur’anore ka mundur ta kalojë, mëshira dhe përdhja e Zotit. Kuptimi më i thellë i pyetjes zbulon mosbesimin

tënd në Kur'an, mëshirën dhe përudhjen e Zotit. Kjo është me të vërtetë orvatje e mashtrimit dhe gënimit. Sipas kësaj ajo bart kundërthënie evidente; del me dëshminë e cila për ty vetë nuk është kurrfarë dëshmie. A nuk po sheh se logjika të cilën po e përdorë kërkon korrigjime rrënjësore.

Përktheu: Nexhat Ibrahim

XHENNETI DHE XHEHENNEMI

Miku ynë kësaj here ishte plotësisht i sigurt në vetvete. Ia filloi duke i shqiptuar fjalët ngadalë:

Si do të na dënojë Allahu, kurse Ai është I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti, për mëkatin gjatë një kohe të kufizuar me dënim të përhershëm (“...ata do të qëndrojnë në xhehennem përgjithmonë!”). Kush jemi ne dhe çka paraqesim në krahasim me madhërinë e Zotit, e që të na “hakmerret” në këtë mënyrë. Njeriu është vetëm atom apo pluhur në kozmos dhe në krahasim me madhërinë e Zotit do të thotë diç shumë e imët dhe e pavlerë, në realitet nuk do të thotë asgjë.

Duke ia përmirësuar njohuritë mikut, themi:

E para - nuk jemi ne vetëm atom dhe pluhur në kozmos. Pozita jonë te Zoti nuk është e parëndësishme, përkundrazi, ajo është e madhe dhe e rëndësishme. A nuk na ka frymëzuar neve prej shpirtit të tij. A nuk na janë përlurur ëngjëjt. A nuk na ka premtuar trashëgiminë e qiejve dhe Tokës, e ka thënë.

“Vërtet, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit dhe i kemi bërë të udhëtojnë nëpër tokë dhe të lundrojnë nëpër det. I kemi furnizuar me më të mirat dhe lart i kemi nderuar ndaj shumicës së krijesave Tona.” (El-Isrâ, 70).

Në ne, do të thotë, ka pjesë prej shpirtit të Zotit.

Kundrejt kozmosit, ne nuk jemi atom as pluhur. Ne ashtu dukemi kur të shikohen trupat tanë në hapësirën e gjithësisë.

Mirëpo, ne a nuk e përfshijmë gjithësinë me mendjen tonë, i kup- tojmë ligjet të cilat sundojnë në të dhe depërtojmë në orbitat e shumë trupave të saj. Falë kësaj, kozmonauti lëshohet në Hënë, duke konfirmuar se njohuria jonë ka qenë e saktë.

Kjo a nuk dëshmon se ne, duke shikuar në shpirtin tonë, jemi më të mëdhenj se kozmosi dhe e zotërojmë atë. Andaj ka patur të drejtë poeti kur duke iu drejtuar njeriut ka thënë:

“Dhe mendon se je trup i vogël kurse në ty përfshihet bota më e madhe”.

Njeriu, siç thonë sufistët, është libër gjithëpërfshirës, kurse kozmosi janë faqet e tij.

Njeriu pra është mjaft i madh dhe mjaft i rëndësishëm. Ai bart në vete prej shpirtit të Zotit. Edhe veprat e tij obligojnë të jenë të llogaritura.

Sa i përket vërejtjes në lidhje me të dënuarit me dënim të përvetshëm për mëkatin me zgjatje kohore të kufizuar, (mendojmë), ky është edhe një gabim të cilin e bën doktori ynë i sigurt në vetvete gjatë arsyetimit të tij. Zoti xh.sh. duke u përgjigjur në kërkesën e të dënuarve të përvetshëm që të kthehen përsëri në këtë botë e të punojnë ndryshe nga ajo që kanë punuar, thotë: “...Edhe sikur të ktheheshin, mesiguri ata përsëri do t'i ktheheshin asaj që e kishin të ndaluar. Ata vërtet janë rrenacakë.” (El-En'âm, 28), do të thotë, mëkati i tyre nuk është i kufizuar sipas kohës. Ajo është veti e përhershme e cila gjithnjë do të përsëritej, siç shihet prej ajetit të theksuar: “edhe sikur të ktheheshin, tra mesiguri përsëri do t'i ktheheshin asaj që e kanë pas të ndaluar. Ata vërtet janë rrenacakë.” Mëkati i tyre pra, nuk është kurrfarë rënie momentale, situatë momentale në të cilën janë gjendur derisa kanë qenë në dynja. Për ta Allahu xh.sh. në një vend tjetër në Kur'an thotë;

“Atë ditë kur Allahu xh.sh. do t'i ringjallë të gjithë ata, Atij do t'i betohen sikur që po ju betohen juve dhe do të mendojnë se me këtë diç kanë arritur dhe fituar... Ata, pa dyshim janë rrenacakë të vërtetë.” (El-Muxhâdele, 18).

Nga ajeti i cituar shihet pra një formë tjetër e vendosmërisë dhe provokimit nga ana e të dënuarve me dënim të përjetshëm, të cilët shkojnë gjer atje saqë e ballafaqojnë Zotin me rrenën dhe betimin e rrejshëm të tyre dhe atë në Ditën e llogarisë së madhe, në Ditën kur do të ngrihen të gjitha perdet dhe mbulesat. Qëndrimi i tillë i tyre është shenjë e kryelartësisë dhe tiranisë më të madhe.

Nuk jemi pra më këtu te mëkati i kufizuar me kohën, por para mëkatisë zgjatja e të cilit është e përhershme dhe para shpirtit i cili në vetvete e mban të keqen e përhershme. Së këndejmi, dënimi i përhershëm për shpirtin e tillë në realitet është drejtësi. Për këtë qartë flet ky ajet kur'anor:

“Dhe ata nuk do të dalin prej xhehennemit.” (El-Bekare, 168). Kurse Ibni Arebiu thotë: “Mëshirë ndaj tyre do të jetë ajo se ata do të adaptohen në këtë zjarr. Dhe ai në amshueshmëri do të bëhet mjedis i përshtatshëm për ta”.

Pa dyshim ekziston afërsi ndërmjet disa shpirttrave të këqij dhe zjarrit. Disa shpirttra janë, në realitet, pishtarë të zilisë, urrejtjes, pasionit, xhelozisë, shpirtligësisë, hakmarrjes, veprave kriminele që i bënë sikur të jenë vërtet zjarr. Shpirttrat e tillë nuk mund të jetojnë në paqe. Për asnjë çast nuk mund të jetojnë, e që përreth vetes të mos nxisin luftë e të mos ndezin zjarr, sepse zjarri është vendbanim dhe natyra e tyre. Dhe kur shpirttrave të tillë vendqëndrim t'u caktohet xhehennemi, atëherë ky është gjykim i drejtë. Kjo në realitet është vendosje e gjërave në vendet përkatëse. Sikur rastësisht shpirttrave të tillë vendqëndrim t'u caktohej xhenneti, ata nuk do ta ndienin (nuk do t'u përshtatej). Ata a nuk e kanë refuzuar paqen në Tokë?

Xhehennemin dhe xhennetin në Ahiret duhet kuptuar në kuptimin më të gjerë. Zjarri në Ahiret nuk është djegës. Djegia në të nuk është sikurse djegia në dynja. Zoti xh.sh. dëfton se të

dënuarit me zjarr të xhehennemit në të do të flasin dhe do ta mallkojnë njëri-tjetrin. Në të ekziston druri i cili jep fryt.

Ai dru quhet “Zekkûm”. Rrënjën e ka prej fundit të xhehennemit. Ekziston dhe uji i xhehennemit i cili do të jetë pije për të dënuarit.

Zjarri i tillë në të cilin gjendet druri, gjendet uji, pastaj në të cilin të dënuarit flasin, gjithsesi është ndryshe nga zjarri të cilin e njohim ne:

“... Sa herë që një grup hyn në të (në zjarr), e mallkon atë të mëparshmin derisa kur të arrijnë në të të gjithë, grupi i fundit i tyre thotë për grupin e parë: ‘Zoti ynë, këta (paria) na kanë humbur neve (nga rruga e drejtë), pra shtoju dënimin me zjarr atyre!’ (Allahu) Thotë: ‘Për secilin (grup) është (dënimi) i shtuar, por ju nuk po e dini.’ (El-A’râf, 38). Dhe ata në xhehennem, e ky është zjarr, do të thonë. Ai zjarr është: “Lëndë djegëse të të cilit janë njerëzit dhe gurët.” (El-Bekare, 24). Zjarri për të cilin ishte fjala gjer më tani bën pjesë në gjërat e fshehta (gajbit). Ajo që është thënë për të është shprehur vetëm simbolikisht.

Nuk guxon kjo të kuptohet sikur ne po e mohojmë vuajtjen ndijore (trupore) ndërsa po e pranojmë atë shpirtërore. Vuajtja trupore ekziston dhe në të nuk lejohet të dyshohet. Ne besojmë në ekzistencën e saj. Ne vetëm konfirmojmë se hollësitë e saj, mënyra e saj si dhe mënyra e zjarrit me të gjitha përsëkrimet e hollësishme të tij, na janë plotësisht të panjohura dhe të pakuptueshme. Sipas asaj çfarë na e prezantojnë rrëfimet kur’anore, mund të konkludojmë se ai nuk është si ky zjarr i rëndomtë të cilin e njohim, sikur që edhe trupat të cilët do ta përballojnë atë zjarr do të jenë, gjithsesi, ndryshe prej trupave tanë të kësaj bote...

E njëjta gjë vlen edhe për xhennetin. Ai nuk është treg perimesh, hurmash, shegash, rrushi... Të gjitha këto përsëkrime kur’anore të

Xhennetit, në realitet janë simbole, dhënie e shembujve dhe afrim i të kuptuarit:

“Shembulli i xhennetit, që u është premtuar atyre që janë të ruajtur, në të cilin ka lumenj me ujë të pashtershëm dhe lumenj nga qumështi me shije të pandryshuar.” (Muhammed, 1“5S)h.embulli i xhennetit” do të thotë se ne sjellim shembull me të cilin dëshirojmë ta afrojmë të kuptuarit e xhennetit, ndërsa esenca dhe detajet e tij në hollësi nuk janë zbuluar:

“Dhe asnjë shpirt nuk e di çfarë i është fshehur prej gëzimeve si shpërblim për atë që e ka punuar.” (Es-Sexhde, 1“7..) Xhenneti, gjerësia e të cilit përfshinë qiejt dhe Tokën...” (Âli Imrân, 133).

Pra nuk është e mundur që xhenneti të jetë vetëm kopsht.

“... Dhe pemë të shumta, të bollshme dhe të pandaluara.”

(El-Vâkia, 32-33).

Ato pemë janë ndryshe nga këto tonat të cilat harxhohen dhe ndalohen... dhe vera:

“Prej saj as s’ju dhemb koka e as që e humbni mendjen (as s’u dobësohet trupi).” (El-Vâkia, 19). Ajo verë pra, është ndryshe prej verës së njohur nga e cila dhemb koka dhe turbullohet mendja.

Për xhennetlinjtë Kur’ani thotë:

“Ne nga krahatorët e tyre e kemi hequr çdo urrejtje.” (El- A’râf, 43). Këtu shpirtat janë pastruar në mënyrën e cila për ne është e panjohur.

Xhenneti është, po ashtu, prej gjërave të panjohura - gajb. Kur e konstatojmë këtë, atëherë me këtë nuk e mohojmë asnjë kënaqësi trupore. Ne besojmë se xhenneti është kënaqësi trupore dhe shpirtërore, por ajo që veçanërisht këtu duam ta theksojmë, është se hollësitë e kësaj kënaqësie dhe vuajtjeje si dhe mënyra

se si do të jenë - na janë të panjohura. As xhenneti nuk është treg i pemëve dhe perimeve, por as xhehennemi nuk është furrë për pjekjen e mishit.

Dënimi në Ahiret nuk është demonstrim i forcës nga ana e Zotit xh.sh. mbi robërit e Tij, por ai është pastrim, prezentim, drejtim dhe mëshirë:

“Nuk do t’ju dënojë Allahu nëse ju Atë e falënderoni dhe e besoni.” (En-Nisâ, 147). Bazë pra, është mosdënimi.

Allahu xh.sh. nuk do ta dënojë besimtarin e vërtetë. Ai do ta dënojë atë i cili është kryelartë dhe i cili e mohon dhe për përdhjen e të cilit kanë dështuar të gjitha mjetet dhe mënyrat e përdhjes, njoftimit dhe të të kuptuarit.

“Dhe mesiguri do të bëjmë që ta shijojnë dënimin më të vogël, para atij më të madhit, ndoshta do të kthehen.” (Es-SCeaxkhtidmei, 2i1Z).otit është që këta të shijojnë dënim më të lehtë në këtë botë, i cili ndoshta do t’u ndihmojë që të zgjohen nga gjumi i thellë, t’i trondisë nga pagdhendshmëria dhe dremitja. “Ndoshta do të kthehen”.

Nëse nuk ndihmojnë të gjitha këto mjete dhe ai i cili e mohon (Zotin) edhe më tutje e mohon, atëherë nuk mbetet tjetër përpos ballafaqimit të tij me dënimin e vërtetë që ta njohë... e njohja e së vërtetës në realitet është mëshirë. Sikur Zoti xh.sh. t’i linte në verbësinë e injorancën e tyre dhe t’i linte pas dore, do të bënte padrejtësi, kurse Zoti xh.sh. është i pastër nga kjo. Ekspozimi në zjarr i atyre të cilët e kanë merituar zjarrin, në të vërtetë është kujdes ndaj tyre, sepse të gjitha veprat e Zotit xh.sh. janë mëshirë. Ai ndaj atyre që e kanë merituar xhehennemin është i mëshirshëm në atë mënyrë që ua ka dhënë, sepse me ndihmën e xhehennemit i edukon dhe mëson. Ndërkaq, ndaj atij i cili e ka njohur dhe besuar, bën mëshirë duke e futur në xhennet i cili i takon si nder dhe mirënjohje nga ana e Sunduesit dhe Krijuesit të

vet.

“... Me dënimin T'im do ta dënoj cilin të dua, kurse mëshira Ime ngërthen çdo send...” (El-A'râf, 156). Ai pra, ka bërë që mëshira e Tij të ngërthejë gjithçka, pra edhe dënimin e Tij.

Ta pyesim tash mikun, sipas mendimit të tij, a do të ishte Zoti më i drejtë sikur t'i barazonte mizorët me ata të cilëve u është bërë mizori, vrasësit me të vrarët, dhe të gjithë njëloj t'i shpërblejë në Ahiret. A do të ishte e drejtë, sipas mendimit të doktorit, që të barazohet e bardha me të zezën? Atyre të cilët e përjashtojnë mundësinë e dënimit të Zotit, u bëjmë pyetje: A nuk po na dënon, në realitet Zoti, edhe në këtë botë? Çka janë pleqëria, sëmundja, kanceri etj., përveç se dënime, por në një mënyrë të caktuar.

Kush është krijues i mikrobit...?!!

A nuk është kjo vërejtje dhe paralajmërim se gjendemi para Zotit i cili mund të lëshojë dënim.

Përktheu: Miftar Ajdini

A ËSHTË FEJA OPIUM?

Miku vazhdoi të shtrojë pyetje duke bërë me sy:

Ç'mendim keni ndaj atyre të cilët thonë se feja është opium, se i bënë si të droguar të varfërit dhe të shkelurit që në heshtje ta durojnë dhunën e ushtruar ndaj tyre dhe mjerimin në të cilin jetojnë, duke ëndërruar vetëm për xhennetin dhe kënaqësitë e tij, gjë që, në anën tjetër, të pasurve u siguron jetë të qetë dhe pa brenga në bollëkun e tyre për të cilin ata thonë se është e drejtë e tyre e plotë, sepse Zoti i ka krijuar njerëzit të ndryshëm sipas pasurisë?

Ç'mendoni për ata të cilët pohojnë se feja nuk është e dhënë nga Zoti, por se është rrjedhim i rrethanave dhe nevojave shoqërore, në mënyrë që të jetë armë e një klase në luftë kundër klasës tjetër?

Miku, shihet qartë, jep shenjë në mendimet e disa materialistëve për fenë.

Në këtë iu përgjigjëm:

Është i papranueshëm pohimi se feja është opium. Përkundrazi, feja në qenësinë e saj është detyrë, obligim dhe përgjegjësi. Ajo nuk është shfrenueshmëri dhe braktisje, e as ikje nga përgjegjësia, prandaj edhe nuk është opium. Feja është punë, jo përtaci: "Thuaj: Punoni, Allahu do ta shohë punën tuaj..." (Et-Tevbe, 105). Ne e rekomandojmë tevvekkulin, por jo pasivitetin. Tewekkuli (mbështetja në Zotin) kërkon vendosmëri, shfrytëzimin e të gjitha mundësive, dhënien e të gjitha forcave dhe shfrytëzimin e të gjitha shkathtësive, pas të cilave vjen mbështetja në caktimin e Zotit dhe urdhëresën e Tij:

"... E kur të vendosish, atëherë mbështetu në Allahun..."

(Âli Imrân, 59). Pra, së pari vendimi i fuqishëm.

Këtë e shohim edhe nga fjalët e Pejgamberit të Zotit një beduini i cili deven e tij e la jo të lidhur duke thënë se është mjaft që është mbështetur në Zotin: “Lidhe, e tek pastaj mbështetu!” d.m.th. jepe tërë atë që mundesh nga vetvetja që të të lidhë, e vetëm atëherë mbështetu në Zotin.

Feja, në të vërtetë është zgjuarsi e përhershme, përplot kujdes, vetëkontroll dhe dhënie e llogarisë me vetveten në çdo punë, gjatë çdo fjale dhe mendimi, që qartë nuk janë karakteristika të konsumuesit të drogës.

Konsumues i vërtetë i drogës është ai i cili dëshiron të ikë nga përgjegjësia për veprat e tij, i cili mashtrohet me iluzionin se çasti i tij është mbretëria e tij, se për këtë askujt nuk i përgjigjet, se nuk ka kontroll as përgjegjësi, prandaj edhe është i lirë të veprojë çka të dëshirojë. Çfarë dallimi ndërmjet njeriut të këtillë dhe atij i cili veten e konsideron përgjegjës madje edhe për fqinjtë më të largët, dhe i cili, nëse kushdo qoftë mbetet i uritur në popullin e tij apo kafshës i është bërë padrejtësi, e qorton veten se nuk e ka kryer obligimin e tij.

E dyta, nuk është i saktë pohimi se feja ka lindur në Tokë - nga rrethanat dhe nevojat shoqërore, në mënyrë që të jetë armë e një klase në luftën kundër tjetrës dhe në mënyrë që pasanikëve t’ua mbrojë pasurinë e tyre, kurse të varfërve varfërinë e tyre. E saktë është pikërisht e kundërta.

Islami është revolucion kundër të pasurve, grumbulluesve të kapitalit, eksploatuesve dhe tiranëve. Haptas ka theksuar se kapitali nuk guxon të jetë vetëm në duart e të pasurve të cilët me të do të manipulojnë dhe spekulojnë, por duhet të bëhet pronë e të gjithë njerëzve:

“Ata të cilët e ruajnë arin dhe argjendin e nuk e japin në rrugën e Allahut, lajmëroi ata me një dënim të dhembshëm.” (Et-Tevbe, 34). Ky shpenzim fillon me zeqatin prej 2,5 për qind i cili detyrimisht duhet të ndahet, kurse pastaj ndarja vullnetarisht rritet deri aty sa vetes t’i lënë vetëm sa t’u mjaftojë për ushqim, kurse tjetrën krejtësisht e ndajnë:

“Të pyesin ty se çka do të ndajnë? Thuaj: Tepricën!” (El- Bekare, 219). Kjo kuptohet nga fjala “el-afwu” që d.m.th. çdo gjë që tepron nga bollëku dhe nevoja.

Në këtë mënyrë Islami ka arritur t’i lidhë obligimet e detyrueshme ligjore dhe dhëniet vullnetare të cilat mbështeten në ndërgjegjen e çdo individi, që është shumë më fisnikëruese për njeriun sesa nga ai ta marrë pasurinë e tij me dhunë dhe konfiskim.

Islami nuk ka ardhur ta konfirmojë dhe vërtetojë dhunën e tiranëve, por, në të vërtetë ka qenë revolucion i pakompromis kundër të gjithë tiranëve, shpatë dhe luftë kundër të gjithë shtypësve dhe despotëve.

Sa i përket akuzës se feja është reaksionare dhe klasore, që disa individë të papërdhur e shohin nga ajeti:

“Allahu ngriti disa nga ju mbi disa të tjerë (kundruall disave) në furnizim.” (En-Nahl, 71) dhe,

“Ne i kemi ngritur disa nga ju ndaj disa të tjerëve për disa shkallë...” (Ez-Zuhruf, 32). Të tillëve u përgjigjemi se këto ajete mund të aplikohen mbi ata në Londër, Paris, Berlin dhe Moskë po aq sa edhe mbi ata në Kajro, Damask dhe Xhide. Nëse do të shëtitnim nëpër rrugët e cilitdo nga këto qytete, do të bindeshim se në to ka të atillë që ecin në këmbë, derisa të tjerët i ngasin biçikletat apo voziten në veturat më luksoze. E ç’është kjo tjetër veçse dallim i madh i bazuar në nevojat, shkallët dhe pozitat

ekonomike të këtyre njerëzve.

Dallimi ndërmjet njerëzve është dëshmi e njëmendtë të cilën askush nuk mund krejtësisht ta fshijë. Si të barazohet pabarazia?

Njerëzit qysh nga çasti i lindjes së tyre janë të pabarabartë sipas inteligjencës, fuqisë, bukurisë dhe talentit. Ata pra, lindin me aftësi të ndryshme dhe jo të barabarta. Synimi përfundimtar nga sendërtimi i të cilit kanë synuar të gjitha lëvizjet ekonomike në histori, ka qenë që të gjithë njerëzve t'u ofrohen mundësi të njëjta, e jo të vijë deri te barazimi ndërmjet njerëzve. Këto lëvizje kanë shkuar nga ajo që çdo njeriu t'i mundësohet shkollimi, mjekimi dhe t'i sigurohet ajo që është e domosdoshme për ekzistencën e tij jetësore. Kurse tërë këtë e ka urdhëruar dhe e urdhëron feja. Sa u përket anulimeve totale të dallimeve dhe heqjes së shkallëve, konsiderojmë se do të ishte një lloj dhune dhe akt i cili do t'i kundërvihet vetë natyrës e cila është e mbështetur dhe ekziston duke iu falënderuar dallimeve dhe fryteve të shumëllojshme të tokës dhe duke iu falënderuar dallimeve ndërmjet kafshëve dhe njerëzve. Dallimet, pra, janë qartë të dukshme edhe në botën bimore dhe shtazore.

Ky është ligji i të ekzistuarit të tërësishëm, domethënia e të cilit është krejtësisht e qartë. Sikur të gjithë njerëzit të lindeshin me cilësi të njëjta dhe sipas një kallëpi dhe një modeli, atëherë aspak s'do të kishte nevojë që të gjithë të lindin. Do të mjaftonte që të paraqitet një model sepse ai do të mund t'i plotësonte të gjithë të tjerët. Rasti i ngjashëm është edhe me të gjitha krijesat tjera në natyrën e gjerë. Kjo vetëm do të shpiente deri te varfërimi i natyrës dhe shkatërrimi i saj sepse pasuria e saj dhe bollëku i saj janë rezultat i fryteve dhe farave të ndryshme.

Por edhe përveç kësaj, feja nuk e ka heshtur dallimin ndërmjet të pasurve në një anë dhe të varfërve në anën tjetër, por ka urdhëruar korrigjimin e gjendjes ekzistuese. Të varfërit i ka caktuar

pjesëmarrje në pasurinë e të pasurit, duke bërë të kuptojnë qartë se ky dallim ndërmjet tyre, në të vërtetë, është sprovë dhe provim:

“Ne bëmë që njëri-tjetrin ta vëni në sprovë; a do të jeni të durueshëm?” (El-Furkân, 20).

Ne do të shohim se ç’do të bëjë i fuqishmi me fuqinë e tij. A do t’i ndihmojë të dobët apo do t’i rrahë, vrasë dhe a do të bëhet tiran në tokë. Gjithashtu do të shohim se ç’do të bëjnë të pasurit me pasurinë e tyre. A do të bëjnë padrejtësi e do të shkapërderdhen apo do të jenë të mëshirshëm dhe bamirës. Do të shohim se ç’do të bëjë me varfërinë e tij edhe i varfëri. Do të xhelozojë, urrejë, vjedhë dhe shpërdorojë apo do të punojë, angazhohet dhe përpiqet që ta përforcojë standardin e jetës së vet në mënyrë të lejuar dhe të drejtë ligjore.

Feja urdhëron drejtësinë, korrektësinë dhe rregullimin e situatave dhe që të gjithë t’i kenë mundësitë e njëjta. Kërcënohet me dënim të dhembshëm në botën tjetër, për të cilën thotë se në të do të jenë dallimet më të mëdha në mënyrë që të përmirësohet ajo që ka qenë jokorrekte në jetën e njerëzve në këtë botë: “Ahireti është, në të vërtetë, më i madh përnga pozita dhe përnga vlerat.” (El-Isrâ, 21).

Atyre të cilët e akuzojnë Islamin duke thënë se është reaksionar, u përgjigjemi se Islami ka miratuar ligje mjaft progresive në sistemin e pushtetit. Respektimi i personalitetit në Islam ka arritur apogjenë. Ai është sprovuar para Kartës për të drejtat e njeriut dhe në çdo gjë e ka tejshkuar, sepse individi në botëkuptimin islam është i barabartë me mbarë njerëzinë:

“... Nëse dikush vret dikë i cili nuk ka vrarë askë, ose nuk ka bërë në tokë rrëmujë, sikur ka vrarë tërë njerëzinë; por kush bëhet shkaktar për të jetuar dikush - sikur tërë njerëzisë ia ka ruajtur jetën...” (El-Mâide, 32).

Nuk vlejné kurrfarë suksessesh, as përmirësimi i kushteve materiale jetësore, as ndërtimi, as pendat, as fabrikat, nëse me qëllim të sendërtimit të tërë kësaj pa të drejtë vritet ose bëhet dhunë kundër kujtqo qoftë sepse kjo vrasje është e barabartë me vrasjen e tërë njerëzisë.

Islami personalitetit njerëzor i kushton rëndësi të madhe. Individi, sipas mësimet islam, ka vlerën absolute, derisa mësimet tjera politike i japin vlerë relative. Ai është i siguruar në shtëpinë e tij dhe në jetën e tij vetjake: “Nuk ka spiunim as përgojim”, i mbrojtur në pasurinë, furnizimin, pronësinë dhe lirinë e tij. Çdo gjë duke fituar nga selami (përsëndetja), bëra e vendit në shoqëri për tjetër, deri te fjala e mirë, ka vendin e vet në Kur’an, i cili repretë- sish të dënon çdo lloj autokracie, dhune dhe absolutizmi.

Allahu i madhëruar i thotë Pejgamberit (a.s.) në një ajet:

“Ti ata nuk mund t’i detyrosh...” (Kâf, 45);

“Ti këshillo - ti je vërtet vetëm këshillues. Ti ndaj atyre nuk je detyrues.” (El-Gâshije, 21-22);

“Vërtet besimdrejtë janë vëllezër.” (El-Huxhurât, 10); Kur’ani e ndalon kultin e personalitetit:

“Mos ta trajtojmë njëri-tjetrin si zota, përpos Allahut.”

(Âli Imrân, 64);

“Zoti yt ka përcaktuar që të mos adhuronit tjetërkë përpos Atij.” (El-Isrâ, 23).

Gjithashtu ndalon britmën, karrierizmin, poshtërsinë dhe bindjen e verbër (lajthitjen) ndaj të humburve dhe thotë:

“Shumica e njerëzve nuk dinë.” (Jûsuf, 21);

“Por, shumica e tyre nuk kuptojnë.” (El-Ankebût, 63);

“Shumica e njerëzve nuk besojnë.” (Gâfir, 59);

“Ata nuk ndjekin tjetër vetëm supozime dhe nuk janë tjetër vetëmse gënjeshtarë.” (El-En'âm, 116);

“Ata nuk trajtohen ndryshe, por vetëm si kafshët, madje janë edhe më të humbur.” (El-Furkân, 44).

Gjithashtu ndalon çdo diskriminim dhe racizëm:

“Më fisniku ndër ju tek Allahu është ai i cili më së shumti i ruhet Atij.” (El-Huxhurât, 13);

“Ai është i cili ju krijoi vetëm prej një vete.” (El-A'râf, 189). Kuptuar shkencërisht, Islami është sintezë universale dialektike e materializmit hebraik dhe e idealizmit të krishterë, sintezë e drejtësisë së vrazhdë e cila thotë: dhëmbi për dhëmb dhe syri për sy dhe dashurinë dhe tolerancës skajore e cila mëson: kush të godet nga faqja e djathtë, ktheja edhe të majtën.

Kur'ani ka ardhur të zë pozitë të ndërmjetme ndërmjet Teuratit i cili i tërë i është kthyer kësaj bote, kënaqësisë materiale në jetën e kësaj bote dhe Inxhilit i cili kërkon kthyerje të plotë të asketizmit në këtë botë. Kur'ani thërret në mëshirë e cila e përfshinë edhe drejtësinë edhe dashurinë.

Urdhëron vetëmbrojtjen, por i jep përparësi ndjesës, pajtimit dhe faljes: “Por kush duron dhe fal, s'ka dyshim se ajo është ndër punët më të larta.” (Esh-Shûrâ, 43).

Islami nuk zgjedh zgjidhje të mesme ndërmjet dhënies së lirisë së plotë individit dhe ndalesës së saj:

“Burra ve ju takon pjesa nga ajo që e fituan ata dhe grave gjithashtu ju takon pjesa nga ajo që e fituan ato.” (En-Ninidsiâv, 3id2i). është i lirë të fitojë, por ai nuk ka të drejtë ta marrë tërë fitimin. Në fitim ai ka pjesën e tij. Edhe i varfëri ka pjesën e vet. E merr zeqatin dhe shpenzimet prej 2,5 për qind e deri në 90 për qind me forcë ose vullnetarisht. Kjo pjesë të cilën e merr (i var- fëri) nuk është mëshirë as ndarje vullnetare por e drejtë

e Zotit (hakk-ull-llah) në fitim. Me këtë ndarje jashtëzakonisht të mirë, Islami individit ia ka ruajtur lirinë, kurse të varfërit ia ka mbrojtur të drejtën e tij.

Prandaj, Kur’ani ka plotësisht të drejtë kur u drejtohet pjesëtarëve të vet me fjalët:

“Dhe ashtu ju kemi bërë juve një popull të drejtë...” (El- Bekare, 43).

Islami në çdo gjë e ka zgjedhur mjedisin e drejtë.

Ky nuk është mjedis matematikor por dialektik, është sintezë e dy drejtimeve (të djathtë dhe të majtë) të cilët i tejshkon dhe ngrihet mbi to. Për këtë në Islam nuk ka të djathtë as të majtë, por ka vetëm “sirât”, d.m.th. mjedis i drejtë, të cilin ne e quajmë Rugë e drejtë.

Kur’ani nuk na ka penguar me kushtetutë të caktuar politike apo me mënyrën e administrimit deri në hollësi të përpunuar sepse kushtet dhe situatat ndryshojnë, gjë që kërkon gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme dhe më racionale për shpalljen e kushtetutës e cila do të ndryshonte me ndryshimin e kushteve jetësore. Kur’ani më tej ka dëshiruar që dyert të jenë gjithnjë të hapura para muslimanëve për marrje dhe dhënie nga dituritë e sendërtuara në çdo kohë, pa mbyllje në suazat e një kushtetute të caktuar.

Për këtë, Kur’ani është kënaqur me porositë e përgjithshme si karakteristika të pushtetit ideal. Nuk na ka pranguar me një teori të caktuar. Kjo në të vërtetë është vetëm një nga fshehtësitë e përkryerjes së tij absolute, ndërsa në asnjë mënyrë mangësi dhe e metë.

Kjo, nga ana tjetër, është dëshmi e qartë e bashkëkohësisë së Kur’anit.

Atyre të cilët thonë se feja do të thotë stagnim dhe prapambeturi, do t'ju përgjigjemi se Islami kurrë s'ka qenë i tillë, por përkun- draz, është fe e të studiuarit, të menduarit, zhvillimit dhe ndry- shimit që shihet nga këto ajete të qarta:

“Thuaj: Udhëtoni nëpër botë dhe shikoni se si ka filluar krijimi.” (El-Ankebût, 20);

“Le të shikojë njeriu se prej çkafit është krijuar! Është krijuar nga një ujë i hedhur që del nga meskryqet dhe kraharori.” (Et-Târik, 5-7);

“A nuk i shikojnë devet se si janë krijuar, edhe qiellin se si është ngritur lart, edhe malet se si janë vendosur, edhe tokën se si është shtrirë (zgjeruar)?” (El-Gâshije, 17-19).

Të gjitha këto janë urdhëresa të qarta për studimin e zanafillës së njeriut, kafshëve, zanafillës së maleve, Tokës, shtresave të kozmosit dhe botëve të tij. Të gjitha këto janë qëndrime të cilat përfshijnë gjithë atë që ne sot e kuptojmë me ndihmën e shkencave siç janë: gjeologjia, astronomia, anatomia, fiziologjia dhe embriologjia.

Të gjitha ajetet e theksuara lart, në të vërtetë janë urdhra të qarta që të udhëtohet nëpër Tokë dhe të mblidhen faktet, pastaj të merren konkludimet, të zbulohen rregullat dhe ligjet për njohjen e zanafillës së çdo gjëje që ekziston. Në mbarë këtë nuk duhet frikësuar gabimisht. Islami e shpërblen me një shpërblim edhe atë i cili nga dëshira të njohë (mësojë) gabon, ndërsa atë i cili studion dhe e qëllon të vërtetën, e shpërblen dyfish.

I paarsyeshëm është pohimi se ne kemi mbetur mbrapa për shkak të fesë, ndërsa Perëndimi ka përparur për arsye se e ka refuzuar fenë. E vërteta është se ne kemi filluar të mbetemi mbrapa atë moment kur i kemi braktisur urdhrat e fesë sonë. Derisa muslimanët fuqishëm u përmbaheshin udhëzimeve

kur'anore, kanë përparuar dhe kanë arritur ta krijojnë shtetin e tyre i cili shtrihej prej Atlantiku deri në Gjirin Arabik, në të cilin lulëzonte shkenca dhe në të cilin kanë jetuar dhe punuar dijetarë të mëdhenj sikur që janë Ibn Sina në mjekësi, Ibni Ruzhdi në filozofi, Ibn Hejthemi në matematikë, Ibën Nefisi në anatomi dhe Xhabir ibn Hajami në kimi.

Bota tjetër e atëhershme nga ne mori të arriturat tona shkencore. Edhe sot e kësaj dite fjalorët astronomikë përmbajnë terma arabë të yjeve dhe hyllësive (konstelacioneve). Kështu ende aparati për destilim në frëngjishte quhet imbique, kurse nga kjo është marrë edhe folja imbiquer, nga fjala arabishte imbiik.

Perëndimi nuk e ka sendërtuar përparimin me ateizëm, por me shkencë. Mosmarrëveshjet rreth konfliktit të fesë dhe shkencës kanë lindur nga njëmendësia e Kishës së Mesjetës, kur ajo pamëshirshëm ka qëruar hesapet me dijetarët nëpërmjet inkuizicionit. Kështu, dijetari i madh Galileu ka qenë i burgosur, ndërsa Xhordano Bruno është djegur në turrën e drunjve.

Nuk themi se kjo nuk ka qenë keqpërdorim i fesë. Por, nuk mundemi kurrësi ta pranojmë mendimin që për këtë duhet fajësuar edhe Islamin dhe ta mohojmë si fe. Islami në gjithë këtë është më së paku fajtor, sepse ai kurrë nuk është shndërruar në hierarki të priftërisë, sepse kurrfarë hierarkie priftërore as klerikale nuk e pranon mësimi i tij. Në Islam Zoti nuk ka vendosur ndërmjetës ndërmjet Tij dhe njeriut.

Nga historia qartë mund të shihet se kur sundonte Islami, në të vërtetë, ishte faktori më i fuqishëm i përparimit dhe i çdo progresi. Kur'ani gjithnjë nxit në kërkimin e diturisë; urdhëron të studiuarit dhe me vendosmëri hedh poshtë çdo konflikt ndërmjet shkencës dhe fesë:

“Thuaj: Zoti im, shtoma diturinë!” (Tâhâ, 114);

“A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?” (Ez-Zumer, 9);

“Allahu ka dëshmuar se nuk ka zot tjetër përveç Tij, (këtë e dëshmojnë) edhe engjëjt dhe të diturit...” (Âli Imrân, 18); Siç shihet nga ajeti i fundit, Allahu menjëherë pranë vetes i vendosi engjëjt dhe të diturit.

Fjalët e para të cilat i janë shpallur Muhammedit (a.s.) kanë qenë “ikre” (d.m.th. lexo, mëso, studio, hulumto...). Kur’ani dijeta- rëve ua premtoi gradat më të larta:

“Allahu, ata nga mesi i juaj që besojnë dhe ata të cilëve u është dhënë dijenia, do t’i ngritë në shkallë të lartë.” (El- Muxhâdele, 11).

Termi “el’ilmu” (dituria, shkenca) dhe sinonimet e tij përsëriten 850 herë në Kur’an.

E si mundet dikush që pas të gjitha këtyre të flasë për konfliktin e fesë dhe shkencës ose për atë se feja e ndalon shkencën!!!

Të studiohet feja dhe të përcillet zhvillimi i saj është obligim. Tërë historia islame paraqet lëvizje të ringjalljes dhe përparim të jetës në tërësi. Prandaj, Kur’ani është krejtësisht i pastër nga akuzat se e ndalon shkencën: Ai e pranon dhe e rekomandon zhvillimin. Ai, në të vërtetë, mban qëndrimin se besimi dhe sheriat i janë të pandryshueshëm, duke e bazuar këtë në parimin themelor: Allahu është Një dhe i Vetmi dhe nuk shtohet në dy apo tre. Ky është një parim absolut. Gjithashtu e mira është gjithnjë e mirë, kurse e keqja e keqe. Kurrë vrasja nuk do të bëhet vlerë, as vjedhja vepër e mirë, sikur që as gënjeshtria nuk mund të jetë virtyt i njerëzve të mirë e të ndershëm. Në të gjitha sferat tjera feja i lë dyert e hapura për idetë, ixhtihadin në të plotësuarit dhe përparuarit.

Thelbi i Islamit është racional dhe logjik, pranon diskutimin dhe dialogun, duke nxitur në përdorimin e arsyes dhe logjikës. Në

shumë vende dhe në shumë faqe të Kur'anit hasim në pyetjen: "A nuk kuptojnë, a nuk marrin vesh". Islami kërkon që ithtarët e tij të jenë "dijetarë":

"Krijesat më të këqija te Allahu janë shurdhmemecët, të cilët nuk duan të kuptojnë." (El-Enfâl, 22);

"Përse ata nëpër botë nuk udhëtojnë me qëllim që zemrat e tyre ta kuptojnë atë që duhet ta kuptojnë, veshët e tyre ta dëgjojnë atë që duhet ta dëgjojnë..." (El-Haxh, 46).

Nga ajetet e theksuara shihet se sa e respektojnë muslimani dhe feja e tij arsyen. Pozitiviteti dhe revolucionariteti janë nervat, respektivisht shpirti i Islamit, i cili kurrë nuk mund të jetë i prapambetur (reaksionar) dhe negativ:

"Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju luftojnë juve." (El-Bekare, 190).

"Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij në radhë si të jenë mure të fortifikuara." (Es-Sâff, 4).

Islami kërkon luftën me jetë, pasuri dhe pasardhës (fëmijë); kërkon qëndrueshmëri dhe vendosshmëri; ballafaqim të guximshëm dhe durim në fatkeqësi. Por mbi të gjitha kërkon qëndrueshmëri të vazhdueshme. Të gjitha këto janë thelb i Islamit.

Si është e mundur atëherë që feja me këtë elasticitet, racionalitet, me këtë shtytje për shkencë dhe të studiuarit e natyrës (së "gjallë" dhe "të vdekur"), me këtë pozitivitet dhe revolucionaritet, të akuzohet për stagnim (të jetës) dhe prapambeturi?! Akuza e tillë mund të bëhet vetëm nga njeriu i cili nuk i njeh as gjërat elementare të fesë së tij dhe i cili nuk ka lexuar asnjë shkronjë nga Kur'ani.

Përktheu: Nexhat Ibrahim

QËNDRIMI I ISLAMIT NDAJ FEMRËS

Tha miku:

A nuk pajtohesh me mua se qëndrimi i Islamit ndaj femrës është reaksionar? Miku filloi të numërojë: Poligamia, mbyllja e femrës në shtëpi, mbulesa, e drejta e mashkullit në shkurorëzim, e drejta e mashkullit në ushtrimin e metodave sikur që janë fuqia fizike, refuzimi i fjetjes me gruan, e drejta e mashkullit me “femrat me të cilat disponon”, pozita më e lartë e burrave në krahasim me gratë dhe pjesa dy herë më e madhe në trashëgim.

I thashë atij: Akuzat këtë herë janë të shumënumërta, prandaj edhe biseda do të zgjasë diç më shumë. Të nisemi prej fillimit. Në periudhën paraislamike, fëmija femër me lindjen e saj ishte e dënuar me varrosjen e saj të gjallë. Mashkulli kishte të drejtë në dhjetë, njëzet, me fjalë të tjera në numër të pakufizuar grashë. Robëreshat e veta i detyronte që me anë të kurvërisë t'i sjellin dobi materiale. Duke e lejuar martesën me më së shumti katër gra, Islami, në të vërtetë, e vendosi kufizimin e poligamisë dhe tendencën për suprimimin e saj. Ky hap i Islamit ka qenë shpëtimtar për femrën, sepse e ka shpëtuar prej turpërimit, përçmimit, skllavërimit dhe vdekjes më brutale, të dhunshme. Që këtë mos ta arsyetojmë në mënyrë të veçantë, të pyetemi, a thua femra bashkëkohore në kushtet formale të martesës monogamike është e lumtur, e kënaqur dhe në nivelin e duhur të dinjitetit njerëzor, kur dimë se është fundosur në jetën ku sundon korrupsioni dhe amoraliteti i të gjitha llojeve. Ç'është më dinjitoze për femrën: të jetë gruaja e dytë në martesë ligjore me të gjitha të drejtat apo të bëhet dashnore që në fshehtësi kërkon kënaqësi fizike.

Përveç kësaj, Islami poligaminë e kushtëzoi ashtu që gati ajo është e pamundur. Me fjalë të tjera, martesa me dy, tri dhe më së shumti katër gra i është lejuar njeriut i cili mund të jetë i bara-

bartë dhe i drejtë ndaj të gjithave:

“... Por, në qoftë se frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë, atëherë (kënaquni) vetëm me një!...” (En-Nisâ, 3) dhe

“Ju nuk mund të jeni plotësisht të drejtë ndaj grave tuaja, sikur ju këtë edhe ta dëshironit...” (En-Nisâ, 129).

Sa i përket lidhshmërisë së femrës me shtëpinë, kjo si urdhër ka të bëjë vetëm me bashkëshortet e Të dërguarit të Zotit, sepse ato merren si shembuj ideal për femrat:

“Në shtëpitë tuaja qëndroni...” (El-Ahzâb, 33).

Nga kjo shihet rekomandimi islam për femrën si nënë dhe amvisë, femrën e cila tërësisht i përkushtohet familjes dhe shtëpisë së vet.

Mirëpo, Islami nuk ia ndaloi femrës daljen prej shtëpisë dhe marrjen me punë të ndryshme, nëse këtë nevojat e kërkojnë. Tekfundit në historinë e popujve islamë gjejmë një numër të madh femrash të cilat u dëshmuar si juriste dhe poetë të shkathëta. Muslimanet kanë marrë pjesë në luftëra njëloj sikur që kanë marrë pjesë edhe në të gjitha sferat e jetës kulturore.

Ajeti i theksuar paraprak paraqet vizionin e gjendje s ideale sa i përket pozitës së femrës, ndërsa ndërmjet gjendjes ideale, të mundshme dhe të vërtetë ekzistojnë, natyrisht, dallime të mëdha. Edhe gratë e Pejgamberit të Zotit kanë shkuar në luftë bashkë me të.

Ta vështrojmë tash kundërshtimin për shkak të mbulesës së fem- rës. Menjëherë të themi se ajo shkon në llogari të femrës dhe di- njitetit të saj. Islami ka lejuar zbulimin e fytyrës dhe duarve, ndërsa ka ndaluar zbulimin e pjesëve tjera të trupit. Është e vër- tetë e dëshmuar se “pema e ndaluar” është më tërheqëse; mbulimi i pjesëve të caktuara të trupit vetëm e zmadhon tërheqjen dhe

dëshirën për to. Kaherë është zbuluar se në fiset primitive në të cilat femrat janë të zbuluara, gatisë nuk ka ndjenjë dashurie. Meshkujt dhe femrat takohen vetëm një herë një muaj, e nëse ajo mbetet me barrë, marrëdhëniet seksuale ndërpriten dy vjet. Edhe në përvojën tonë kemi shembuj të shumtë të cilët e dëshmojnë këtë të vërtetë. Trupat lakuriq të femrave të cilat na rrethojnë verës nëpër plazhe nuk janë joshës, tërheqës dhe nxitës sikur kur janë të mbuluar. Është e pakontestueshme se femrës më së shumti i ka mbetur të jetë e dashur dhe se si femër, së pari dhe më së shumti e përul ajo që ia heq nxitjen dhe tërheqshmërinë.

Sa i përket kundërshtimit për të drejtën e mashkullit në shkurorezim, do të jemi krejtësisht të shkurtër. Sikur që mashkulli mund ta shkëpusë martesën, këtë mund ta bëjë, me anë të gjyqit, edhe femra po qe se ka shkaqe të arsyeshme. Në anën tjetër, femra me rastin e lidhjes së kurorës, themelimin e saj mund ta kushtëzojë me të drejtën e saj për shkurorezim.

Përveç kësaj, ekziston një dallim qenësor në pozitën bashkëshortore të muslimanes dhe femrës evropiane. Me rastin e lidhjes së martesës, muslimani pranon mehrin, ndërsa femra në Perëndim sjell miraz (prikën). Muslimanja, më tej, krejtësisht e pavarur disponon me pasurinë e saj, derisa me pasurinë e evropianes disponon burri i saj.

E drejta e mashkullit në aplikimin e mjeteve fizike dhe largimin prej shtratit bashkëshortor, ka të bëjë vetëm ndaj atyre femrave të cilat shprehin disa lajthitje të caktuara seksuale dhe bashkëshortore. Kryesisht kjo ka të bëjë me dy ekstravaganca më të përhapura dhe psikologjikisht të shpjeguara: mazohizmin dhe sadizmin. Në rastin e parë femra dëshiron të jetë fizikisht e munduar, kurse në rastin tjetër, që ajo ta mundojë bashkëshortin. Kjo, në të shumtën e rasteve mund të kuptohet si mu'xhize kur'anore, sepse shumë para çfarëdo zbulimeve psikologjike, i ka vënë këto veti dhe marrëdhëniet ndaj tyre duke i lejuar mashkullit

që femrën - mazohiste ta shërojë me ilaçin që e dëshiron ajo, kurse ato janë të rrahurat fizike, ndërsa femrën sadiste ta shërojë me braktisjen e shtratit bashkëshortor:

“... E pastaj në shtrat ndanu nga ato, e madje edhe rrahni...”
(En-Nisâ, 34).

Këto dy fjalë përmbajnë vëllime të tëra të hulumtimeve psikologjike për ekstravagancat seksuale të femrës dhe shërimit të saj. Sa i përket kundërshtimit për të drejtën e mashkullit në “femrat me të cilat disponon”, të kuptuarit e tij ashtu siç duhet, para- shtron diskutimin e raportit të Islamit ndaj robërisë. Është e njo- hur orvatja e disa orientalistëve që ta akuzojnë Islamin, duke po- huar se anon nga robëria, ndonëse Islami, sikur që këtë do ta shpjegojmë, është feja e vetme e cila kërkon suprimimin e rNoëbsëeridsoë.ta lexonim Inxhilin (Ungjëllin) dhe po t'i shqyrtonim po- saçërisht fjalët e apostullit Pal nga shkresat e tij të drejtuara popullatës së Efsusit, do të gjenim thirrjen më të hapët për robëri, në të vërtetë, kërkesën më të drejtpërdrejtë të përlules së tillë të robërve ndaj zotërinjve, e cila është e njëjtë me përlulen ndaj Zotit:

“Ejjuhe-l-abid.. Ettîû sâdetikum bi hawfin we ra'detin fi besâtati kulubikûm kemerr-rabbi.” (Inxhili).

“O ju robër!! Nënshetrojuni zotërinjve tuaj me frikë dhe brengë në përlulen e zemrave tuaja sikur Zotit!”

Inxhili nuk ka kërkuar suprimimin e robërisë sikur sistem. Qëllimi i tij i fundit ka qenë vendosja e dashurisë dhe marrëdhënieve të mira midis robërve dhe zotërinjve të tyre.

Sipas Teuratit ekzistues, fati i të lirëve është më i keq se sa fati i robërve. Prej porosive të tij është që: banorët e vendit të cilët dorëzohen pa luftë merren si robër, derisa banorët e vendit të cilët kundërvihen me armë e pastaj dorëzohen, u ekspozohen armëve

dhe vriten. Tmerrit nuk mund t'i shmangen as gratë, as fëmijët, as pleqtë.

Pra robëria, para paraqitjes së Islamit ka qenë dukuri e rëndomtë dhe e përhapur, ndërsa fetë para Islamit porositnin nënshtrim ndaj zotëriut.

Kur'ani është libri i parë i shpallur i cili flet për lirin e robërve. Ai nuk e ndaloj kategorikisht robërinë as që kategorikisht kërkoi lirin e robërve, sepse realizimi praktik i qëndrimit të tillë në kuptimin e tij të vërtetë do të thotë shkatërrim i strukturës së tërësishme të shoqërisë së atëhershme. Kjo në të vërtetë, do të thoshte dalje e qindra mijëra lypsive nëpër rrugë duke kërkuar lëmshë ose të vjedhin, plaçkisin, të merren me kurvëri për shpëtimin e lëkurës. Është e panevojshme të theksohet se një gjendje e tillë do të ishte më e keqe se sa robëria. Andaj Kur'ani ka konstatuar realisht rrugën më të pranueshme, rrugën e eliminimit gradual të robërisë. Ai fillon ashtu që së pari e mbyll robërinë e gjetur dhe pastaj i shkatërron të gjitha burimet e saj. Në atë kohë robërimi në luftë ishte burimi kryesor i robërisë dhe Kur'ani urdhëroi lirin e robërve, me apo pa kompensim dhe ndaloj që robërit e zënë në luftë të shndërrohen në robër:

“...E mandej, ose me zemërgjerësi nga robëria lironi, ose dëmshpërblim kërkon...” (Muhammed, 4).

Pasi që i likuidoi burimet e robërimit të ri, do të thotë e pamundësoi zgjerimin e tij të mëtejshëm, Kur'ani me mjete jashtëzakonisht efikase praktike e hapi rrugën për suprimimin e plotë të robërisë. Muslimanit i cili bën ndonjë mëkat, Kur'ani si formë të kompensimit i ofroi lirin e robit, me atë që pesha e mëkatit është harmonizuar me numrin e robërve të cilët duhet liru.

Në aspektin e robërisë së femrave, për çka flet miku ynë, gjendja është në shenjë të të lartshënuarës. Mirëpo, është e nevojshme të theksohet që deri në suprimimin përfundimtar të robërisë,

mashkulli ka të drejtë të sillet me robërshën sikur me gruan e tij të ligjshme, por jo edhe ndryshe. Nëse i kemi përmendur marrëdhëniet ndaj robërshës sikur ndaj gruas së ligjshme, për atë kjo do të thotë nder e kurrësi përulje.

Në të njëjtën kohë duhet të jemi të vetëdijsëm se Islami me proklamatin e tij për vëllazërimin e njerëzve, robin e barazoi me zotëriun e tij:

“Vërtet, besimdrejtët janë vëllezër.” (El-Huxhurât, 10).

“Ai është i cili ju krijoi vetëm prej një vete (njeriu)...” (El- A’râf, 189).

“... Dhe njëri-tjetrin, në vend të Allahut, mos t’i konsiderojmë si zotër!” (Âli Imrân, 64).

Muhammedi (a.s.) me një shembull të vetin ka treguar se si do të eliminohet robëria. Ai robin Zejd ibni Harithin së pari e bijësoi, pastaj e liroi dhe e bëri si bir të vetin. Shkoi edhe më larg dhe ia kurorëzoi vajzën e një familjeje të njohur fisnike, Zejneben, të bijën e Xhahshit. Muhammedi (a.s.) këtë e bëri për shkak që një herë e përgjithmonë t’i shkatërrojë të gjitha aspektet e mendje - madhësisë dhe anshmërive. Lirimin e robërve e bëri praktikë të cilën muslimanët, ithtarët e tij, duhet ndjekur. Ai, më tej, me vepër dhe shembull vetjak, tregoi se misioni i tij është lirim i plotë i njeriut nga të gjitha aspektet e robërisë (përveç Një, të Vetmit Zot).

Në kundërshtimin e mikut që ka të bëjë me ajetin në të cilin Kur’ani e shënon aftësinë më të madhe të meshkujve nëse krahasonen me femrat dhe ate në kryerjen më efikase të (disa) punëve, përgjigjemi ashtu që mikut i përkujtojmë që pak më mirë ta shohim realitetin jetësor, gjendjen faktike si në botën muslimane ashtu edhe në botën jomuslimane. Gati në të gjitha vendet e botës, meshkujt janë ata të cilët e kanë sundimin në

duart e tyre. Ata miratojnë ligjet dhe dispozitat. Edhe të gjithë pejgamberët e Zotit kanë qenë të gjinisë mashkullore. Gati e njëjta gjë është edhe me filozofët, e deri diku edhe me kompozitorët, edhe pse vetë komponimi më tepër mbështetet në fuqi të imagjinatës se sa në fuqi të muskujve. Akkadi (mendimtari dhe islamologu i njohur egjiptian, N. I.) me ironi thotë se madje edhe gatimi, qepja dhe modelimi ja në punë të cilat përndryshe mendohen specialitete të femrave, terren jo i rrallë ku meshkujt ua tejkalojnë femrave.

Të gjitha këto janë fakte në të cilat sheriatu islam nuk ka kurrfarë kontributi, sepse këto janë dukuri të përgjithshme në të gjitha pjesët e botës, dhe atje ku sheriatu islam nuk sundon as që gjykohehet sipas Kur'anit. Të gjitha këto janë të vërteta faktike. Mash- kulli është më i qëndrueshëm se femra sipas ligjit të natyrës, duke iu falënderuar ndërtimit të tij të trupit, me të cilin Krijuesi e ka dhuruar. Nëse diku në botë edhe ndodh që femra të zgjedhet për ministre, udhëheqëse ose sunduese, kjo gjë është e rrallë dhe përjashtëm i cili vetëm e konfirmon parimin.

Përveç kësaj, këtu është e nevojshme të theksohet se Islami vetëm e ka regjistruar parimin tashmë ekzistues.

Pas gjithë kësaj që u tha, bëhet plotësisht i qartë qëndrimi i Isla - mit për çështjen e trashëgimit, kur e ka paraparë që mashkulli të trashëgojë pjesën dy herë më të madhe në krahasim me femrën. Kur'ani këtë përparësi ia dha mashkullit thjesht sepse mashkulli është ai i cili shpenzon në mbajtjen e tërë familjes nga ajo që personalisht e fiton me punën dhe djersën e tij. Ai nuk mund të marrë pjesë në pasurinë e gruas së tij (pa lejen e saj).

Nga e ekspozuara mund të përfundojmë se qëndrimi i Islamit ndaj femrës është plotësisht me vend dhe i drejtë. Sjellja e Muhammedit (a.s.) ndaj bashkëshorteve të tij ka qenë mishërim i dashurisë. Ndaj tyre ka treguar simpati dhe respekt të plotë. A nuk

tha:

“Nga bota juaj të dashur më janë gratë dhe aroma, kurse gëzimi im më i madh është në namaz”.

Siç shihet nga fjalët e tij, gratë janë përmendur së bashku me aromën dhe namazin. Edhe fjalimin e tij të fundit lamtumirës të drejtuar as’habëve kur ndahej nga kjo botë, e përfundoi me porosinë që të jenë të sjellshëm ndaj bashkëshorteve të tyre.

Dhe në fund, Allahu i Gjithëmundshëm xhel-le shanuhu, mashkullit ia besoi ndërtimin, ngritjen dhe rregullimin e jetës, por femrës ia dhuroi rolin më të madh, më të rëndësishëm, më të rëndë dhe më të ndershëm: ia besoi edukimin e vetë njeriut.

Ky besim, pa mëdyshje paraqet nderin më të madh për femrën. Prandaj, a mund të konfirmohet pas tërë kësaj të ekspozuarës, se Islami ndaj femrës ka qenë i padrejtë dhe se i ka bërë dhunë?!!

Përktheu: Nexhat Ibrahim

SHPIRTI

Miku im vazhdoi duke besuar se kësaj radhe më ka shpjerë në situatë të vështirë e pa rrugëdalje.

- Ç'është dëshmia juaj se njeriu ka shpirt, se pas vdekjes do të ringjallet, se nuk është vetëm trup i cili pas vdekjes shkatërrohet në elementet e tij përbërëse dhe çka thotë feja juaj për të ftuarit e shpirttrave?

Pas të menduarit të shkurtër iu përgjigja mikut:

- Pyetja juaj, pa dyshim, është mjaft e ndërlikuar. Diskutimi për shpirtin është sikur të ecurit nëpër parrugësi (absurditet). Dëshmitë ekzistuese flasin në llogarinë tonë e jo tuajën.

Jam ndalur ca çaste duke menduar, e pastaj kam vazhduar:

- Përpiqu që së bashku me mua të mendosh pak! Treguesi i parë i cili do të na ndihmojë kur diskutojmë për ekzistimin e shpirtit është fakti i pranuar se njeriu ka dy natyra:

Natyrën e jashtme, fenomenale, të dukshme në të cilën bën pjesë trupi i tij me të gjitha cilësitë e materies, kurse, e cila si e tillë ka peshën e saj, zë vend të caktuar, i nënshtrohet ndikimit të kohës, ndërrimit, lëvizjes, kalimit nga gjendja në gjendje, bie në situata të ndryshme: njëherë është e shëndoshë që herën tjetër të sëmuret; e njeh trashësinë, ligësinë, të kuqtë, zbehjen; gjendet në gjendjen e aktivitetit, përtacisë, e kaplon kotja, zgjuarsia, uria, ngopësia. Këtu hyjnë edhe ndjenjat, disponimet, epshet, frika, pasionet etj. Për shkak të asaj që kjo natyrë e jashtme e dukshme e njeriut me ndjenjat plotësuese ka attribute të materies, themi se trupi i njeriut dhe shpirti i tij shtazarak janë nga materia; dhe natyra shpirtërore brenda vetë njeriut e cila është e ndryshme nga e para dhe me te e kundërt. Karakteristikat e saj janë: jondryshueshmëria, mosku-

fizimi me kohë dhe vend dhe përhershshmëria. Atë e përbëjnë: arsyeja me kriteret, përfundimet (logjike) dhe kategoritë e saj të përhershme, ndërgjegjja me ligjet e veta, ndjenja estetike dhe “Uni” (i njeriut) i cili në vete përmban të gjitha cilësitë e theksuara të mendjes, ndërgjegjes, ndjenjës estetike dhe etike. “Uni” është jomaterial dhe plotësisht i ndryshëm nga shpirti shtazarak të cilin e copëtojnë uria dhe nepset. “Uni” është uni (qenia) i njeriut absolutisht i pakufizuar me ndihmën e të cilit ai përjeton ndjenjën e thellë të pranisë, ekzistencës, të treguarit dhe të prezentuarit në botë: se këtu është dhe se këtu ngaherë ka qenë. Kjo ndjenjë është e përkohshme, gjithnjë e njëjtë, pa të kaluarën dhe të ardhmen e saj. Uni është, në të vërtetë, e tashmja e vazhdueshme e paraqitur në ndjenjën e gjithnjëshmërisë dhe përhershshmërisë.

Këtu natyrisht bëhet fjalë për llojin krejtësisht tjetër të të ekzistuarit nga i pari. Ky ekzistim nuk ka attribute të materies prandaj nuk i nënshtrohet ligjit të ndryeshmërisë dhe nuk është i kufizuar as me kohën, as me vendin e as që mund me diç të matet. Duke iu falënderuar jondryshueshmërisë së këtij ekzistimi, arrijmë ta masim të ndryshueshmen; duke iu falënderuar absolutitetit të tij mësojmë relativen në botën e materies. Shkurt, fjala është për të ekzistuarit e natyrës shpirtërore (tabiaturr-rruhije).

Të pyetemi tash: cila nga këto dy natyra e përfaqëson njeriun. A është njeriu trupi i tij apo shpirti i tij?

Që të vijmë deri te përgjigjja e vërtetë në pyetjen e shtruar, duhet të hulumtojmë se cila nga këto natyra i është nënshtuar tjetrës. Materialistët pohojnë se njeriu në të vërtetë është trupi i tij, i cili ka rol parësor në krahasim me të gjitha të tjerat që njeriu i posedon. Të gjitha të tjerat, siç janë: arsyeja, përfundimi logjik, ndje - njat (estetike dhe etike), ndërgjegjja, qenia ose “Uni” njerëzor, vetëm janë shtojca të trupit dhe kanë rëndësi të dorës së dytë në krahasim me trupin, sepse i janë nënshtuar dhe janë në shërbim

të tij.

Mirëpo, ky pohim i miqve tanë materialistë është i gabuar. Trupi i njeriut i është nënshtuar shpirtit të njeriut. Ai e ndjek shpirtin e jo shpirti atë. A nuk ndodh që trupi të kërkojë ushqimin kurse ne e privojmë nga ky, sepse paraprakisht kemi vendosur që atë ditë të agjërojmë në emër të Allahut?! Trupi ynë, kur zgjohe mi në mëngjes, fillon mekanikisht ta zbatojë planin e punës të cilin e kemi planifikuar dhe deri në hollësi e kemi përpunuar. Kush është ai i cili këtu vërtet ndjek, dhe kush është ai i cili është i ndjekur?! Atë çast kur luftëtari vendos të flijohet dhe e ngjesh dinamitin rreth vetes me të cilin dëshiron ta shkatërrojë tankun, ku është atëherë trupi, ku është aty interesi material të cilin ai do të mund ta arrinte me fljimin e jetës së tij? Kush e ka fjalën vendimtare në këtë çast? Shpirti është ai i cili vendos të mos e shpjegojë me çfarëdo interesi material asnjë drejtim materialistik. Por edhe trupi nuk ka fuqi ta refuzojë urdhrin e shpirtit, që t'i kundërvihet. Atij i mbetet vetëm të zhduket. Tash shihet qartë se cila nga këto dy bota ekzistuese është më parësore dhe më e rëndësishme, cila nga dy natyrat e njeriut vërtet e përfaqëson njeriun?!

Ne sot kemi më shumë dëshmi që trupi i njeriut ka rëndësi dytësore në krahasim me shpirtin e tij. Këtë të vërtetë na e vërteton tërë ajo që sot ndodh në fushën e amputimit, transplantimit të disa pjesëve të trupit të njeriut; çka lexojmë për zemrën elektronike, veshkët artificiale, bankën e gjakut dhe syve dhe çka dimë për transplantimin e disa gjymtyrëve sikur të duarve, këmbëve dhe zemrës. Nuk do të jetë aspak e çuditshme dhe qesharake nëse dhëndri në vitin 2000 hyn tek nusja dhe e sheh si ajo e nxjerr nga goja protezën, e heq perukën, i heq gjinjtë plastikë, i nxjerr sytë artificialë, e heq këmbën e drurit dhe në fund nga nusja mbetet vetëm skeleti i ngjashëm me shasinë pa dyer dhe ulëse.

Shohim se trupi mund të prehet deri në atë shkallë, të zbërthehet dhe mbërthehet pa kurrfarë frike se çka do t'i ndodhë personalitetit, çka qartë flet se ajo dorë, këmbë, flokë, ata sy ose gjinj nuk janë vetvetiu njeri. Ti sheh se këto organe mund të transferohen, ndërrohen dhe në vendin e tyre të vendosen bateritë, vidhat dhe pjesë nga alumina e që njeriu sërish të mbetet ai që është, pra, njeri. Pra shihet se shpirti është ai i cili “mban timonin” duke drejtuar makinën e cila quhet trup. Atë mundemi praktikisht ta prezentojmë si një drejtor të cilën sërish e përfaqëson këshilli i drejtorisë i përbërë nga shumë qeliza të trurit. Por shpirti në asnjë rast nuk është tru. Shembulli i trurit është i ngjashëm me shembullin e qelizave të trupit i cili i nënshtrohet urdhrit të cilin e pranon dhe të cilin e zbaton. Trup në tërë këtë janë vetëm dorëzat të cilat i vesh ajo dorë e padukshme - shpirti dhe me ndihmën e tyre operon në botën e materies.

Në bazë të kësaj që u tha të përfundojmë se: Njeriu ka dy natyra: parësor është shpirti i tij, kurse dytësor trupi i tij.

Pas vdekjes natyra dytësore shkatërrohet (zhdukët), kurse parësorja i bashkangjitet botës së amshueshmërisë.

Sa u përket ithtarëve të filozofisë, atyre dëshirojmë t'ua prezentojmë një dëshmi tjetër të të ekzistuarit të shpirtit në bazë të cilësisë me të cilën shquhet lëvizja. Kjo lëvizje është e pamundur të kundrohet përveç jashtë vetë atij. Është e pamundur ta kuptosh lëvizjen deri atëherë derisa edhe vetë ti bashkë me atë lëvizë në rrethin e njëjtë. Që ta kuptosh duhet ta kundrosh nga jashtë. Mund të të ndodhë që në ashensorin lëvizës nuk mund ta kuptosh se a është i ndalur ashensori apo është duke lëvizur. Kjo është kështu sepse je bërë pjesë e tij e përbashkët në lëvizjen e tij. Të vërtetën do ta mësosh atëherë kur nëpër dyert e ashensorit do ta hedhish shikimin në objektet që gjenden jashtë. Ngjashëm ndodh nëse gjendesh në tren i cili ngadalë lëvizë nëpër binarë. Lëvizjen e trenit e ndien vetëm atëherë kur ai ndalet ose kur ta hedhish

shikimin nëpër dritare. Nuk do të mund ta vëresh as lëvizjen e Diellit nga Dielli. Lëvizja e tij mund të vërehet nga Hëna apo Toka, sikur që as lëvizja e Tokës nuk mund të vërehet meqë gjendemi në të. Lëvizjen e saj mund ta kundrosh, për shembull, nga Hëna.

Një gjendje mund ta përfshishë vetëm kur gjendesh jashtë saj. Ne nuk do të kishim mundësi ta kuptojmë karakterin kalimtar të kohës sikur te ne të mos ishte “pjesa e cila kupton”, kurse e cila është jashtë kësaj kalueshmërie të vazhdueshme kohore, d.m.th. e cila qëndron “në prag të amshueshmërisë”. Sikur botëkuptimi ynë i karakterit kalues të kohës të lëvizte çdo çast me treguesin i cili i tregon sekondat, asnjëherë nuk do të mund t’i kuptonim ato sekonda.

Kështu vijmë deri te rezultati hutues se në vetë ne ekziston pjesa e të ekzistuarit tonë, e cila është jashtë suazës së kalimit të kohës, d.m.th. e cila është e amshueshme. Ajo e kundron lëvizjen e kohës, kurse vetë është në gjendjen e qetësisë, e kupton atë dhe nuk përzihet në të. Për këtë arsye kjo pjesë nuk rritet dhe nuk vjetrohet, prandaj edhe nuk shkatërrohet. Atë ditë kur trupi i njeriut vdes, kjo pjesë do të mbetet duke jetuar jetën e saj të veçantë pa u kufizuar me kohën. Kjo pjesë është shpirti.

Të gjithë ne mundemi në brendinë tonë ta ndiejmë këtë ekzistencë shpirtërore në trajtë të pranisë, përhershmërisë, tregueshmërisë dhe ekzistueshmërisë e cila është plotësisht e ndryshme nga të ekzistuarit e ndryshueshëm material.

Kjo gjendje e brendshme të cilën e ndiejmë dhe kuptojmë në ças- tet e zgjuarshmërisë së brendshme, kurse të cilën e kemi quajtur gjendje e pranishmërisë, në të vërtetë, është udhëheqës i cili na udhëheq nga ekzistenca shpirtërore brenda nesh dhe na shpie deri te enigma që quhet shpirt...

Dëshmia e dytë për ekzistencën e natyrës sonë shpirtërore është ndjenja jonë fillestare (fitrijeh) e lirisë. Sikur me ndonjë rast të jemi vetëm trupa materiale brenda jetës materiale me të cilën drejtojnë ligjet e domosdoshme materiale, ndjenja jonë fillestare e lirisë nuk do të ketë kuptimin e vet. Domethënë se ne posedojmë shpirtin i cili ngrihet mbi suazat e kohës dhe i tejkalon vdekjen dhe nevojat materiale.

Ç'të thuhet këtu për ringjalljen?

Askush pas vdekjes nuk është kthyer që të na lajmërojë për atë se çka ka ndodhur me të atje. Nuk ka hyrë as Dita e Ringjalljes e cila do të na shërbente si argument dhe dëshmi e qartë (e ringjalljes së sërishme). E gjithë ajo që mund të thuhet për ringjalljen është se ringjallja është e vërtetë fetare të cilën e pranojnë edhe arsyeja edhe shkenca. Ato e pranojnë këtë të vërtetë fetare për shkak se dëshmitë e të ekzistuarit sikur edhe të gjitha fenomenet e tij tregojnë atë se në çdo gjë ekziston kthimi nga pika nisëse dhe se çdo gjë ka rendin e vet. Kështu nata e ndërron ditën në mënyrë që kjo dukuri të përsëritet sërish me fillimin e ditës së re. Dielli lindet, pastaj perëndon në mënyrë që sërish të lindet. Stinët e vitit ndërrohen: vjen vera, pastaj vjeshta, e pastaj vijojnë dimri dhe pranvera në mënyrë që menjëherë pas pranverës sërish të fillojë vera e pas saj vjeshta, pastaj dimri dhe kështu me radhë. Pasi të zgjohemi ne përsëri flejmë, e kjo parashtrohet zgjimin tonë të sërishëm. Të gjitha këto janë fakte të cilat na konfirmojnë se pas vdekjes pashmangshëm vjen zgjimi i sërishëm, sepse “çdo gjë ka rendin e saj”. Allahu i Gjithëfuqishëm për Vetën në Kur'an thotë se është Fillues (el- mubdi'u) dhe Përtëritës (el-mu'idu):”

“Ashtu siç ju ka krijuar, ashtu edhe do të ktheheni tek Ai...”

(el-A'râf, 29).

“Ai me të vërtetë e filloi krijimin e pastaj e përsërit atë...”

(Jûnus, 4).

A nuk lundron çdo gjë në gjithësinë e gjerë duke filluar nga atomi e deri te galaktika!? Madje edhe qytetërimet kanë lëvizje zik- zake. Edhe historia gjithashtu. Dhe pikërisht ky fakt i kthimit të amshueshëm, i cili inkuadron çdo gjë që ekziston, e konfirmon fenomenin e ringjalljes pas vdekjes. Dëshmia e dytë e ringjalljes është rendi i vendosur preciz i cili e përfshinë tërë gjithësinë, në të cilën çdo gjë funksionon sipas planit të caktuar me mençuri dhe zhvillohet sipas një rregulle të dhënë. Rregullimi i këtillë sundon në galaktikën më të madhe dhe në pjesëzën më të vogël të gjithësisë - atomit, e madje edhe në pjesëzën e tij - elektronin. Rendi dhe rregullimi përfshijnë çdo gjë që ekziston. As pjesa e atomit - elektroni nuk mund të kalojë nga “kozmosi” në “kozmos” brenda vetë atomit përveç me kusht që të marrë sasi të energjisë, fuqia e së cilës është në pajtim me shpjëtesinë e tij. Që ta shpjegojmë këtë më mirë ta paramendojmë elektronin si udhëtar i cili që të udhëtojë diku duhet të ketë biletë udhëtimi.

E si mundemi atëherë të kuptojmë që në këtë rregullim të rregulluar saktësisht mund të ikë dorasi apo tirani nga dënimi për shkak se ka arritur ta mashtrojë policinë. Arsyeja flet se do të pajtohen llogaritë. Kështu flet drejtësia. Njerëzit nga natyra janë të prirur të shkojnë nga drejtësia, që të duan e të kërkojnë, dhe të përpiqen që ta sendërtojnë. Por edhe përsikaj gjithë kësaj, drejtësia në këtë botë nuk është realizuar gjithnjë.

Nëse etja për ujë, siç thonë mendimtarët, tregon ekzistimin e ujit, atëherë edhe etja për drejtësi tregon ekzistimin e drejtësisë. Mirëpo, nëse drejtësia absolute nuk ekziston në këtë botë, atëherë doemos do të vijë dita dhe çasti kur do të vendoset drejtësia.

E gjithë kjo që u tha deri më tash tregon se ekziston ringjallja pas vdekjes. Ai i cili beson në Kur'an, nuk ka aspak nevojë për

dësh- mitë e këtilla të ringjalljes për arsye se ai beson me zemër dhe se është liruar nga lodhja të cilën e imponon diskutimi:

“Dhe kur të pyesin ty për shpirtin, thuaju: “Shpirti është punë vetëm e Zotit tim, kurse juve u është dhënë fort pak dije.” (El-Isrâ, 85).

Shpirti është fshehtësi për të cilën askush nuk di asgjë. Është interesant të theksohet këtu se në Kur'an gjithnjë gjatë të përmendurit të shpirtit është thënë se ai është “punë e Krijuesit”:

“... I cili ia shpall Shpalljen, Fjalët e Tij - kujt të dojë nga robërit e Tij...” (El-Mu'minu, 15);

“Ua dërgon ëngjëjt me shpallje, sipas urdhrit të Tij, atyre njerëzve të vet që Ai do...” (En-Nahl, 2);

“Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) zbresin ëngjëjt dhe Xhibrili për të gjitha çështjet.” (El-Kadr, 4).

“Kështu Ne edhe ty të shpallim atë çka po të shpallet.” (Esh-Shûrâ, 52).

Gjithnjë, pra, pranë shprehjes shpirti (err-rruhu) janë përmendur edhe fjalët: “Sipas caktimit tonë”, “Sipas caktimit të Tij”, “Si- pas caktimit të Krijuesit tim”.

A nënkupton shprehja “Urdhri i Zotit” shpirtin? Edhe “Fjala e Zotit” gjithashtu?

A nuk ka thënë Allahu për Isaun (a.s.) se është:

“... Me fjalën e vet se emrin do ta ketë Mesih, Isa, i biri i Merjemesë...” (Âli Imrân, 45);

“Fjala e Tij, të cilën ia tha Merjemes dhe Fryma (Shpirti) i Tij.” (En-Nisâ, 171).

A janë shprehjet el-emru, dhe err-rrûhu sinonime të kuptimit të njëjtë? Këto shprehje janë vetëm shenja (simbole). Domethëniet

e tyre të vërteta i di vetëm (Allahu), I Gjithëdijshti.

Pas kësaj na mbetet që të preokupohemi me çështjen e “thirrjes së shpirtave”. Menjëherë të themi se ne dyshojmë në mundësinë e “thirrjes së shpirtave”. Është i dyshimtë pohimi se dhoma e errët shkakton thirrjen e shpirtit të dikujt.

Mendimtari i madh Henri Suder thotë:

“Burimet e kësaj shfaqjeje janë: logjika e brendshme dhe fuqitë shpirtërore të vetë ndërmjetësimit dhe asgjë tjetër”.

Kurse mendimtarët hindusë pohojnë:

“Ata që paraqiten si ndërmjetës gjatë të “thirrurit” janë shpirta botërorë të cilët dinë disa gjëra për të vdekurit dhe i përdorin për përqeshjen e të pranishëmve dhe përçmimin e tyre”.

Sufijtë (mistikët) muslimanë thonë që ai i cili merr pjesë në ato seanca, nuk është shpirti por dytësori (kipci), kurse ai është xhinni i cili e ka përcjellur të vdekurin gjatë jetës së tij dhe si i tillë i njeh fshehtësitë e tij. Pasi që xhinni është i përjetshëm ai jeton edhe pas vdekjes së shokut të tij. Xhinni është ai i cili tash merr pjesë në seanca dhe i zbulon fshehtësitë e shokut të tij: e imiton zërin e tij dhe i imiton sjelljet e tij me qëllim që, sipas traditës së xhinnëve, të pranishmit t’i nënçmojë. Kjo vjen nga ajo sepse xhinnët janë armiq të njeriut. Ata (sufistët) pohojnë:

“Nëse i bien ziles në zyrë, do të dalë portieri, derisa përgjegjësit nuk do ta lënë botën e tyre që të dalin. Ngjashëm është edhe në botën e shpirtave: Ata të cilët marrin pjesë në seancat e thirrje s së shpirtave dhe të pranishmit i përcmojnë, janë shpirtat botërorë dhe xhinnët dhe të gjithë ata të cilët janë në nivel të tyre”. Sa u përket shpirtave të njerëzve, ata janë në botën tjetër, botën ndërmjet vdekjes dhe ringjalljes dhe ata nuk është e mundur të thirren. Por, është e mundur, mbase, që të lidhen me ata të cilët dëshirojnë në ëndërr apo në njëmendësi, nëse do të

ekzistonin kushtet përkatëse për këtë. Nga shumë këso seancash në të cilat kemi prezentuar dhe në bazë të asaj çka kemi fituar si përvojë personale, kurse që ka të bëjë me këtë temë, mund të përfundojmë se: nuk ekziston asnjë dëshmi se dhoma e errët është shkaktare e pranisë së shpirtit të kërkuar. Mbase mendimi i mistikëve muslimanë më së miri e shpjegon se çka në të vërtetë po ndodh. Ky fenomen ende është në fazën e hulumtimit. Të theksojmë se, fatkeqësisht, këtu besëtytnitë janë ende më të përfaqësuar se sa të vërtetat e vërteta. Fjala e fundit për këtë ende s'është thënë. Nuk ka dyshim në atë se ti do të qeshesh me fjalët siç janë xhinnët, shpirtat botërorë, kipcat e të ngjashme. Ti për këtë ke edhe arsyetim, sepse nëse nuk beson në të ekzistuarit e shpirtit tënd personal, si është atëherë e mundur të presim nga ti të besosh në të ekzistuarit e xhinnit tim... Nëse nuk beson në Zotin, si mundet nga ti të pritet të besosh në ekzistimin e djallit. Por edhe përveç kësaj, sikur të ishe i lindur para njëqind vjetësh dhe sikur të të vinte ndonjë njeri dhe të fillonte të të flasë për rrezet e padukshme të cilat kalojnë përtej hekurit, për fotografitë të cilat transmetohen nëpërmjet ajrit përtej oqeanit më shpejtë se një sekondë dhe për kozmonautin i cili ec mbi sipërfaqen e Hënës, a nuk do të qeshesh dhe pëlqishesh duke qeshur në të gjitha ato tregime dhe a nuk do të mendoje në vete se njeriu i cili t'i tregoi të gjitha këto ka ikur nga ndonjë spital për të çmendur. Por, ja, edhe përkundër gjithë kësaj, të gjitha këto janë të vërteta të cilat ne sot i dëgjojmë dhe i shohim.

Përktheu: Nexhat Ibrahim

NDËRGJEGJJA

Tha miku im:

- Ju për ndërgjegjen flitni sikur ajo të ishte diç absolute, ndonëse është një prej prodhimeve shoqërore: hiç më tepër se një monedhë e aluminit të prerë, e shtypur dhe e formuar në furrën e afarizmit shoqëror. Ne konsiderojmë se ndërgjegjja i ndërron parimet dhe ligjshmëritë e veta sipas interesave vijuese. Ajo pra, nuk është fare absolute. Për vlerën e cila sjell dobi themi se është e mirë, kurse për vlerën e cila sjell dëm themi se është e keqe, po edhe sikur ajo vlerë të jetë edhe vetë pafajësia të cilën ju e ruani si sytë tuaj.

I thashë atij duke e ruajtur me atë rast qetësinë e plotë.

- Po... Ky është mendimi i filozofisë materialiste... si po dëgjoj... ndërgjegjja është pushtet i qortimit dhe vërejtjes i mugulluar prej faktorëve shoqërorë. Në realitet, ajo është përvojë e tubuar e cila ndryshon prej një personi në tjetrin, prej një kohe në tjetrën dhe prej një populli në tjetrin. Kështu ju mendoni dhe flitni.

Mirëpo e vërteta është krejtësisht tjetër.

Ndërgjegjja është dritë të cilën Allahu xh.sh. e vendosi në natyrën e njeriut. Ajo është tregues dhe “busull” me të cilën lindemi. Kjo dritë na udhëzon nga të vërtetat. I gjithë roli i faktorit shoqëror reduktohet në “pastrimin” e qelqit të asaj busulle dhe shkëlqimin e saj.

Ne kemi shumë argumente të cilat flasin në favor të pohimeve tona, ndërsa pohimet e juaja i demantojnë. Do t’i përmendim vetëm disa prej tyre:

P.sh. Shiko botën shtazore e cila nuk njihet shoqëri në kuptimin e rëndomtë të fjalës. Në të ka fenomene të panumërta shumë interesante dhe të çuditshme. Shih. p.sh. macen e cila pas kryerjes së nevojës kthehet dhe e mbulon me dhe. Në cilën “shoqëri macesh” ajo e ka mësuar këtë. Prej nga ajo të dallojë ndyrësinë prej pastërtisë? Pastaj, e sheh macen duke e grabitur peshkun dhe kur e zë në vepër dhe për këtë e rrah, vëren se si ajo përulet dhe kapsallit sytë, haptas duke ndier se ka bërë diç që është e ndaluar. Ose e vëren se si, duke luajtur me fëmijët nëpër shtëpi, e rrëzon saksinë e cila thehet. Çka ndodh me atë rast. Macja prej frike ik dhe fshehet nën karrige, duke ndier se ka bërë diç, për të cilën ndoshta do të dënohet.

Të gjitha këto janë dëshmi dhe manifestime të ekzistimit të ndërjegjes.

Në pushtetin e maceve nuk ekziston nevoja për kultivimin e këtyre ndjenjave. Pastaj ne e dimë se në të vërtetë nuk ekziston “shoqëria e maceve”.

Ta shikojmë tash një fenomen tjetër - zakonet e besnikërisë bashkëshortore të pëllumbat dhe të mendojmë për te. Pastaj fisnikëria e kalit e cila pasqyrohet nëpërmjet lidhjes së tij me të zotin; kryelartësia e luanit dhe njëkohësisht ngritja e tij mbi atë që mos ta sulmojë prenë e tij pas shpine; turpërimi i deveve mashkull dhe ndërprerja e aktit seksual sapo të hetojë se dikush po e shikon. Pastaj aty është edhe rasti i luanit me stërvitësin e luajve në cirkun nacional të Kajros, kur luani pas shpine i vërsulet stërvitësit Muhamed El-Hilvi dhe duke ia ngulur kthetrat në shpatulla i shkakton plagë vdekjeprurëse. Çka ndodh me luanin menjëherë pas kësaj, të dëgjojmë nga nëpunësit e cirkut të përmendur. Ata thanë se luani menjëherë pas asaj fatkeqësie plotësisht e bojkoton marrjen e ushqimit. Tërhiqet në kafazin e tij të cilin nuk e lëshon. E transferojnë në njërin prej kopshteve zoologjike. Ia lëshojnë një luaneshë, që të mund të dëfrehet.

Mirëpo ai e plagosë luaneshën dhe e “përzë” përjashta. Edhe më tutje e bojkotonte ushqimin. Pas kësaj filloi ta kafshojë këmbën e tij “mëkatare” duke e këputur copa-copa. Plagët aq shumë i rridhnin gjak, saqë në fund luani ngordhi.

Çka shohim, kafsha pra bën vetëvrasje duke u penduar dhe duke paguar dëmshpërblim për krimin e bërë. Nga cila shoqëri në pushtetin e luajve, luani i përmendur i ka mësuar këto zakone dhe në shoqërinë e tyre copëtimi i njeriut a paraqet krimin i cili dënohet me vetëvrasje?! Ne këtu jemi para fakteve të fisnikërisë, moralit dhe ndërgjegjes të cilat nuk i hasim shpesh as te njerëzit. Ne jemi para dështimit të plotë të çfarëdo shpjegimi dhe kuptimi materialist të ndërgjegjes. I vetmi shpjegim i drejtë për të gjitha këto është ai të cilin e jep feja, i cili thekson se ndërgjegjja është dritë të cilën Zoti xh.sh. e mbolli në natyrën e njeriut dhe roli i gjithmbarshëm i faktorit social shqyrtohet në pastrimin e të keqes prej shpirtit, që të mund ai më shpejt ta zbulojë dhe ta kuptojë këtë dritë të Zotit. Kështu mund të komentohet edhe rasti i luanit dhe stërvitësit të tij. Jeta e përbashkët, dashuria reciproke dhe shoqërimi e kanë kalitur shpirtin shtazor, i cili, duke iu falënderuar kësaj, ia doli që ta ndezë dritën e Të Gjithëmëshirshmit. E vërejtëm luanin i cili pas rastit në cirk fort u dëshpërua. Ai u pendua dhe në fund bëri vetëvrasje për shkak të asaj që bëri, duke u sjellë kështu si njeriu.

“Çka është hallall (e lejuar) është e qartë, dhe çka është haram (e ndaluar) është e shpjeguar...”, thotë Muhammedi a.s.

“Kërko shpjegim prej zemrës tënde edhe nëse ke marrë (shpjegim) prej njerëzve”.

Nuk nevojitet të kryhet Fakulteti i Sheriatit që të mund të dihet se çka është e drejtë e çka e gabueshme; ç’është e vërtetë e çka jo, që të mund të dallohet harami prej hallallit. Në zemrën e secilit prej nesh Zoti xh.sh. e ka vendosur fakultetin e sheriatit dhe

kandarin i cili nuk gabon. Gjithçka që kërkohet prej secilit nga ne është që t'i pastrojmë shpirtat tanë prej rrobave të materies dhe shtresës së impulsit, të shikojmë, shqyrtojmë, mësojmë dhe të mund t'i dallojmë gjërat pa shkopin i cili quhet “përvojë sociale”, por me dritën e Zotit e cila quhet “ndërgjegje”.

“O besimdrejtë, nëse ju u përmbaheni dispozitave të Zotit, dhe u shmangeni ndalimeve të Tij, Ai do t’ju udhëzojë që të mund të dalloni të vërtetën nga e pavërteta.” (El-Enfal, 29).

Zoti xh.sh. thotë në një hadith - kudsijj prej sufistit Muhamed bin Abdul-Xhebbar:

“Si mund të dëshpërohesh prej Meje kur në zemrën tënde gjendet I dërguari Im dhe ai i cili flet në emrin Tim?!”.

Ndërgjegjja është e vërtetë e pandryshueshme. Edhe vlerat themelore morale -etike po ashtu janë të pandryshueshme. Vrasja e nje riut të pafajshëm asnjëherë nuk do të bëhet vlerë, e po ashtu as vjedhja, as rrena, ofendimi, shkelja e kurorës, panjerëzia, brutaliteti, hipokrizia, tradhtia etj. Të gjitha këto janë të meta morale dhe si të tilla do të mbeten sa të jetë bota.

Nga ana tjetër dashuria, mëshira, sinqeriteti, bujaria, fjala e mirë dhe bamirësia janë vlera dhe si të tilla do të mbeten për të gjitha kohët - përveç nëse çrregullohen qiejt e Toka dhe sundon marrëzia dhe errësohet mendja.

Përktheu: Miftar Ajdini

A PËRMBAJNË ELEMENTE TË IDHUJTARISË CEREMONITË E HAXHXHIT?

Miku tha, duke i fërkuar duart nga gëzimi, i buzëqeshur me dinakëri, ashtu që iu dukën dhëmballët, ndërsa sytë i shkëlqyen me një shkëlqim i cili mund të vërehet në fytyrën e boksierit në momentin kur përgatitet ta nokautojë kundërshtarin:

- A nuk vëren bashkë me mua se ceremonitë e haxhxhit të ju janë thjesht idhujtari... ajo ndërtesë prej guri të cilën e quani Qa'be, për të cilën fërkoheni dhe rreth së cilës silleni, pastaj gjuajtja e djallit me gurë, vrapimi ndërmjet Safa-së dhe Merves, puthja e Haxherul-Esvedit (Gurit të zi), tregimi për shtatë sjelljet - Tavafi, shtatë gjuajtjet me gur dhe shtatë vrapimet, të gjitha këto janë mbeturina të tregimeve për numrat magjikë të cilët përmenden në tregimet pa vlerë, pastaj ihramët (mbulesat) të cilët i vishni në trupin e zhveshur... më fal nëse të kam ofenduar me këtë sinqeritet sepse në shkencë nuk ka turp.

Dhe miku filloi ngadalë ta lëshojë tymin e cigares së tij, duke më përcjellë nën syzet e tij.

I thashë plotësisht në mënyrë të qetë:

- A nuk e vëren edhe ti bashkë me mua se sipas ligjeve të materies, të cilat i ke studiuar, pjesët e vogla sillen rreth të mëdhave. E shohim, p.sh. se elektroni në atom sillet rreth bërthamës, Hëna sillet rreth Tokës, Toka rreth Diellit, Dielli rreth Galaktikës, Galaktika rreth Gjithësisë së madhe, kështu gjersa të arrijmë deri te “Më i Madhi Absolut” e ai është Allahu xh.sh.. A nuk themi:

“Allahu ekber” - Allahu është më i madhi. Dhe kështu, sipas ligjit tënd shkencor, rreth Tij, si më i madhi, domosdo duhet

gjithçka të sillet. Edhe ti në këtë moment sillesh rreth Tij në kuadër të sistemit tënd diellor përkundër dëshirës tënde dhe nuk të mbetet asgjë tjetër pos të sillesh. Nuk ka në mbarë gjithësinë asgjë të pandryshueshme përveç Allahut xh.sh. i cili si i tillë është i Pakufizuar, Absolut dhe i Përhershëm. Çdo gjë sillet rreth Tij. Ky është ligji i raportit ndërmjet të voglit dhe më të madhit të cilin e ke mësuar në fizikë.

Ndërsa, sa na përket neve, vullnetarisht sillemi rreth Bejtulllahut (Qa'bes), ndërtesës së parë të cilën njeriu e ka marrë që në te ta adhurojë Allahun. Ajo, si faltore e parë në historinë e nje - rëzimit, është bërë simbol dhe shtëpi e Zotit. A nuk ka në këtë botë raste kur vizitohet dikush që ka vdekur dhe kur vizita e tij arsyetohet me atë se i ka kontribuar njerëzimit. Përveç kësaj, ka shumë personalitete të shquara varrezat e të cilëve nuk dihen, e të cilat mesiguri do të vizitoheshin po të diheshin. Pastaj ka shumë raste kur në varrezat e trimave të panjohur rregullisht vihen kurora. Atëherë, përse na e shihni për të madhe që ne gjuajmë guraleca në përmendoren simbolike për të cilën themi se e simbolizon djallin. A thua nuk po jeton në vrap dhe nxitim prej lindjes e deri në vdekje, e pas vdekjes tënde djali yt do ta rifillojë vrapin; ai vrapim, në të vërtetë është simbolik i cili fillon prej Safasë e cila fjalë do të thotë pastërti, zbrazëti, shkretëti, e që gjithë kjo është simbol i mosekzistimit, e deri në Merve - vetë emri i së cilës tregon burimin i cili e simbolizon jetën dhe ekzistencën. A nuk është kjo, në realitet, vrapim prej mosekzistimit në ekzistim, pastaj prej ekzistimit nga mosekzistimi... dhe a nuk është kjo lëvizje e domosdoshme e të gjitha krijesave. Pas gjithë kësaj, në ceremonitë e haxhxit a nuk po e sheh rezytën simbolike të të gjitha këtyre sekreteve.

Sa i përket numrit shtatë (vërejtëm se disa ceremoni të haxhxit kryhen nga shtatë herë) të cilin ti e përqesh, më lejo, që para se ta zbuloj sekretin e tij, t'i shtroj disa pyetje. A mund të

më thuash ti ku qëndron sekreti që numri i notave muzikore kryhet me numrin shtatë: sol, la, si, do, re, mi, fa? Numri i shkallëve të spektrit të dritës është po ashtu shtatë, sikur që edhe elektronet sillen rreth bërthamës së atomit në shtatë shtigje. Deri te formimi i plotë i foshnjës në barkun e nënës vjen në muajin e shtatë dhe nëse ajo lindet para kësaj, zakonisht (foshnja) vdes. Të të gjithë popujt në botë java ka shtatë ditë, edhe pse nuk ka pasur kurrfarë marrëveshjes rreth këtij numri. E gjithë kjo a nuk na flet se numri shtatë, megjithatë, ka njëfarë sekreti të vet. Apo të gjitha këto gjëra janë konfuzion sharlatan.

A nuk të ndodhë që ta puthësh letrën e marrë prej të dashurës. Vetëm për këtë a do të jeshë idhujtar? Përse atëherë neve na gjykon, vetëm pse e puthim Haxheru-l-Esvedin të cilin Muhammedi a.s. e ka bartur në petkun e tij dhe e ka puthur. S'ka këtu asgjë idhujtare. Ne gjatë kryerjes së ceremonive fetare nuk i drejtohem i drejtpëdrejt gurit, po hulumtojmë kuptimet e thella, simbolet dhe kujtimet në të cilat ai përkujton.

Ceremonitë e haxhxit, nga ana tjetër, paraqesin raste të jashtëzakonshme për aktivizimin e mendimeve, për ringjalljen e ndjenjave dhe thellimin e devotshmërisë në zemrën e njeriut. Ndërsa, sa i përket ihramit të cilin e mbajnë haxhilerët gjatë kryerjes së haxhxit, e të cilët nuk guxojnë të jenë të qepur, ata, në realitet simbolizojnë heqjen dorë nga zbukurimet e kësaj bote dhe çlirimin e plotë të njeriut, i cili si i tillë i nënshtrohet vetëm Allahut të Gjithëfuqishëm. Njeriu edhe vjen në këtë botë i mbështjellur, shkon prej kësaj bote i mbështjellur dhe në varr lëshohet i mbështjellur. Për të gjitha këto ihramet janë simbole. A nuk shoh se si kërkon protokolli që në pranimet solemne duhet patjetër të jeshë në rroba solemne dhe nëse sillesh ndryshe do të shkelen rregullat e mirësjelljes. Ne themi:

Vetëm para madhërisë së Allahut xh.sh. bien të gjitha zbukurimet dhe hedhen të gjitha stolitë e kësaj bote. I vetmi

Allahu xh.sh. meriton që njeriu plotësisht t'i jetë i bindur dhe i dëgjueshëm. Përveç kësaj ihramët - ato petka modeste - të cilat gjatë kohës së haxhxhit i mbajnë të gjithë pa dallim: të pasurit dhe të varfërit, edhe maharaxha edhe milioneri, sepse të gjithë njerëzit para Zotit janë të barabartë, demonstrojnë vëllazërimin e të gjithë njerëzve pa marrë parasysh dallimet sipas pozitave dhe pasurisë. Haxhxhi te ne është tubim i madh dhe kongres vjetor i muslimanëve të mbarë botës. Namazi i Xhumasë është kongres javor.

Të gjitha këto janë mësimet të bukura dhe mendimet me kuptime të thella për çdonjërin që mendon dhe gjykon. Në të gjitha këto nuk ka asgjë prej tipareve të idhujtarisë.

Po të qëndroje ti njëherë me mua në Arefat në momentin kur disa miliona njerëz shqiptojnë: Allahu është më i madhi, lexojnë Kur'an në disa dhjetëra gjuhë, brohorisin "Të përgjigjemi (në thirrje) Ty o Zot!", qajnë dhe digjen nga dëshira e zjarrtë dhe entuziazmi, mesiguri edhe ti do të qaje nga gëzimi dhe entuziazmi që të është dhënë ai rast i veçantë, që në atë masë shumë të madhe të gjendesh në atë vend të ndershëm kur para Allahut të Gjithëfuqishëm bien të gjitha forcat dhe bukuritë e kësaj bote, para Sunduesit absolut i cili i qeverisë të gjitha dhe në pushtetin e të cilit është çdo gjë.

Përktheu: Miftar Ajdini

PSE TË MOS JETË KUR'ANI VEPËR E MUHAMMEDIT?

Më tha miku duke i zgjedhur fjalët:

- Nuk dua të të ofendoj sepse e di se sa e respekton dhe mburresh me Kur'anin. Edhe unë pajtohem me ty se Kur'ani është libër i vlefshëm. Por, pse ai të mos jetë vepër e Muhammedit, sepse njeriu me urtësinë e Muhammedit nuk do të paraqiste kurrfarë çudie me shkrimin e një vepre siç është Kur'ani. Kjo më duket më e logjikshme se sa të thuhet që Kur'ani është vepër e Allahut, libër i shpallur. Ne nuk e kemi parë Zotin që diç të lëshojë nga qielli. Jetojmë në kohën kur është shumë vështirë ta bindish një riun në ekzistimin e melekut me emrin Xhibril i cili lëshohet nga qielli me librin i cili i është shpallur dikujt.

I thashë plotësisht në mënyrë të qetë:

- Përkundrazi, jetojmë në kohën kur është shumë lehtë të besohet se ekzistojnë melekët si qenie të padukshme dhe se të vërtetat mund t'i përcillen njeriut me anë të Shpalljes. Sot është aq e po- pullarizuar çdo bisedë për pjatat fluturuese të cilat, të drejtuara nga disa trupa qiellorë të largët, aty-këtu lëshohen në sipërfaqe të planetit tonë, biseda për rrezet e padukshme të cilat kanë veprim vdekjeprurës, pastaj radiovalët të cilat vendosin caqe dhe i që- llojnë. Aty janë edhe fotografitë të cilat në rreze transformohen në vibracione të cilat më vonë i kapin aparatet e vogla të madhësisë së kutisë së duhanit, pastaj lloje të ndryshme kamerash të cilat me sukses i xhirojnë hijet, sytë të cilët shohin në terr, njeriun i cili ec në sipërfaqe të Hënës, anijen kozmike mbi Mars etj.

Sot nuk është kurrfarë çudie të dëgjosh se Allahu xh.sh. ia ka dërguar melekun - qenien e padukshme, me Shpallje njërit prej

Të dërguarve të Tij. Ekzistimi i melekut të quajtur Xhibril sot më pak habit prej asaj që për çdo ditë e dëgjojmë dhe e shohim.

Sa i përket pohimit tonë se Kur'ani nuk është vepër e Muhamedit a.s. ky pohim bazohet, përveç tjerash, në atë që vijon: Kur'ani sipas formës, shprehjeve, shkronjave të tij dhe vetë përmbajtjes si të tillë, sipas bukurisë së të shprehurit, saktësisë së gjuhës, paraqet diç të pamundur për mundësitë njerëzore. Nëse kësaj ia shtojmë edhe atë se vetë Muhammedi a.s. ka qenë “um-mijj”, do të thotë nuk ka ditur të shkruajë e të lexojë e as që ka mësuar në shkollë, nuk ka rënë në kontakt me civilizimet tjera, sepse nuk e ka lëshuar Siujdhesën Arabe, atëherë bie poshtë mundësia e çdo dyshimi dhe shtruarjes së kësaj lloji pyetjeve. Allahu xh.sh. u përgjigjet kështu atyre të cilët thonë se Kur'ani është vepër e njeriut:

“Thuaj: Përpiloni një kaptinë e cila do të ishte e barabartë me kaptinat e Kur'anit dhe ftoni përveç Allahut, ata të cilët mendoni se do t'ju ndihmonin në këtë”, (Jûnus, 38), do të thotë thirrni në ndihmë xhinnët, melekët dhe të gjithë gjenitë e mendimit njerëzor dhe përpiloni së paku një kaptinë të ngjashme. Kjo thirrje akoma është aktuale. Mirëpo, ende askush asnjëherë nuk arriti të bëjë asgjë.

Nëse Kur'anin e shikojmë nga një aspekt neutral dhe objektiv, do ta eliminonim çdo mundësi të autorësisë së Muhamedit a.s. për shumë arsye:

- E para: Sikur të ishte Kur'ani vepër e tij, atëherë ai në të do ta futte vetveten; brengat, dëshpërimet e tij, sepse e dimë se Muhammedi për një vit i humbi bashkëshorten Hatixhen dhe xhaxhain Ebu Talibin, të cilët i pati mbështetje të vetme kur filloi të ftojë në Islam. Dhembja e tij për ta ishte e madhe, sepse vdekja e tyre ishte humbje e pakompensueshme. Por, megjithatë, në Kur'an nuk theksohet asnjë lajm i vetëm. Gjithashtu Muham-

medit a.s. i vdes djali i tij Ibrahim. Ky atij i dhimbet dhe qanë për të, por në Kur'an për këtë s'ka kurrfarë gjurme. Kur'ani është plotësisht i abstraksionuar nga personaliteti i Muhammedit.

Jo vetëm kjo. Ndodh, përkundrazi, të shpallet ndonjë ajet porosia e të cilit është e kundërt me atë që e vepron dhe mendon Muhammedi a.s. Ndonjëherë vjen ajeti si qortim për ndonjë qëndrim të tij, si rasti i cili i ndodhi me nje riun e verbër nga i cili ai e ktheu kokën derisa zhvillonte bisedë me liderët kurejshitë. Kur'ani për këtë thotë:

“U vrenjt dhe ktheu kokën për arsye se i ka ardhur i verbëri. Çka di ti, ndoshta mu ai i verbëri veten do ta pastrojë ose do ta pranojë këshillën e cila do t'i sjell dNoëbKi..u.”r'a(nAbkeased1h-e4)a.jete në të cilat kritikohet ndonjë veprim i Muhammedit si: “Nuk i ka hije asnjë pejgamberi të ketë robër gjersa nuk shënon fitore në Tokë. Ju i doni të mirat e kësaj bote, ndërsa Allahu ua dëshiron Ahiretin. Po të mos ishte libri prej Allahut i cili ka ardhur më parë, juve do t'ju qëllonte dënimi i madh për atë që keni marrë.” (El-Enfâl, 6S-h7p)e.shherë Kur'ani i urdhëron Muhammedit a.s. që t'u thotë ithtarëve të tij edhe atë të cilën nuk do të mund t'ua thoshte sikur të ishte ai autor:

“Thuaj! Unë nuk jam zanafillë e pejgamberëve dhe nuk e di se çdo të bëhet me mua dhe me ju...” (El-Ahkâf, 9).

Nuk ka pejgamber i cili vullnetarisht vetvetiu do t'u thoshte ithtarëve të vet: unë nuk e di se çdo të bëhet me mua dhe me ju. Nuk mundem vetes sime t'i sjell as dëm as dobi e as juve këtë nuk mund t'ua bëj. Sepse, kjo do të ishte e mjaftueshme që prej tij të largohen ithtarët e tij.

Kjo pikërisht edhe ndodhi. Çifutët e morën këtë ajet si shkas për qëndrimin e tyre ndaj Të dërguarit duke thënë: Çfarë dobie nga ky pejgamber i cili nuk di se çka do të bëhet me të dhe me ne. Prej tij njeriu nuk ka kurrfarë dobie.

Ajetet e këtilla dhe të ngjashme është e pamundur që t'i përpilonte Pejgamberi sikur Kur'ani të ishte vepër e tij.

- E dyta: Nëse pas kësaj e shikojmë tekstin kur'anor, do të shohim se ai është unikat në pajtueshmërinë, strukturën dhe në teknikën e tij të shprehurit. Nuk ka shembull as në letërsinë arabe, në atë klasike dhe të re. Gjuha e tekstit kur'anor është e atillë saqë të duket se ai ndahet në poezi, prozë dhe Kur'an. Gjendesh para të folurit i cili është i përpiluar dhe thurur në mënyrë të veçantë, i cili më nuk është as prozë e pastër e as poezi. Muzika e poezisë është e kushtëzuar me metrikën dhe rimën. Kështu e degjojmë poetin Ibnul-Ebras El-esedi duke kënduar:

“E kafrun min ehlihi abidu fe lejse jubdi vela juidu”.

Nga ky varg shohim se muzika formohet prej pjesëve dyfish të rimuara dhe prej rimës në “dal” të gjatë. Kjo është muzika e jashtme e vargut. Ndërkaq, ajo e Kur'anit është muzikë e brendshme. P.sh.

“Vedduhâ vel-lejli idhâ sexhâ.” - “Pasha paraditën! Pasha natën kur shtrinë errësirën!” (Ed-Duhâ, 1-2). Nga ajeti i cituar shihet se nuk ka pjesë dyfish të rimuara as rimë, por, muzika megjithatë ekziston, dhe atë muzika e brendshme. Të shikojmë edhe disa ajete:

“Rabbi inni vehenel adhmu minni veshtealerre ‘su shejben. Ve lem ekun biduâike rabbi shekijjen”. - “O Zoti im, eshtrat më janë dobësuar dhe tharë, flokët dhe mjekra më janë zbardhur. O Zoti im, nuk kam qenë asnjëherë i refuzuar për gjithçka që të jam drejtuar me dua.” (Merjem, 4).

“Tâhâ! Ma enzelna alejkel Kur'âne liteshkâ. Il-la tedhkireten limen jahsha. Tenzilen mimmen halekal erda ves- semavatil-ul. Err-Rrahmânu al-el-arshisteva” - “Tâhâ! - Ne nuk ta kemi shpallur Kur'anin që ti të ndiesh mundim dhe vështirësi, por si vërejtje atij i

cili në zemër ndien frikë. I shpallur është prej Atij i cili e ka krijuar Tokën dhe qiejt e lartë. I Gjithëmëshirshmi mbisundon gjithësinë.” (Tâhâ, 1-5). Nëse shqyrtohen ajetet të cilat përmbajnë kërcënim, qartë shihet se ato vetë sikur shndërrohen në gërryerje guri dhe ritmi fiton zë plumbi i cili shurdhon veshët. Kjo bukur mund të shihet nga ajeti vijues:

“Inna erselna alejhim rihan sarsaren fi jevmi nahsin mustemirrin. Tenzi’unnase ke ennehum e’axhazu nahlin munkairin”. - “Ne dërguam mbi ta një erë të ftohtë në një ditë të kobshme e cila tmerrshëm gjëmoi dhe frynte panda. I shkulte dhe ngriste njerëzit sikur drunj hurmash, të shkukur mFjealërrt ë“nsjaër.”sa(rEeln-K”admhe “, 1m9u-n2k0a).irin”, sikur është secila gërryerje shkëmbi. Nëse ajeti sjell ndonjë lajm të tmerrshëm siç është ai për përfundimin e përmytjes (tufanit), shprehjet e fjalive janë të shkurtra sikur të ishin shenja telegrafike të Morseos dhe i tërë ajeti në realitet është telegram shumë i thukët i cili lë mbresë të fortë. Një ajat i tillë është edhe ky:

“Ve kîle ja erdoubleî mâeki ve jâ semâu aklii vegidal-mau ve kûdije lemru” - “Dhe është thënë: Oj Tokë, thithe ujin tënd! O qiell ndalu! Dhe uji u tërhoq (në tokë). Urdhri u zbatua.” (Hûd, 44). Ky lloj i ngjyrshmërisë në gdhendjen e fjalëve, në ndërtimin e fjalive, në ritmin e vetë fjalëve me kuptimet dhe ndjenjat në Kur’an, e arrin kulmin dhe gjithnjë vjen në vendin përkatës, pa kurrfarë ngarkese dhe shtrëngimi.

- E treta: Nëse shkojmë në analizë më të thellë (të tekstit kur’an- or), do ta zbulojmë precizitetin e përkryer dhe ligjshmërinë e mrekullueshme. Secili harf është në vendin e tij përkatës pa kapërcim përpara e as vonim. Asnjë fjalë nuk mund të zëvendësohet me tjetrën e as shkronjat e të mos humbet radhitja, harmonia etj., që e bëjnë të përkryer vetë tekstin. Sikur secila fjalë me kendarin më të saktë të jetë zgjedhur prej milion e më tepër

fjalëve. Ky precizitet kulminant, siç do të shohim më vonë, është i papërsëritshëm. Psh. fjala “levakihi” në ajetin:

“Ve erselnerrij’aha levakiha” - “Ne i kemi dërguar erërat të cilat mbarësojnë...” (El-Hixhr, 22). Në të kaluarën ky ajet komentohej si alegori: erërat i shtynë retë e bie shi i cili tokën e bën pjellore. Sot megjithatë, është fakt i njohur se era i shtynë retë me elektricitet pozitiv dhe ato ndeshen me retë e elektrizuara me elektricitet negativ. Atëherë shkaktohet vetëtimja, murmurima dhe fillon të bie shi. Ja, edhe në atë mënyrë erërat kryejnë një lloj mbarësimi. E dimë, po ashtu, se era e shpërndanë pluhurin mbarësues prej lules në lule me ç’rast e bënë mbarësimin në kuptim të plotë.

Ne këtu pra, jemi para një fjale e cila vërtet e kryen funksionin e vet në kuptim të bartjes me kuptim të vërtetë e shkencor. Kjo fjalë përveç kësaj është edhe e bukur. Ka mundësi që kjo fjalë në mënyrë më të bukur të përdoret në format artistike dhe letrare. Ajo ka edhe ritëm mjaft të harmonishëm.

Saktësinë e përkryer në zgjedhjen e fjalës e cila në mënyrë më të bukur do ta transmetonte kuptimin, porosinë, mendimin e caktuar etj., e gjejmë edhe në shumë ajete të tjera si psh. ky të cilin po e citojmë vetëm në përkthim:

“Mos ia hani pasurinë njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar dhe mos u shkoni gjykatësve dhe administruesve që në atë mënyrë ta grabitni pasurinë e huaj dhe padrejtësisht ta hani e kënaqeni, e veçmas kur e dini se është ashtu...” (El-Bekare, 188). Në ajetin e theksuar është përmendur fjala “tudlu”. Edhe pse ai të cilit i jepet pasuria (ai i cili merr kapital) është “lart” e jo “poshtë”, Kur’ani çdo gjë e vë në vendin e merituar dhe thotë “dora e cila merr mitë është dorë e poshtër”, po edhe në qoftë se ajo është dora e sundimtarit. Prandaj, në këtë ajet thuhet “tudlu biha ilel hukkami” dhe kështu me një stil të përsosur është thënë për gjithë ligësinë e atij i cili pranon mitën si dhe për poshtërsinë e tij.

Ta marrim edhe ajetin në të cilin flitet për luftën në rrugë të Zotit.

“Çka keni kur ju thuhet të dilni dhe luftoni në rrugë të Zoti, ju mbeteni sikur të ishit të gozhduar përtoke...” (Et-Tevbe, 3K8u)r.’ani këtu e ka përdorur fjalën “iththâ’kaltum” në vend të fjalës “tethâ’kaltum”... i ngjet dhe përputh shkronjat ashtu që të shpreh në mënyrë sa më të qëlluar sjelljet e frikacakëve të cilët ngjiten përtoke dhe “ngadalë ecin” nga frika kur do të thirren të luftojnë në rrugë të Zotit, andaj edhe vetë shkronjat prej të cilave përbëhet kjo fjalë janë të radhitura ashtu që besnikërisht ta shprehin atë” “ecje të ngadalshme”.

Ajeti i cili flet për mbytjen e fëmijëve prej frikës nga varfëria, ka ardhur në dy forma të ndryshme:

“Mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë. Ne ju furnizojmë edhe juve edhe ata.” (El-En’âm, 151).

“Mos i mbytni fëmijët tuaj duke iu frikësuar varfërisë. Ne i furnizojmë ata, edhe juve.” (El-Isrâ 31).

Ndryshimi në mes të dy ajeteve nuk është bërë rastësisht, por për shkaqe të arsyeshme. Në ajetin e parë kemi të bëjmë me varfërinë e cila është e pranishme. Do të thotë, njerëzit janë të varfër, andaj Kur’ani u drejtohet me fjalët “Ne ju furnizojmë edhe juve edhe ata”.

Ndërkaq, në ajetin e dytë fjala është për varfërinë si mundësi. Andaj Kur’ani u drejtohet fëmijëve dhe qartë ua bën me dije që “Ne i furnizojmë ata, e edhe juve”. Vetëm Kur’ani ka mundur kështu t’i precizojë gjërat dhe askush tjetër.

Në situatat e nxjerrjes së një fjale para tjetrës dhe anasjelltas, gjithmonë shohim se ajo është bërë me arsye dhe urtësi. Fjala vjedhës psh. në ajet ka ardhur para fjalës vjedhëse, ndërsa fjala lavire, në ajetin në të cilin flitet për kurvërinë, është nxjerrur para

fjalës lavir. Kjo është bërë kështu sepse mashkulli më tepër i është nënshtruar vjedhjes se sa femra, ndërsa në rastin e kurvërisë femra e merr iniciativën dhe me vetë pamjen e jashtme të saj mashkullit ia përgatit kurthin:

“Laviren dhe lavirin, secilin prej tyre veç-e veç, rrahne me nga njëqind shkopinj.” (En-Nûr, 2).

“Vjedhësit dhe vjedhëses preniu duart (si dënim).” (El- Máide, 38). Ashtu në Kur’an të dëgjuarit është vënë para të pamurit në më tepër se 16 vende:

“U ka dhënë veshët, sytë dhe zemrat...” (En-Nahl, 78).

“U kemi dhënë juve dëgjimin, pamjen dhe zemrat.” (El-Ahkâf, 26).

“Sa mirë, ata çdo gjë do ta dëgjojnë dhe do ta shohin.”

(Merjem, 38).

“Vërtet për veshët, sytë, zemrat, për të gjitha këto do të jepet përgjegjësi.” (El-Isrâ, 36).

“A nuk do të fshiheshit ju sikur kundër jush të mos dëshmonin veshët e juaj dhe sytë e juaj.” (Fussilet, 22).

“Atij asgjë nuk i përngjet. Ai është Ai i cili çdo gjë dëgjon dhe sheh.” (Esh-Shûrâ, 11).

Gjithmonë pra, së pari është përmendur të dëgjuarit e pastaj të pamurit. Dëgjimi është, pa dyshim, më i ndijshëm dhe më i përkryer se sa të pamurit. Xhindët i dëgjojmë e nuk i shohim. Pejgamberët e Zotit e kanë dëgjuar Allahun xh.sh. se si flet, kanë biseduar me Të, por asnjë pejgamber nuk ka mundur ta shohë Atë. Muhammedi a.s. Kur’anin e ka pranuar me anë të dëgjimit. Nëna e dallon vajin e fëmijës së saj në ndonjë turmë të madhe edhe nëse nuk e sheh me sy. Të dëgjuarit nuk e lëshon njeriun

edhe gjatë kohës së gjumit, përderisa sytë flejnë veshët janë të zgjuar. Ai i cili është mirë i udhëzuar në anatomi e di mjaft mirë që veshi është më preciz se syri.

E njëjta gjë është edhe me nxjerrjen e fjalës pasuri para fjalës fëmijë.

“Atë ditë nuk sjell dobi pasuria e as fëmijët. Vetëm do të jetë i shpëtuar ai i cili i vjen Allahut me zemër të pastër.” (Esh- Shûarâ, 88).

“Vërtet pasuritë tuaja dhe fëmijët tuaj janë provë, ndërsa te Allahu ka shpërblim të madh...” (Et-Teg’âbun, 15).

“Vërtet, pasuritë e tyre dhe fëmijët e tyre, atyre nuk do t’u sjellin dobi. Ata janë shokë të zjarrit në të cilin do të mbeten përgjithmonë.” (Âli Imrân, 116).

“A mendojnë ata se do t’i ndihmojmë me pasuri dhe fëmijë dhe se do t’ua shpejtojmë të mirat. Ata nuk ndiejnë.” (El-Mu’minûn, 55). “Mos t’ju pëlqejë pasuria as fëmijët e tyre. Zoti vetëm do që me to t’i dënojë në jetën e kësaj bote.” (Et-Tevbe, 55). “Dine, vërtet jeta e kësaj bote është vetëm lojë, zbavitje, stolisje dhe garim i ndërsjellë në shtimin e pasurisë dhe fëmijëve, sik urse shiu i madh pas të cilit bima rritet...” (El-

HShaedmîdb, u2j0)të. nxjerrjes së pasurisë përpara fëmijëve në Kur’an ka

shumë. Sekreti i kësaj qëndron në faktin se pasuria te shumica dërrmuese e njerëzve paraqet thesar më të madh se sa fëmijët. Në tekstin kur’anor pastaj gjejmë precizitetin e përkryer, butësinë dhe misterin tërheqës në vetë ndryshimin e fjalëve. Ta marrim vetëm këtë ajet:

“Ve in tâifetâni minel mu’minîne-ktetelû fe aslihû bejnehumâ”
- “Nëse dy grupe besimtarësh lëshohen në luftë pajtoni ata...” (El-

Huxhurât, 9). Në këtë ajet njëherë është përmendur shumësi (Iktetelu - luftojnë), ndërsa herën e dytë dytësia (fe aslihu bejnehumâ = pajtoni ato dy grupe), ndonëse në ajet flitet vetëm për dy grupe. Ku është fshehtësia? Gjatë kohës së betejës dy palët ndërluftuese bëhen një grup në të cilin gjuan kush kënd e zë. Ndërkaq, në kohën e pajtimit përsëri vjen deri te ndarja dhe formimi i grupeve të veçanta.

Bile edhe paraqalët dhe lidhëset të cilat i gjejmë në tekstin kur'anor, janë të vendosura ashtu që do të humbej harmonia në tekst dhe përmbajtje, po qe se rastësisht lëshohen ato. Pas çdo paraqale dhe lidhëseje qëndron arsyeja më e thellë dhe parallogaria më precize. Për këtë është karakteristike fjala “jes’eluneke” e cila në Kur’an është përmendur në shumë vende:

“Jes’eluneke mâdhâ junfikûne, Kulilafv...” - “Të pyesin çka të ndajnë. Thuaj: Tepricën!” (El-Bekare, 219).

“Jes’elûneke anirr-rrûhi kulirr-rrûhu min emri rabbî...” - “Të pyesin ty për shpirtin, Thuaj: shpirti është çështje e Krijuesit”. (El-Isrâ, 85).

“Jes’eluneke anil-ehil-leti. Kul hije mevâkîjtu linnâsi vel-haxhxh”. - “Të pyesin për hënat e reja. Thuaj: Ato janë udhërrëfyes kohe për njerëzit dhe për haxhxh.” (El-Bekare). Të gjitha ajetet e përmendura shohim se përgjigjja në pyetje vjen me fjalën “Thuaj”, por në ajetin në të cilin të folurit është për kodrat, vjen deri te ndryshimi i fjalës “Thuaj”:

“Jes’elûneke anil-xhibâlî, fekul jensifuhâ rabbî nesfen”, - “Të pyesin ty për kodrat. Por ti thuaju: Zoti im ato do t’i bëjë hi e pluhur.” (Tâhâ 105). Këtu në vend të fjalës së zakonshme “thuaj” është përdorur edhe fjala “por”. Arsyeja është si vijon: Në të gjitha ajetet e mëparshme fjala është për pyetjet të cilat vërtet i janë shtruar Muhammedit a.s. Mirëpo në ajetin në të cilin është fjala për kodrat, nuk kemi pyetje të drejtpëdrejtë. Sikur Allahu xh.sh. thotë:

E në qoftë se të pyesin për kodrat, por (atëherë) thuaj: Pra, “por” këtu është përdorur majft me mençuri dhe me arsye të thellë. Në ajetin: “Kur robtë e Mi të pyesin për Mua. Unë jam shumë afër. I përgjigjem lutjes së atij i cili më lutet...” (El-Bekare, 187), shohim se nuk është përdorur fjala “thuj”. Kjo është për arsye se në këtë ajet flitet për Zotin, dhe se Zoti është më kompetent që të japë përgjigje në pyetjen për Vetveten. E ngjashme është çështja edhe me përemrat vetorë të vetës së parë në njëjës dhe shumës (ene dhe nahnu).

Zoti xh.sh. flet për Vete në vetën e parë shumës kur është fjala për veprën e Tij në të cilën janë inkuadruar më tepër se një veti e Tij siç janë krijimi, shpallja dhe ruajtja e Kur’anit:

“Vërtet, Ne e kemi shpallur Kur’anin dhe pa dyshim Ne do ta ruajmë atë.” (El-Hixhr, 9);

“Ne juve ju kemi krijuar! Përse atëherë nuk besoni?” (El- Vâkia, 57);

“Vërtet, Ne e kemi shpallur Kur’anin në një natë të vlefshme dhe të ndershme (Lejletu-l Kadër).” (El-Kadr, 1).

“A doni t’i kushtoni ju sadopak kujdes atij embrioni jetësor. A e keni krijuar ju atë, apo e kemi krijuar Ne.” (El-Vâkia, 5“8N-e59i).kemi krijuar ata dhe i kemi forcuar pjesët e trupit. Sikur të duam Ne do t’i zëvendësojmë me njerëz tjerë të ngjashëm.” (El-Insân, 28). Në të gjitha këto ajete është përdorur përemri vetor i vetës së parë shumës, sepse flitet për veprat e jashtëzakonshme në të cilat marrin pjesë disa attribute të Zotit xh.sh. Ndërkaq në ajetet në të cilat nuk është fjala për vepra të tilla, apo të ngjashme, Zoti xh.sh. kur flet për Vete, flet në vetën e parë njëjës. Kështu p.sh. në ajetin në të cilin flitet për bisedën e Zotit xh.sh. me Të dërguarin e Tij, Musën a.s., është përdorur përemri vetor i vetës së parë njëjës:

“Vërtet vetëm Unë jam Zot, Përveç Meje zot tjetër nuk ka. Andaj vetëm Mua më adhuro, vetëm Mua falmu, që të më përkujtosh Mua...” (Tâhâ, 14). Zoti xh.sh. këtu flet për Vete në vetën e parë njëjës, sepse është prania e Qenies dhe sepse deshirohet të tërhiqet vërejtja për monoteizëm të pastër në adhurim. Precizitetin në shprehje, për të cilin folëm deri më tash, e gjejmë edhe në ajetet tjera. Kështu p.sh. në dy ajetet për durimin (sabrën) ekziston dallimi në përfaqësimin apo mospërfaqësimin e tingullit “el”:

“Dhe bëhu i durueshëm në gjithçka që të godet në këtë punë. Vërtet kjo është më së miri dhe më së drejti.” (Lukmân, 17);

“Kushdo që përmbahet, bën durim e fal, vërtet kjo është prej veprave të mëdha, më të rëndësishme dhe më të mira.” (Esh-Shûrâ, 43).

Në ajetin e fundit ka ardhur dëshmia e madhësisë dhe rëndësisë së durimitarit, sepse ka të bëjë me durueshmëri të dyfishtë: durimitarit padrejtësia i është bërë dhe prej tij po kërkohet durim dhe falje. Kjo gjithsesi është shumë më vështirë të përballohet se sa kur ka të bëjë me durimin në caktimin e Zotit, në fatin të cilit nuk mund t’i iket.

Të njëjtin rast me tingullin “el” e gjejmë edhe në ajetet në të cilat flitet për rënien e shiut dhe mugullimin e bimëve:

“Pse ju nuk e vështroni ujin që e pini? A e lëshoni ju nga retë, apo Ne e lëshojmë. Po të dëshironim do ta bënim të njelmët.” (El-Vâkia 68-70);

“Pse ju nuk shikoni dhe nuk i kushtoni kujdes asaj që e mbillni? A jeni ju ata që e bëni të mbijë ajo, apo e bëjmë Ne. Sikur të dëshironim mund ta bënim aq të thatë saqë e gjitha të shkatërrohet.” (El-Vâkia 63-65).

Në ajetin e parë fjala “Xhealnâhu” është përdorur e pavarur, ndërsa në të dytin ka ardhur me pjesëzën përforcuese “le xhealnâhu”, do të thotë “Ne mesiguri do ta bëjmë aq të thatë...” “El” këtu ka ardhur nga arsyeja se do të gjendet dikush i cili do të shtihet kinse mund t’i shkatërrojë të mbjellat ashtu siç mundet Krijuesi, derisa është e sigurt se askush që është i mençur nuk do të pohojë se mund ta lëshojë shiun nga retë. Andaj dhe nuk ka qenë e nevojshme që për lëshimin e shiut prej reve veçmas të theksohet se ajo punë është ekskluzivisht në mundësinë e Allahut xh.sh. T’i marrim edhe ajetet në të cilat flitet për të folurit e Ibrahimit a.s. për Zotin xh.sh.:

“I cili më bën të vdes, pastaj më ngjall.” (Esh-Shûrâ, 81).

“I cili (Ai) më ushqen dhe më jep ujë.” (Esh-Shûrâ, 79).

Në ajetin në të cilin flitet për të ushqyerit, pas përemrit lidhor është përmendur përemri vetor “Huve - Ai” që nuk është rasti me aje tin në të cilin flitet për dhënien e vdekjes dhe ringjalljen. Ku është arsyeja? Gjithmonë do të gjenden të atillë të cilët do të thonë se ata janë të cilët ushqejnë (furnizojnë) dhe japin ujë ndërsa askush nuk do të ketë guxim të pohojë se mund të shkaktojë vdekjen apo ringjalljen e dikujt. Të tilla janë edhe ajetet në të cilat Allahu xh.sh. u drejtohet muslimanëve dhe ithtarëve të “Librave të shenjtë”. Është shumë evident ndryshimi në vetë drejtimin. Në rastin e parë kemi:

“Ju vetëm Mua më përmendni dhe vetëm Mua më përkujtoni, e edhe Unë juve do t’ju përkujtoj”, (El-Bekare, 152), ndërsa në të dytin.

“Përkujtoni begatitë e Mia të cilat ua kam dhuruar.” (El- Bekare, 40). I njëjti rast është edhe kur Kur’ani u drejtohet atyre që kuptojnë dhe atyre që nuk kuptojnë:

“Frikësomuni Mua, o ju të mençur!” (El-Bekare, 197), thotë Kur’ani duke iu drejtuar atyre që kuptojnë. Të tjerët i porositi: “Ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët”, (El-Bekare, 24), sepse këta vetëm zjarri mund t’i Pfreencoizjëtin e përmendur në zgjedhjen e fjalëve me të cilat më së miri do të shprehet mendimi i dëshiruar, e gjejmë edhe në ajetet në të cilat Iblisi i betohet Zotit se do t’ia dalë që t’i mashtrojë njerëzit:

“Betohem në fuqinë Tënde, të gjithë do t’i shmangë nga rruga dhe do t’i bëjë të varur.” (Sâd, 82). Iblisi betohet në fuqinë e Zotit, e jo me tjetër gjë. Me këtë ai vërteton diturinë dhe mendje mprehtësinë e tij. Mëshira e Zotit është mbi çdo gjë tjetër, pra Zotit askush dhe asgjë nuk i nevojitet. Andaj dhe kush do le të besojë në Të, e kush s’do, mos të besojë. Atij askush dhe asgjë nuk mund t’i bëjë gjë. Ai në hadithikudisij thotë: “Këta janë për xhennem dhe Unë s’mërzitem, kurse këta për xhennet dhe Unë prapë s’mërzitem”. Kjo i takon fuqisë dhe madhërisë së Zotit xh.sh. Kjo është ajo e cila Iblisit i lë hapësirë për veprimin e tij. Ai mund t’i largojë nga rruga dhe t’i shpjerë në mashtrim, sepse Zoti xh.sh. askënd nuk do ta detyrojë që të besojë apo të mos besojë. Andaj dhe Iblisi betohet me fjalët: “Betohem në fuqinë Tënde se të gjithë ata bashkë do t’i largoj nga rruga”:

“.. Unë do t’ua vendos kurthin në mënyrë që t’i shmangë nga rruga e drejtë. Do t’u vijë nga para dhe nga prapa, nga e djathta dhe nga e majta...” (El-A’raf, 16-17). Këtu mund të shihet se Iblisi i ka përmendur të katër anët. Mirëpo, nuk ka përmendur se njerëzve do t’u vijë “nga lart” dhe “nga poshtë” (fevka - tahte), sepse “lart” është sundimi ndërsa “poshtë” devotshmëria. Ai i cili i është përlur Zotit, atij Iblisi (djalli) assesi nIbulkisimmunëdtut’tijefatrhoehkesto. n se do ta përdorë gjithë shkathhtësinë e tij për t’i larguar nga rruga e drejtë, pastaj edhe prej sjelljeve të mira dhe prej namazit. Atij të cilin nuk e stolisin

virtytet e mira as që i nevojitet Iblisi, sepse ai vetveten e mashtron dhe e largon nga rruga e drejtë. Iblisi është vjedhës shumë mendjemprenhtë dhe i mençur i cili nuk humb kohën e shtrenjtë për t'i vizituar shtëpitë e zbrazëta e të rrënuara.

Në ajetet kur'anore pastaj gjejmë se kur është fjala për faljen dhe dënimin, mëshirën dhe hidhërimin, falja dhe mëshira janë të theksuara para dënimit dhe hidhërimit. Kështu në suren Fâtiha thuhet se Zoti xh.sh. “Është i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëplotë” para se të thuhet se Ai është “Sundues i Ditës së gjykimit”. Në vendet ku flitet se Zoti ia fal kujt të do, ndërsa e dënon kë të dojë, falja është përmendur para dënimit, përveç në dy vende: në ajetin i cili ka të bëjë me prerjen e dorës: “E dënon kë të dëshirojë, ndërsa ia falë kujt të dojë.” (El- Mâide, 40). Kjo vjen nga fakti se dënimi me prerje të dorës është dënim i kësaj bote, pas të cilit vjen falja në Ahiret. Në ajetin në të cilin Isa a.s. flet për ata të cilët e kanë adhuruar, thuhet: “Nëse i dënon, ata janë robërit Tu, ndërsa nëse ua fal, Ti je i Madh në Mundësinë Tënde dhe i urtë në Gjithëditurinë Tënde.” (El-Maide, 118). Këtu nuk thotë Ti je më i mëshirshmi dhe ai i cili më së shumti falë, nga kurtuazia. Dënimin e përmend para faljes për shkak të madhësisë së mëkatit të cilin e kanë bërë. Precizitetin e lartpërmendur e gjejmë edhe në ajetet në të cilat flitet për kohën. Ardhmëria përmendet në kohë të kaluar. Kështu ngjarjet e Ditës së gjykimit janë theksuar sikur tashmë të kishin ndodhur:

“I është fryrë burisë (surit).” (El-Kehf, 99).

“Edhe qielli është çarë dhe fuqia e tij atë ditë ka rënë.” (El-Hâkka, 16);

“Dhe xhehennemi u është dëftuar të humburve.” (Esh-Shuarâ, 91); “Dhe janë paraqitur para Zotit tënd të radhitur.” (El-Kehf, 4T8ë).gjitha këto ajete i përkthyer në kohën e kaluar ashtu siç qën- drojnë në tekstin kur'anor, edhe pse është i njohur fakti se

këtu koha e ardhshme është shprehur me kohë të kaluar. Sekret i kësaj qëndron në atë se të gjitha ngjarjet, të tashmet dhe të ardhmet, tashmë kanë ndodhur në diturinë e Zotit e cila është absolute dhe si e tillë nuk është e përkufizuar as me kohë as me hapësirë. Kështu në një ajet gjejmë të flitet për dy kohë plotësisht të ndryshme, andaj na duket se janë kontradiktore, në çka edhe gabojmë: “Caktimi i Zotit ka ardhur, andaj mos e ngutni-shpejtoni.” (En-Nahl, 1). Caktimi ka ardhur dhe ka ndodhur. Zoti xh.sh. u thotë njerëzve që mos ta ngutin caktimin e Tij, si të mos kishte ndodhur. Pra, caktimi ka ardhur në diturinë e Zotit, por ende jo edhe në të njerëzve. Nuk është fjala, siç shihet qartë, për kundërthënie dhe kontradikta, por për saktësi të stërholluar në shprehje, për ligjshmëri, për fshehtësi, zbulim dhe gjetje të urtësive, sekreteve dhe të vërtetësive të kuptimeve të thella kur’anore.

Këtu theksuam vetëm disa shembuj të cilët mjaft qartë flasin për saktësinë e përkryer të Kur’anit në zgjedhjen e fjalëve, ndryshimin e tyre, në zgjedhjen e vetë shkronjave etj. Askund në tekstin kur’anor asgjë nuk është e tepërt e as e mangët. Gjithçka është në vendin e vet përkatës.

Për ajetet kur’anore në të cilat theksohen të vërtetat shkencore, pastaj për ajetet të cilat flasin për fshehtësitë e gjithësisë, që njeriu sot e kësaj dite po i zbulon, do të flasim me një rast tjetër.

Përktheu: Miftar Ajdini

KUR'ANI ËSHTË SHPALLJE E ZOTIT

I thashë mikut:

Ndoshta biseda jonë e sotme për të vërtetat shkencore në Kur'an do të jetë më interesante nga diskutimet tona të gjertanishme, duke marrë parasysh marrjen tënde me shkencë dhe insistimin tënd për gjithçka ekskluzive në të vërtetat dhe argumentet shkencore. Këtu duhet të thuhet edhe kjo se atë që e ka thënë Kur'ani për qiejt, Tokën, yjet, planetët, spermën, embrionin dhe formimin e njeriut në kohën kur për dituritë shkencore, astronominë, gjeologjinë, anatominë, atomistikën etj., nuk ka patur kurrfarë gjurme, shkenca vetëm në kohën më të re po i zbulon. Mirëpo, Kur'ani nuk është marrë me këto çështje dhe nuk i ka paraqitur deri në detaje siç e bën këtë p.sh. një vepër e cila këtë e ka lëmë të ngushtë, sepse Kur'ani në radhë të parë është libër besimi i cili ka për qëllim që ta rregullojë jetën e njeriut dhe të vendosë marrëdhënie më të mira dhe më njerëzore ndërmjet njerëzve. Nga ana tjetër, sikur Kur'ani rastësisht, të kishte hyrë në detaje dhe në të gjitha finesat e mundshme, atëherë ata të cilëve iu drejtua do t'i vënte në situatë të vështirë, sepse do t'u fliste me gjuhën të cilën atëherë nuk do të mund ta kuptonin. Andaj Kur'ani në komunikimin e së vërtetës u shërbye me metodën e tregimit, kontaktit dhe tërheqjes së vëmendjes në faktet të cilat shkencat do t'i zbulojnë pas qindra vjetëve, që e gjithë kjo së bashku më së qarti u ka folur gjeneratave të cilat kanë ardhur, se Kur'ani është vepër e Zotit dhe Shpallje e Tij për njerëzimin.

“Ne atyre së shpejti do t'ua tregojmë argumentet Tona në horizontet dhe në veten e tyre. Atëherë atyre do t'u bëhet plotësisht e qartë se Kur'ani është i vërtetë. A nuk mjafton që Krijuesi yt në gjithçka është dëshmitar.” (Fussilet, 53). Meqë ata të cilëve iu drejtua Kur'ani nuk u kënaqën vetëm me dëshminë e

Zotit që Kur'ani është vepër e Tij andaj u bë e domosdoshme që ajo t'u tregohet edhe me këto argumente. Kështu Allahu xh.sh. thotë në Librin e Tij.

Vazhdimisht Kur'ani, nga dita në ditë, po zbulon gjithnjë e më te- për argumente dhe dëshmi të tilla të qarta. Kështu p.sh. në lidhje me rrumbullakësinë e Tokës, kanë ardhur këto ajete të qarta në të cilat është përdorur fjala “tekvir” që të përshkruajë e paraqesë lëshimin e natës dhe të ditës si dy gjysmëtopa: “...me natë e mbulon ditën, kurse dita shpie në natë.” (Ez-Zumer, 5). Pastaj kemi ajetin i cili e përshkruan rregullimin e Tokës: “... pastaj Tokën e ka rregulluar.” (En-Nâziât, 30). Fjala “duha” e cila është përdorur në këtë ajet është fjala e vetme në fjalor e cila ka kuptimin e shtrirjes dhe rrumbullakimit. Ndërkaq Toka, siç është e ditur, në dukje është e tillë, në realitet e rrumbullakët, përkatësisht në formë veze.

Pastaj lexojmë ajetet në të cilat flitet për notimin e bjeshkëve në lartësi, përkatësisht të Tokës, sepse ajo bashkë me bjeshkët përbën një tërësi:

“Dhe i sheh bjeshkët për të cilat mendon se pushojnë, ndërsa ato në realitet fluturojnë sikur retë. Kjo është vepër e Allahut i cili çdo gjë e ka krijuar dhe rregulluar në mënyrë të përkryer.” (En-Neml, 88). Bjeshkët të cilat duken se janë të palëvizshme, të qeta, në realitet lundrojnë nëpër kozmos. Në këtë ajet ekziston edhe një tregim i shkurtër edhe për një fakt tjetër. Fjala është për formimin e materies nga atomet ashtu siç përbëhen retë prej pikave. E gjithë kjo është thënë duke i krahasuar bjeshkët me retë.

102

Në Kur'an hasim edhe në ajete në të cilat flitet për ndërrimin e ditës dhe të natës, për caktimin preciz të kohës së tyre, për fillimin e krijimit e deri në fund të vazhimit të tyre.

“As Diellit nuk i duhet ta arrijë Hënën, e as nata ta kapërcejë ditën.” (Jâsîn, 40). Aty janë pastaj edhe ajetet tjera në të cilat flitet për formën e Tokës si të topit, sikur edhe kur është fjala për fillimin e natës dhe ditës bashkërisht në të njëjtën kohë qysh prej krijimit si dy gjysmëtopa. Mirëpo, sikur Toka të ishte e rrafshtë, dita dhe nata domosdo do të vinin njëra pas tjetrës. Kur të vie Dita e gjykimit, Toka përsëri do të jetë njëkohësisht në natë dhe në ditë, ashtu siç ka qenë edhe në ditën e “Akrsihjitmuitq: ë kur Toka të stoliset me bukuri të ndryshme dhe qëndiset me petkun e vet dhe banorët e saj binden se mund ta mbledhin frytin, vjen caktimi Ynë, natën ose ditën, dhe Ne ato i bëjmë si të korrura, si të mos kishin qenë dje fare.” (Jûnus, 24). Në fjalët e Zotit “natën ose ditën” gjendet vërtetimi i kësaj kohe të cilën nuk mund ta shpjegojmë ndryshe, por që njëra anë e Tokës është e fshehur prej Diellit dhe gjendet në terr, ndërsa ana tjetër e ekspozuar Diellit dhe me të e ndriçuar, që del nga forma e rrumbullakët e Tokës. Andaj edhe është thënë: “... dhe as nata ta tejkalojë ditën.” (Jâsîn, 40). Pastaj kemi edhe theksimin e shumë lindjeve dhe shumë perëndimeve, si në ajetet:

“... E marr për dëshmitar Krijuesin dhe Sunduesin e lindjeve dhe të perëndimeve.” (El-Meârixh, 40); “Ai është Krijues dhe Sundues i dy lindjeve dhe dy perëndimeve.” (Err-Rrahmân, 17). Po të mos ishte Toka ajo që është, do të ishte vetëm një lindje dhe një perëndim. Njeriu, thuhet në Kur’an, djallit të vet në Ditën e gjykimit do t’i thotë: “Çfarë fati sikur të ishim të larguar njëri prej tjetrit sa është larg vendi i lindjes së Diellit prej vendit të perëndimit të tij.” (Ez-Zuhruf, 38). Në Tokë nuk ka largësi më të madhe se largësia e lindjes dhe perëndimit të Diellit përveç nëse është Toka e rrumbullakët. Në kontekst të këtyre ajeteve bëjnë pjesë edhe ato (ajete) në të cilat flitet se qiejt kanë orbitat e veta, zonat dhe rrugët:

“... dhe qielli me rrugë yjesh.” (Edh-Dhârijât, 7),

“... dhe qielli i cili kthen...” (Et-Târik, 11), do të thotë i cili kthen në Tokë gjithçka që ngrihet; avullin e ujit e kthen në formë të shiut, trupat e ndryshëm me gravitetin e Tokës, radio-valët me reflektim nga jonosfera siç i kthen rrezet ngrohëse infra-të kuqe të reflektuara dhe kështu e nxen natën. Siç e kthen qielli atë që në të “hedhet” nga Toka, ai po ashtu thithë, reflekton dhe shpërndanë atë që në të “hedhet” prej “botës së jashtme” dhe në atë mënyrë e mbron dhe ruan Tokën nga torpilat vdekjeprurës të rrezeve kozmike dhe të rrezeve ultra-vjollcë. Si i tillë, qielli në realitet është pullaz i Tokës.

“Qiellin e kemi bërë kulm i cili është i ruajtur fort.” (El-Enbijâ, 32), “Dhe qiellin e kemi ngritur me forcën Tonë dhe Ne jemi në gjendje që të gjithë t’i mbajmë dhe ushqejmë.” (Edh-DNhëâkriçjâtët, 47e)t. flitet për të ashtuquajturën shtrirje e domosdoshme e kozmosit.

Në kohën e shpalljes së Kur’anit konsiderohej se atomi është pjesa më e vogël e materies dhe e pandashme më tej. Kur’ani vjen dhe flet në mënyrë precize për pjesët më të imta të materies se atomi, për pjesët përbërëse të vetë atomit. Kur’ani, përndryshe, është libri i parë i cili ka përmendur se atomi nuk është më i vogli:

“Diturisë së Zotit nuk mund t’i shmanget asgjë, as sa pesha e një atomi në qiej dhe në Tokë, dhe asgjë as më e madhe se ajo e as më e vogël.” (Sebe’, 3).

Të gjitha këto dëftime të shkurtra por plotësisht të qarta të Kur’anit për dukuritë mahnitëse dhe admiruese në kozmos, siç janë forma e rrumbullakët e Tokës, përbërja dhe natyra e kozmosit dhe e atomit, dhe atë në kohën kur për to askush nuk ka pas as përfytyrimin më elementar, flasin mjaft dhe në mënyrë më të qartë për origjinën hyjnore të Kur’anit, për embrionin e njeriut dhe formimin e tij, për spermën dhe aftësinë e saj për caktimin e gjinisë së të posalindurit:

“Ai është Ai i cili e ka krijuar çiftin, mashkullin dhe femrën, prej ujit të njeriut...” (En-Nexhm, 45). Pra fjala është për një fakt biologjik i cili sapo është bërë i njohur në kohën tonë. Ne sot themi se koka e spermës është e vetmja e cila i përbënë faktorët e determinimit të gjinisë. Kur’ani qysh në atë kohë flet për krahasimin e majeve të gishtërinjve, për shenjat e gishtërinjve, në kontekstin e të folurit për ringjalljen pas vdekjes.

“A mendon njeriu se nuk mund t’i tubojmë eshtrat e tij? Përkundrazi, Ne kemi mundësi që përseri dhe sakt t’i rregullojmë majet e gishtërinjve të tij.” (El-Kijâme, 34), do të thotë, përsëri do t’i formojmë edhe majet e gishtërinjve të tij dhe do t’i rregullojmë siç kanë qenë... Shumë më vonë është zbuluar se majet e gishtërinjve të gjithë njerëzit janë të ndryshme.

Kur’ani thekson se shtëpia më e dobët është ajo e merimangës. Zoti xh.sh. thotë shtëpia e jo peri i merimangës, sepse është e ditur se peri i merimangës është katër herë më i fortë se sa peri i ngjashëm me të. Fjala është për dobësinë e shtëpisë e jo të perit, sepse shtëpia e merimangës si e tillë është strehim i keq për atë që strehohet në të, kurth për atë që bie në të prej vizitorëve të huaj. Ajo është vdekjeprurëse edhe për anëtarët e tjerë të “familjes” së merimangës, sepse merimanga femër e ha mashkullin e saj pas mbarësimit. Ajo i ha edhe të vegjlit e saj pasi t’i bëjë, kurse edhe të vegjlit e hanë njëri-tjetrin.

Shtëpia e merimangës është shembulli më i mirë i strehimit të keq dhe përfundimit të keq, siç thekson Kur’ani. E ngjashme është edhe gjendja e atij i cili kërkon ndonjë strehim tjetër përveç strehimit të Zotit. Për këtë flasin këto ajete madhështore të Kur’anit:

“Shembulli i atyre të cilët në vend të Allahut xh.sh. marrin mbrojtës dhe ndihmës tjetër është sikurse shembulli i merimangës e cila vetes i ndërton shtëpi si vendbanim, por në të vërtetë,

vendbanimi më i dobët është shtëpia (rrjeti) e merimangës, sikur këtë ata vetëm ta dinin.” (El-Ankebût, 41). Përfundimi i këtij ajeti veçmas është karakteristik. Zoti xh.sh. thotë: “... sikur këtë ata vetëm ta dinin”, duke paralajmëruar se këtë njerëzit një ditë do ta kuptojnë. Është e ditur se shumë zbulime në këtë lëmi janë zbulime të reja të mëvonshme.

Në kaptinën e Kur'anit El-Kehf, një ajet në përkthim thekson: “Ata kanë qëndruar në shpellën e tyre treqind e nëntë vjet.” (El-Kehf, 25). Sot dihet se treqind vjet, sipas kalendarit diellor, janë të barabarta në ditë, orë, minuta dhe sekonda me treqind e nëntë vjet sipas kalendarit të Hënës.

Në kaptinën Merjem, Allahu i Lartmadhërishëm e paraqet situatën e Merjemes kur ajo në kohën e lindjes strehohet nën një dru të hurmës duke e dëshiruar vdekjen... kur ajo u thirr që ta shkundë pemën dhe t'i hajë hurmat e freskëta të cilat pikonin:

“... dhe dhembjet e lindjes e detyruan që të vijë te trupi i një hurmeje. Ajo tha: - Ku të kisha fat të kisha vdekur pa e pritur këtë dhe të isha harruar krejtësisht. Dhe u thirr nga poshtë me fjalët: - Mos u pikëllo! Zoti, Krijuesi yt të ka dhënë që nën ty, të rrjedhë një përrockë. Shkunde për ty trupin e hurmës. Do të bien hurma të freskëta, andaj ha e pi dhe t'i kesh sytë e gëzuar!” (Merjem, 23-25).

Përse është fjala mu për hurmat?

Zbulimet më të reja shkencore në këtë lëmi flasin qartë se hurma në vete përmban materien e cila e mbledh mitrën, e lehtëson lindjen dhe pengon gjakderdhjen pas lindjes, ngjashëm me oxytosinin dhe materien e cila zbut. Ndërkaq, në mjekësi është e njohur që zbutësit bimore e lehtësojnë dhe sigurojnë lindjen. Dhe ja pra, edhe në këtë shembull vërejmë madhështinë e fjalëve të Zotit për përkryershmërinë e Kur'anit si shpallje e Zotit:

“Nuk mund t’i vjen kurrfarë mangësie, e as ndryshimi as para tij e as prapa tij”. (Fussilet, 42);

“Sikur të ishte ai prej tjetërkujt përveç Allahut, ata mesiguri në të do të gjenin shumë kundërthënie”. (En-Nisâ, 8S2ik)u. r të mos ishte Kur’ani me origjinë hyjnore, ai me atë rast nuk do të ishte i përkryer; një ajet do ta kundërshtonte tjetrin, do të ishte përplot kontradikta dhe mangësi të tjera që janë karakteris- tike për veprat të cilat janë prodhim i mendjes dhe shpirtit nje - rëzor. Botimi i dytë i ndonjë vepre zakonisht dallohet prej botimit të parë sepse autori i saj i shton diç të re ose hjek diç nga botimi i parë, qoftë për ta korrigjuar vetveten, përmirësuar gabimet ose për të futur njohuri të reja deri te të cilat ka ardhur në ndërkohë. Kur’ani si shpallje e Allahut xh.sh. njerëzimit, është ruajtur nga të gjitha gabimet dhe të metat. Ai është i përkryer sepse është vepër e Të Përkryerit. Kur’ani si i tillë ka mundur të flasë për të kaluarën të cilën askush tjetër nuk e ka njohur, sepse për të nuk ka patur dokumente të shkruara si dhe për të ardhmen dhe atë që sjell ajo me vete. Po sjellim vetëm disa ajete në të cilat Kur’ani i ka paralajmëruar ngjarjet të cilat së shpejti edhe kanë ndodhur.

Në kaptinën Err-Rrûm Kur’ani thotë se romakët, të cilët kanë pësuar disfatë në një betejë, së shpejti do të ngadhënjëjnë: “Janë mundur romakët në tokën më të afërt, ndërsa ata pas disfatës pas DISA vjetëve do të triumfojnë...” (Err-Rrûm, 2- 4). Fjala “bid’a” - disa, në gjuhën arabe e ka kuptimin e pacaktuar ndërmjet tre dhe nëntë. Dhe vërtet, romakët pas sPhëtratfëitvojrenëvncëtrBiuemdëfruaKnu! r’ani thotë: “Së shpejti ai grup do të jetë i mundur dhe ata do ta kthejnë shpinën dhe do të ikin.” (El-Kamer, 45). Për ëndërrimin e (Muhammedit a.s.) për hyrje në Mekke, në Kur’an qëndron: “Allahu ia ka vërtetuar Të dërguarit të Tij ëndërrën e vërtetë... mesiguri do të hyni në Mesxhidu-Haram, nëse dëshiron Allahu, plotësisht të sigurt, disa me koka të rruara, ndërsa disa me flokë të shkurtuara.” (El-Fet’h,

27). Ashtu edhe ndodhi. Edhe tash paralajmërimet e Kur'anit po realizohen para syve tanë. Ibrahim i a.s. kështu e ka lutur Allahun xh.sh.:

“O Zoti ynë, unë disa pasardhës të mi i kam vendosur në një luginë jopjellore te tempulli Yt të cilin Ti e ke bërë të shenjtë... O Zoti ynë, bën që ata ta falin me përpikëri namazin. Vendosi në zemrat e njerëzve dashuri mes tyre dhe furnizoi me fryte, që të jenë falënderues.” (Ibrâhîm, 37). Ibrahim i a.s. e ka lutur Allahun xh.sh. që ta furnizojë këtë luginë jopjellore. Pastaj u erdhi premtimi i Zotit mekkasve se jetën do t’ua bëjë të begatshme me plot pasuri, kur u urdhëroi që mushtrikëve t’ua ndalojnë vizitën e Qa’besë ndërsa ata u frikësuan nga bllokada ekonomike sepse “banorët e Mekkes në jetën e tyre ekonomike mbështeteshin në të ardhurat të cilat i fitonin me rastin e vizitës së Qa’bes”. Allahu xh.sh. i qetësoi me fjalët: “Nëse i frikësoheni varfërisë, atëherë Allahu do t’ju pasurojë prej begatish të Tij...” (Et-Tevbe, 28). Ky premtim edhe sot e kësaj dite po përmbushet. Për çdo ditë ngrihet çmimi i naftës, burimet kryesore të së cilës shtrihen në këtë nënqiell. Nëse kësaj i shtohen edhe thesarët e uraniumit në këto vise, atëherë edhe më mirë mund të shihen “begatitë e ZNogtair” anpaërttjëetçëirl,atKëusrh’taënfijaflaetnëpëarjebtiontëet mtjësraipëtërmp.anjohura. Ai i zbulon sekretet e xhinnëve dhe engjëjve. Flet për gjërat të cilat për shumicën më të madhe janë të panjohura dhe për të cilat pak diçka mund të dinë vetëm disa sufij, por edhe ata për ato gjëra mund të dinë vetëm atë dhe aq sa thotë Kur’ani se mund të dinë dhe shohin. Pastaj aty është edhe fjala e fundit e Kur’anit për: administrimin, etikën, udhëheqjen, luftën, paqen, ekonominë, shoqërinë, martesën, afarizmin, për të drejtat (e njeriut) të shprehura me stil të pashoq, me shprehje autentike, me fjalë të cilat me vlerë të tyre estetike paraqesin fenomen të veçantë në historinë e gjuhëve përgjithësisht.

Ibnu Arebiun njëherë e pyetën për fshehtësinë e përkryerjes së Kur'anit, e ai u përgjigj vetëm me një fjalë: “E vërteta absolute”, sepse fjalët e Kur'anit janë absolutisht të vërteta, ndërsa maksimumi që një shkrimtar mund ta arrijë është e vërteta relative, dhe më së shumti që mund të arrijë është e vërteta e tij subjektive e cila del nga shikimi i tij i gjërave, të cilit hapësira e të pamurit i është gjithmonë e kufizuar. Secili prej nesh përfshin dhe arrin një pjesë të së vërtetës, derisa pjesët tjera të saj i shpëtojnë, ai shikon prej një këndi duke e larguar shikimin prej këndeve tjera, nga e cila del se gjithçka gjer te e cila arrin individ i është vetëm një pjesë e terësisë. Vetëm Allahu i Gjithëdijshtëm dhe i Gjithë- fuqishëm është Ai i cili e përfshinë të vërtetën absolute dhe gjith- çka tjetër. Andaj edhe themi se Kur'ani e ka burimin prej Allahut xh.sh. sepse e jep të vërtetën absolute të gjithçkaje.

Muhammedin a.s. e kanë pyetur për Kur'anin, e ai ka thënë: “Në të është lajmi për atë që ka qenë para jush, gjykim për atë që është ndërmjet jush dhe lajmërim për atë që vjen pas jush; ai është kufiri, nuk është mahi, ai është vërejtje e urtë, lidhje e fortë e Zotit, rruga e drejtë. Kush e lëshon shkatërrohet, kush kërkon udhëzim tjetër përveç tij humbet. Ai nuk i shtrembëron mendjet, nuk kërkon shumë diskutime; dijetarët nuk mund të ngopen, kurse vlerat e tij asnjëherë nuk mund të harxhohen (shteren)”.

Ja pra mik, ky është Libri ynë. Dhe gjithçka që përmban në vete dhe që porositi Kur'ani buron vetëm nga Zoti xh.sh.

Përktheu: Miftar Ajdini

DYSHIMET

Miku tha:

- Ti thua se Kur'ani nuk është kundërthënës. Çka thua, pra, në lidhje me ajetin: “Kush dëshiron le të besojë, ndërsa kush dëshiron le të mos besojë” (El-Kehf, 29) dhe ajetin në të cilin Allahu xhel-le shanuhu thotë: “Ju s’mund të dëshironi asgjë tjetër veç se atë çka dëshiron Allahu.” (Ed-Dehr, 30). Në një ajet thuhet se mëkatarët do të merren në pyetje për dhënien e llogarisë: “Dëshmitë e tyre do të shkruhen dhe ata do të merren në pyetje.” (Ez-Zuhruf, 19). “Me të vërtetë ai (Kur’ani) është nder i madh për ty dhe popullin tënd dhe ju do të merreni në pyetje” (Ez-Zuhruf, 44), ndërsa në një vend tjetër në Kur’an qëndron: “Dhe mëkatarët nuk do të merren në pyetje për mëkatet e tyre” (El-Kasas, 78), sepse do të njihen sipas shenjave të tyre. “Mëkatarët do të njihen sipas shenjave dhe fizionomisë së tyre dhe do të rrëmben për flokësh dhe për këmbësh.” (Err-Rrahmân, 41). Në një vend tjetër në Kur’an përsëri thuhet se askush nuk do ta lidhë fortë kriminelin: “Askush s’do të mund të lidhë lidhje të forta.” (El-Fexhr, 26), në kuptimin që secili do ta marrë përsipër ndëshkimin e vetvetes: “Sot të mjafton ajo që do të japësh llogari për vetveten.” (El-Isrâ, 14). Në këtë kuptim është edhe ajeti vijues: “E pastaj lidhne me zingjirë të gjatë shtatëdhjetë kute...” (El-Hâkka, 32).

Në këtë i thashë:

- Këto ajete nuk janë kundërthënëse... Të mendojmë bashkërisht për këto... “Kush dëshiron le të besojë, ndërsa kush dëshiron le të mos besojë...”, ajet plotësisht i qartë dhe i kuptueshëm. Ai konfirmon lirinë e njeriut, zgjedhjen e tij të lirë... por jo lirinë të cilën njeriu e ka rrëmbyer nga Zoti, por lirinë të cilën Zoti atij ia ka dhuruar sipas dëshirës së Vet. Ajeti vijues

këtë pak më afër e shpjegon: “Ju s’mund të dëshironi tjetër asgjë veç se atë që e dëshiron Allahu”, dmth. liria e njeriut është në kuadër të vullnetit të Zotit e jo kundër tij, që në anën tjetër do të thotë se liria e njeriut mund t’i kundërvihet kënaqësisë së Zotit prej nga rrjedh edhe mëkati, por liria e njeriut asnjëherë s’mund të jetë jashtë kuadrit të vullnetit të Zotit, edhe pse mund të jetë në kundërshtim me kënaqësinë e Zotit. Kjo është çështje mjaft e koklavitur. Ne e kemi shpjeguar këtë më gjerësisht kur folëm për deterministët dhe indeterministët, ithtarët e kushtëzimit kauzal të vullnetit njerëzor, përkatësisht ithtarët e lirisë së vullnetit të njeriut. Me atë rast kemi thënë se caktimi i Zotit është njëkohësisht vetëzgjidhje, sepse Zoti xhel-le shanuhu e zgjedh për njeriun atë që është në nijetin (qëllimin) dhe zemrën e tij, që do të thotë se Zoti i dëshiron njeriut atë çka njeriu i dëshiron vetes me nijetin dhe zgjedhjen e zemrës së tij, dmth. secili njeri është i drejtuar nga ajo që e ka zgjedhur vetë. E gjithë kjo flet mjaft për zgjedhjen e lirë pa imponimin edhe më të vogël, sikur që flet edhe për qartësinë e këtyre ajeteve. Përveç kësaj, çështja e lirisë së vullnetit të njeriut është një ndër çështjet më të vështura në të cilat kërkohet përgjigje. Atë që ti po e sheh me kundërthënie, në të vërtetë është shpjegim dhe plotësim.

Për ajetet të cilat flasin për përgjegjësinë për veprën e bërë është e nevojshme të thuhet se çdo ajet ka të bëjë me një grup të caktuar të të marrurve në pyetje. Midis tyre do të jenë ata për të cilët do të kërkohet dëshmim, pastaj ata të cilët do të kenë shumë mëkate andaj do të njihen në fytyrë se janë mëkatarë. Ata do të jenë, sikur thotë Kur’ani “të rrëmbyer për flokësh dhe këmbësh”. Midis të marrurve në pyetje do të jenë edhe ata të cilët me kokëfortësi dhe këmbëngulje i kanë mohuar të gjitha argumentet. Kundër tyre do të dëshmojnë duart e tyre dhe këmbët e tyre: “Atë ditë Ne do t’ua vulosim gojët e tyre e duart e tyre do të na flasin, ndërsa këmbët e tyre do të na dëshmojnë çka kanë punuar.” (Jâsîn, 65). Në të

vërtetë, do të ketë edhe të atillë të cilët do t'i qërojnë hesapet me vetveten. Do ta mendojnë dhe përvoja vetveten duke u penduar fort për rastin që e kanë humbur. Në Ditën e dhënies së llogarisë ata do ta gënjëjnë Zotin kur të vijnë para Tij. Gënjeshtrat e tyre do t'i mbrojnë duke u betuar rrejshëm: “Atë ditë kur Allahu t'i ringjallë, ata do t'i betohen Atij sikur që ju betohen juve duke menduar se me atë do të arrijnë diçka. Dije mirë! Me të vërtetë ata janë gënjeshhtarë.” (El-Muxhâdele, 18). Ata do të jenë të lidhur me zingjirë. Ebu Hamid El-Gazaliu thotë se këta janë zingjirë kauzalë.

- Ç'mendon ti për interpretimin kur'anor të diturisë së Allahut? Kur'ani thotë: “Me të vërtetë vetëm Allahu e di kur do të vijë çasti dhe dita e shkatërrimit të botës, kur do ta lëshojë shiun dhe ç'ka në mitrat e nënave. Askush nuk e di se çka do të bëjë nesër dhe ku dhe në çfarë vendi do të vdesë.” (Lukman, 34). Kur'ani në mënyrë eksplicite thotë se Allahu diturinë e përmendur e ka mbajtur për veti: “Te Ai janë çelësat e të gjitha fshehtësive. Ato i di vetëm Ai.” (El-En'âm, 59).

- E çka mendon psh. për mjekun i cili sot mund ta dijë se çka ka në mitra, mund ta qëllojë gjininë? Ç'të thuhet për shiun e fituar në mënyrë artificiale?

- Kur'ani nuk flet për lëshimin e shiut por flet për lëshimin e shtrëngatës, e ky është shi i mjaftueshëm i cili bie në sasi aq të mëdha sa që mund ta ndërrojë fatin e një populli, ta shpëtojë duke i sjellë mirëqenie. Ky lloj i shiut është e pamundur të prodhohet artificialisht.

Sa i përket dijes së Zotit për “atë çka ka në mitra” është e nevojshme të thuhet që dija e Zotit është gjithëpërfshirëse dhe kur është fjala për “atë se ç'ka në mitra”, nuk është fjala vetëm për gjininë e fëmijës mashkullor dhe femëror, por edhe për atë se kush do të jetë ai dhe çka do të jetë, ç'do të punojë dhe çfarë do të

jetë rruga e tij jetësore prej atij çasti e deri në vdekje. Të gjithë këtë mund ta dijë vetëm Zoti xhel-le shanuhu dhe askush tjetër.

- E çfarë tregimi është ai për fronin e Zotit i cili, sipas fjalëve tu- aja, përfshinë qiejt dhe tokën... për fronin të cilin e mbajnë tetë...?

Mendja jote përfshinë qiejt dhe tokën edhe pse je vetëm njeri. Si atëherë nuk mund t'i përfshijë froni i Zotit. Toka, Dielli, të gjithë planetët, yjet, galaktikat etj. barten me fuqinë e Zotit nëpër gjithësi. Si atëherë mund të habitesh kur është fjala për bartjen e fronit!

Ç'është kjo “El-Kursijju” dhe “El-Arshu”?

Më thuaj ti ç'është elektroni, do të them se ç'është “el-kursijju”. Më thuaj ç'është elektriciteti, do të të them se ç'është graviteti..., më thuaj ç'është koha. Ti nuk e di esencën e çkado qoftë e më pyet mua për esencën e nocioneve “el-kursijju” dhe “el-arshu”. Bota është përplot me fshehtësi dhe këto janë vetëm disa nga ato.

- Kur'ani flet për buburrecin i cili ua ka tërhequr vërejtjen bubu- rrecave tjerë për ardhjen e Sulejmanit a.s. dhe ushtrisë së tij: “Një buburrec tha: O buburreca, hyni në vrima tuaja që mos t'u shkelë Sulejmani me ushtrinë e tij...” (En-Neml, 18)

- Sikur të paktën, të kishe lexuar pak për insektet nuk do të shtroje pyetje të këtyllë. Shkenca për insektet është përplot me studime të përgjithshme për gjuhën e buburrecave dhe bletëve. Sot është fakt i gjithëpranuar se buburrecat kanë gjuhën e vet, sepse do të ishte absolutisht e pamundur të organizohen shërbi- met në foletë, në të cilat ka nga disa qindra mijëra buburreca, të transmetohen urdhrat etj., sikur të mos ekzistonte gjuha me të cilën ato transmetohen. Prandaj nuk ka vend as për habinë më të vogël se si buburreci ka mundur ta njohë Sulejmanin. Vallë, a nuk e njeh njeriu Zotin xhel-le shanuhu?

- Si e fshin Zoti atë që njëherë e ka shkruar (caktuar). “Allahu fshin çka të dojë dhe përforcon çka të dojë. Te ai është Libri Amë.” (Er-Ra’d, 39). A gabon Zoti juaj në llogaritje sikur që këtë e bëjnë njerëzit, fshijnë dhe përsëri shkruajnë, a e korrigjon Ai Vetveten sikur që këtë e bëjnë njerëzit?

- Allahu xhel-le shanuhu i fshin mëkatet me qëllim që të të inspirojë të bësh mirë. Ai në Kur’an thotë: “Veprat e mira, njëmend, i fshijnë të këqijat.” (Hûd, 114). Për robërit e tij të mirë, Allahu xhel-le shanuhu thotë: “U kemi shpallur të bëjnë vepra të mira, të falin namazin dhe të japin zeqatin.” (El- Enbijâ, 73). Dhe ja kështu shihet se Allahu xhel-le shanuhu shlyen pa shlyerje dhe kjo është fshehtësia e ajetit të theksuar të kaptinës Er-Ra’d të cilën e përmenda më lart.

- E çka thua për ajetin: “Exhinet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm për atë që të më adhurojnë Mua.” (Edh-Dhârijât’ 56)? A është Zoti i nevojshëm për adhurimin tonë?!

Përkundrazi, ne jemi të nevojshëm ta adhurojmë dhe t’i falemi Atij!

A e “adhuron” femrën e bukur nga dashuria të cilën ta ka imponuar apo të pëlqen, je i lumtur dhe kënaqesh me bukurinë e të dashurës sate. Zoti xhel-le shanuhu është mbi çdo gjë tjetër sipas bukurisë, madhërisë, fuqisë, etj., dhe nëse e njeh si të tillë, do Ta adhurosh dhe në atë adhurim do të gjesh lumturinë dhe kënaqësinë më të madhe.

Adhurimi te ne rrjedh nga të njohurit. Allahu xhel-le shanuhu adhurohet nga njohja. Ndërsa njohja e Allahut xhel-le shanuhu është kulmi i çdo njohurie dhe paraqet pikën fundore në rrugën e njohjes e cila fillon me lindjen. E para që fëmija e njeh pas lindjes është kraharoni i nënës. Kjo është kënaqësia e tij e parë. Pastaj fëmija e njeh nënën, babain, familjen, shoqërinë, rrethin. Më vonë fillon ta shfrytëzojë rrethin e tij i cili tash në krahasim me të është

si kraharori i dytë i nënës. Nga ai rreth, ai merr dhe shfrytëzon gjithë begatitë e tij, nga thellësitë e tokës nxjerr ar dhe diamante, nga detet margaritarë, nga arat dhe fushat mbledh lloje të ndryshme të fryteve. E gjithë kjo paraqet kënaqësinë e dytë të njohjes. Pastaj nga të njohurit e rrethit të tij tokësor kalon në të njohurit e sferave qiellore: e pushton Hënën, dërgon anije kozmike në Mars dhe lundron nga botët e panjohura duke u kënaqur edhe me një kënaqësi të madhe, me kënaqësinë e zbulimit dhe njohjes së gjithësisë. Pastaj ai kozmolundrues kthehet dhe vetvetes ia shtron këtë pyetje: kush jam unë që këtë e njoha. Me këtë pyetje ai nis një rrugë të re të udhëtimit, udhëtimin e njohjes së vetvetes me qëllim që t'i njohë dhe të zotërojë me fuqitë e tij të cilat i vë në shërbim të vetvetes dhe në shërbim të të tjerëve. Të ndihmosh veten dhe të tjerët edhe kjo është një lloj i kënaqësisë. Pas njohjes së vetvetes vjen njohja e cila paraqet kulmin e çdo njohurie, e kjo është njohja e Allahut xhel-le shanuhu i cili ka krijuar shpirtin e njeriut dhe qenien e njeriut. Me këtë njohjen e fundit njeriu arrin lumturinë kulminante, ngase takohet me më Të Lartësuarin, me më Të Përkryerin dhe me më Të Bukurin e çdo gjëje të bukur. Ky është udhëtimi i të devotshmit në rrugën e tij të devotshmërisë. E tërë kjo është në ligjin e luleve dhe të lumturisë së begatshme. Ndërsa ajo që në jetë ka vështirësi, është ngase ai që dëshiron ta këpusë trëndafilin duhet patjetër ta fusë dorën në ferra. Ai që dëshiron ta arrijë kulmin e pafundshmërisë duhet patjetër t'i angazhojë të gjitha fuqitë e tij në mënyrë që ta arrijë këtë. Ardhja e njeriut të devotshëm deri te njohja e Zotit xhel-le shanuhu dhe heqja e perdes nga sytë, është ajo më e bukura, më e madhërishmja dhe më e larta që njeriu përgjithësisht mund ta arrijë. Një sufi i veshur me petkun e zhgunjtë thotë: “Ne gjendemi në kënaqësinë e atillë që sikur të dinin për të sundimtarët, do të përpiqeshin të na e rrëmbenin me shpata”. Kjo është kënaqësia e ibadetit të vërtetë. Në këtë ka pjesë vetëm ai i cili është vërtet i devotshëm. Mirëpo, ajo devotshmëri Zotit xhel-le

shanuhu nuk i duhet. Ai për atë nuk është i nevojshëm. Ai është i pavarur edhe nga njerëzit. Ne nuk e adhurojmë Allahun për shkak se jemi të obliguar në këtë, por për shkak se e kemi njohur bukurinë dhe madhështinë e Tij. Në ibadetin Allahut xhel-le-shanuhu ne nuk gjejmë përçmim për njeriun, por lumturi dhe nder, gjejmë çlirimin nga të gjitha llojet e kulteve në jetën e kësaj bote, çlirimin nga çdo lloj i instinktit, epshit, lakmisë, robërimit të pasurisë etj. Duke iu frikësuar Zotit xhel-le-shanuhu nuk i frikësohemi më askujt dhe nuk qajmë kokën për asgjë tejtdër. Nënshtrimi për Allahun xhel-le-shanuhu është trimëri, ndërsa ibadeti për Atë është liri. Përlshmeria për Zotin është nder. Njohja e Zotit është siguri. Ja ky është ibadeti i vërtetë. Ne jemi ata të cilët kemi nevojë për dobinë dhe kënaqësinë e ibadetit, sepse Zotit xhel-le-shanuhu kjo fare nuk i duhet. Ai na ka krijuar që të na japë, e jo që nga ne të marrë. Na ka krijuar që të na pasurojë me një pjesë të përkryeshmërisë së Tij. Ai i cili çdo gjë dëgjon dhe çdo gjë sheh na ka bërë që edhe ne të dëgjojmë dhe të shohim. Ai i cili çdo gjë e di dhe çdo gjë e njeh na ka dhënë mendjen në mënyrë që edhe ne të pajisemi me një pjesë të dijes dhe shqisave të Tij, në mënyrë që të shërbehemi me një pjesë të njohjes së Tij. Ai thotë “O njeri, përlmu Mua do të jap një pjesë të fuqisë hyjnore dhe do të mundesh t’i thuash diçkasë bëhu dhe ajo do të bëhet” (hadithi - kudssijj). Vallë a nuk ia ka mundësuar këtë Isaut a.s., ashtu që Isau a.s. ka bërë atë çka e ka bërë.

Ibadeti për Allahun xhel-le-shanuhu pra nuk është robërim në kuptimin që e kuptojmë këtë zakonisht ne. Të robërosh, në kuptimin siç kjo zakonisht kuptohet, është që zotëriu t’i marrë dhe t’i shfrytëzojë të mirat e robit të vet. Ibadeti për Allahun xhel-le-shanuhu ka domethënie dhe kuptim plotësisht të kundërt sepse Allahu xhel-le-shanuhu i ka dhënë begati të panumërta dhe e ka dhuruar me shumë përkryeshmëri. Dhe kur Allahu xhel-le-shanuhu thotë: “Exhinet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm për atë

që të më adhurojnë Mua”, kjo në esencë do të thotë i kam krijuar exhinet dhe njerëzit që t’u jap dhe t’u dhuroj dashuri, mirësi, nder, fuqi, që t’u ndaj respekt dhe hilafet në Tokë. Zoti Krijues nuk ka nevojë fare për ibadetin tonë. Ne jemi të nevojshëm për Të. Ne jemi të nevojshëm për këtë ibadet, sepse kemi nevojë për këtë nderim, këto respekte dhe këto të mira që janë të pakufishme. Allahu fisnik na ka lejuar që të mund të “hyjmë” te Ai në çdo kohë pa u paralajmëruar dhe të mbetemi te Ai sa të duam, duke e lutur dhe duke kërkuar nga Ai çka të duam. Sa të biem në sexhde në namaz dhe të shqiptojmë “Allahu ekber” dmth. Allahu është më i madhi, vijmë në praninë e Zotit dhe mundemi nga Ai të kërkojmë ç’të duam.

A ka dikush tjetër te i cili mund të hyjmë kur të duam dhe si të duam?! Në këtë pikëpamje bukur thotë robi i mirë Shejh Muham-med Mutevel-li Esh-Sha'raviu:

“Mjafton që kam nderin të jem rob. Zoti i cili në madhërinë e Tij më të madhe është vazhdimisht, më pranon pa kurrfarë paralajmërimi.

Por, edhe përveç kësaj e takoj kur të dua dhe kur kam dëshirë dhe, “Ma tregoni prodhimin i cili prodhuesit të vet i tregohet pesë herë në ditë (mendon në pesë namazet ditore). Dhe i është ekspozuar shkatërrimit!”

Këto ishin vetëm disa domethënie të fshehta të ajetit i cili në shikim të parë shpie në dyshim:

“Exhinet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm për atë që të më adhurojnë Mua.”

Po të mendoje pak më tepër për këtë ajet, ai te ti do të zgjonte entuziazëm dhe do ta nxiste admirimin tënd.

Përktheu: Muhidin Ahmeti

QËNDRIMI ISLAM NDAJ EVOLUCIONIT

Miku im tha:

- Sot do të kesh punë të vështirë. Të duhet patjetër ta dëshmosh krijimin e njeriut në mënyrën gala -gala: e mori Zoti një copë dhe, e përziu me dorën e Vet, e frymëzoi në atë shpirtin dhe kështu u krijua Ademi, ndërsa krijimin e njeriut në këtë mënyrë e refuzojnë dituritë për evolucionin, të cilat nga ana e tyre pohojnë se njeriu i parë, Ademi, ka ardhur në botë si rezultat i një procesi të tërë të zhvillimit të jetës në tokë dhe si i tillë është i lidhur ngusht me anëtarët e familjes së tij - botën shtazore, se ka paraardhës të përbashkët me majmunët, se ekziston ngjashmëri e madhe në ndërtimin e trupit të tyre që, krejtë së bashku, flet qartë se të gjithë i takojnë një familjeje.

I gatshëm për hir të të vërtetës dhe shkencës në diskutim të pa-kursyer, mikut tim iu përgjigja:

- Së pari më lejo t'i përmirësoj disa pikëpamje tua në lidhje me krijimin e njeriut. Zoti nuk e ka krijuar Ademin në mënyrë gala - gala si mendon ti: Ja, këtu është një copë dhe, i fryejmë asaj dhe do të bëhet Ademi. Kur'ani flet për një mënyrë krejtësisht tjetër të krijimit të Ademit, flet për krijimin i cili ka fazat e veta, zhvillohet nëpër periudha dhe kalon në kohën e Zotit. Kur'ani krejtësisht qartë thekson se njeriu nuk ka dalë drejtpërsëdrejti nga dheu por nga pasardhësit të cilët kanë lindur nga dheu: "Ne, me të vërtetë e kemi krijuar njeriun nga palca e tokës." (El-Mu'minûn, 12). Pastaj, se njeriu në fillim s'ka qenë aspak i rëndësishëm:

"Vallë, a nuk ka kaluar njeriu një kohë, atëherë kur nuk ka qenë i denjë të përmendet." (Dehr - Insân, 1). Dhe se krijimi i tij ka qenë në mënyrë evolutive: "Ç'është me ju, pse nuk i frikësoheni

fuqisë së Allahut. Ai ju ka krijuar në etapa (shkallërisht).” (Nûh, 13-14).

“Ne ju krijuam, pastaj ua dhamë formën dhe atëherë u thamë engjëjve: Bini në sexhde para Ademi., Ata ranë në sexhde, ndërsa Ibli si refuzoi...” (El-A’râf, 11);

“Dhe kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë do ta krijoj njeriun nga balta, e kur ta përkryej dhe ta frymëzosh nga fryma ime, atëherë ju përuluni.” (Sâd, 71-72).

Nga ajetet e theksuara bukur mund të shihet se krijimi ka kaluar nëpër faza: të krijuarit, të formuarit, të përkryerit, e pastaj të frymëzuarit e frymës. Është karakteristike që këto faza në ajete janë të lidhura me lidhësen “thumme” (pastaj), e cila në kohën e Zotit shënon miliona vjet: “Dhe vetëm një ditë te Zoti yt është sa një mijë vjet sipas llogaritjes suaj.” (El-Haxh, 47).

T’i shikojmë këto faza kohore të krijimit në kaptinën Sexhde në të cilën Allahu xhel-le-shanuhu thotë: “E ka filluar krijimin e njeriut nga balta, pastaj e ka bërë që pasardhësit e tij të bëhen nga gjaku i pikësuar dhe nga uji i dobët i njeriut, pastaj e ka unjësuar dhe qenien e tij e ka përkryer dhe e ka frymëzuar nga fryma e Vet dhe i ka dhënë veshë, sy dhe zNeëmfejlrl.i.m” (kEas-qSeenxëhdheé, ,7p-9a)s.taj gjak i pikësuar nga uji i dobët. Këto janë nismat e krijimit të njeriut i cili si i tillë “nuk ka qenë i denjë të përmendet”. Pastaj kanë pasuar unjësimi, formimi dhe frymë- zimi me të cilin njeriu është bërë qenie e përkryer me shqisa: të të dëgjuarit, të të pamurit, si dhe me zemër... është bërë Ademi i cili pra është etapa e fundit e një zhvillimi kauzal e të gjatë, e kurrësi fillim absolut i një krijimi momental (mënyrë - gala-gala):

“Dhe Allahu ju ka bërë që të rriteni nga toka sikur bimët...” (Nûh, 17).

Me rritjen e cila është përmendur në këtë ajet, mendohet në rritjen e cila i ka fazat e veta. Mirëpo, fshehtësia e vërtetë është në atë se çfarë kanë qenë ato faza në esencën e tyre, ç'kanë qenë në të vërtetë ato periudha të zhvillimit.

A është trangu i jetës i tërë nga një baba?

Duke e marrë parasysh përbërjen kimike, çdo gjë është nga dheu. Çdo gjë me vdekjen e cila është e pashmangshme, i kthehet tokës dhe zërthehet në përbërjet e veta themelore. Ky është fakt i gjithënjohur. Por, fjalën “baba” ne këtu e kuptojmë shumë më gjerë se përbërja themelore e njeriut. Pyetja vetëm është se a është lindur qeliza e parë nga toka e cila me të shumëzuarit i ka prodhuar të gjitha llojet dhe gjinitë e shtazëve dhe të bimëve e me këtë edhe vetë njeriun, apo kanë ekzistuar nisma të shumënumërta dhe të nduarnduarta: një nismë nga e cila janë zhvilluar bimët, një tjetër nga e cila lindi një lloj i caktuar i shtazëve si psh. sfungjerët, nisma nga e cila u zhvilluan peshqit, pastaj nisma nga e cila lindën zvarranikët, nisma e shpendëve, nisma e sisorëve dhe nisma nga e cila është zhvilluar njeriu, që do të thotë se edhe njeriu ka nismën e vet... plotësisht të pavarur sikur edhe çdo lloj tjetër.

Ngjashmëria anatomike e gjinive, llojeve dhe familjeve nuk e mohon lindjen e çdo lloji nga nisma e veçantë. Kjo përputhshmëri anatomike krejtësisht qartë tregon në atë se është një Krijues i të gjitha llojeve, gjinive dhe familjeve, i cili të gjithë i ka krijuar nga materiali i përbashkët, sipas një stili dhe plani të njëjtë. Kjo është konsekuenca e tyre logjike dhe e domosdoshme. Mirëpo, kjo që kanë një baba, nuk është rezultat i domosdoshëm i ngjashmërisë anatomike dhe përputhshmërisë së llojeve, gjinive dhe familjeve. Mjetet e komunikacionit janë të ngjashme ndërmjet veti si qerret, trenat, tramvajët, etj. Kjo ngjashmëri e tyre flet se ato mjete të komunikacionit janë prodhim i trurit njerëzor. Por kjo në asnjë mënyrë nuk e mohon ekzistimin e projektuesit dhe

originalitetin e tyre. Sikur që është e padrejtë të themi se qerrja e dorës është “zhvilluar” sipas ndonjë ligji të vet të brendshëm të pavarur, së pari në qerre të cilën e tërheqin kuajt, pastaj në ford, tren dhe dizel, sepse është e vërtetë që ky “kalim” do të ishte krejtësisht ndryshe dhe do të vijonte me zhvillimin e mendjes së konstruktuesit dhe aftësive të tij shpikëse. Po ashtu është e padrejtë të thuhet se një lloj ka dalë nga tjetri, edhe pse ky pohim, duke marrë parasysh renditjen e përmendur kohore, duket i saktë. Mirëpo është e vërtetë se çdonjëri prej tyre ka ardhur me “kërcimin shpikës” të konstruktuesit të vet dhe ashtu ka filluar pavarësisht.

A kanë ekzistuar paranisma të pavarura të gjinive apo disa gjini kanë nismë të njëjtë?

Zhvillimi është përmendur krejtësisht qartë në Kur'an sikur që janë përmendur edhe fazat e tij: faza e krijimit, faza e formimit, faza e përkryerjes dhe faza e gjallërimit... Mirëpo, shkenca ende nuk ka mbërritur që në tërësi ta shpjegojë cilëndo qoftë nga këto faza dhe ta japë fjalën e fundit për to.

Nëse kthehemi në ajetin e kaptinës Sexhde i cili në përkthim është: “... E filloi krijimin e njeriut nga balta, pastaj e bëri që pasardhësit e tij të bëhen nga gjaku i pikësuar dhe nga uji i dobët i njeriut, pastaj e unjësoi dhe qenien e tij e bëri të përkryer dhe e frymëzoi nga fryma e vet, dhe i dha veshë, sy dhe zemër...” (Es-Sexhde, 7-9), do të shohim se nismat e para të njeriut, prej të cilave më vonë është bërë njeriu i parë-Ademi, e ato janë mbi të cilat flitet sikur mbi ujin e njeriut, nuk i kanë pasur të formuara shqisat: e të pamurit, të dëgjuarit, as zemrën. Këto kanë ardhur më vonë pas “frymëzimit të frymës” e kjo ka qenë faza e fundit e krijimit të Ademit. Do të thotë, këto nisma janë të ngjashme me jetën paranismore (primodiale) të shtazëve: “Vallë, a nuk ka kaluar njeriu një kohë kur nuk ka qenë i denjë të përmendet.” (Insân, 1). Nuk mendoj se e gjithë kjo dallohet nga

qëndrimet e shkencës për të cilat flet ti. Mirëpo, e vërteta e zhvillimit ende është fshehtësi. Dhe askush i mençur nuk do të pohojë se këtë të vërtetë e ka zbuluar. Ndoshta ajo që me të vërtetë ka ndodhur, as për së largu nuk është kjo për të cilën flasim ne dhe për të cilën flasin shken- cëtarët. Çështja është ende e hapur për hulumtime dhe çdo gjë që shkenca e servon është vetëm supozim.

Përktheu: Muhidin Ahmeti

MAKSIMA KUR'ANORE: “LÂ ILÂHE IL-LALL- LLAH” (NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALLAHUT)

Miku tha:

- A nuk pajtohesh me mua në mendimin se ju e teproni shumë në përdorimin e fjalës “Lâ ilâhe-il-lAllah”, duke e quajtur atë çë- lës i cili hap çdo derë, me këto fjalë e përcillni të vdekurin, e prit- ni foshnjën e posalindur, i vendosni ato fjalë në vula, i skalitni në gjerdane, i shtypni në monedha, përpunoni lehva në mure... (thoni) se cili prej jush i shqipton këto fjalë, trupin e vet e ka të ruajtur nga zjarri... e nëse e shqipton njëqind mijë herë, do të hyjë në xhennet, sikur ato fjalë të ishin talisman magjik, magji për dë- bimin e gjindëve apo shpellë për mbylljen e tyre, si dhe shkronjat elif-lâm-mîm, kâf-hâ-jâ-ajn-sâd, tâ-sîn-mîm, hâ-mîm, elif-lâm- râ, kuptimin e të cilave as ju vetë nuk e dini. A do ta shpëtoj veten nga dënimi nëse i shqiptoj fjalët “La illahe il-lAllah”. Nëse po, atëherë ja unë e shqiptoj para teje dhe këtij auditoriumi: Lâ ilâhe il-lAllah, dhe me këtë a ka marrë fund çdo gjë?

- Jo, me këtë nuk ke thënë asgjë. Maksima kur'anore, “Lâ ilâhe il-lAllah” e cila do të thotë: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut” është e dobishme vetëm për atë që e rregullon jetën e vet sipas saj, e jo edhe për atë i cili e përsërit vetëm me gjuhë.

“Lâ ilâhe il-lAllah” është metodë e punës, stil dhe program i jetës. Të mendojmë pak për domethënien e saj. Kur të themi “Lâ ilâhe il-lAllah”, atëherë me atë qartë bëjmë me dije se vetëm Allahu është i denjë për adhurim. Ndërmjet “la -së” dhe “il-la-së”, ndërmjet mohimit dhe pohimit të cilët janë përfshirë në këtë maksimë, ndërmjet tyre gjendet i tërë besimi. Me “la -në” mohuese mohohet hyjnia e çdo gjëje që na mashtron dhe josh nga të

mirat e kësaj bote si pasuria, dinjiteti, pozita, sundimi, çdo formë e kënaqësisë, luksi, gratë, krenaria... Të gjitha këtyre haptazi u themi: Jo. Nuk do të adhuroj. Ti nuk je zot. Pastaj i drejtohem vetes, shpirttrave tanë të cilët shpesh jepen pas këtyre kënaqësive, sepse njeriu shpesh e adhuron edhe vetveten; e adhuron mendimin e vet, epshet e veta, zgjidhjen e vet, vullnetin e vet, aftësitë e veta dhe mendon se me duart e tij i ka kapur skajet e çdo sendi, se në duart e tij është fati i mbarë njerëzimit, dhe në këtë mënyrë e bën veten zot e që shpesh edhe s'është i vetëdijshëm për këtë. Shpirtit të këtyllë ne i themi: Jo. Nuk do të adhuroj. Ti nuk je zot. U themi "Jo" të gjithë atyre të cilët kërkojnë nga ne që t'i adhurojmë në vend të Zotit.

Fjala "ilahun" është "failun", ndërsa failun do të thotë ai i cili vepron. Te ne ai është Zoti, kurse çdo gjë tjetër është mjet. Çdo gjëje dhe çdokujt tjetër përveç Allahut i themi: Jo, nuk do të adhuroj, sepse nuk je zot. Se s'ka zota tjerë përveç Allahut e vërtetojmë me pjesëzen "il-la" në maksimën e përmendur kur'anore. E ndërmjet këtyre dy pjesëzave, siç e theksuam këtë më lart, qëndron i tërë besimi. Pra, ai i cili është i zënë me grumbullimin e pasurisë, kapitalit, poltroneri ndaj eprorëve, vrapim pas kënaqësive, dhënie pas epsheve, adhurimin e mendimit të vet dhe qëndrimit të vet, ai nuk u ka thënë vendosmërisht zotërinjve të vet: Jo. Ai është në mihrab (altar) të idhujve të tij dhe nëse e shqipton maksimën kur'anore "Lâ ilâhe il-lAllah", ai këtë e bën rrejshëm, e shqipton me gjuhën e tij atë që nuk e bën me duart e tij dhe që nuk e dëshmon në praktikën e tij të përditshme.

Maksima "Lâ ilâhe il-lAllah" do të thotë edhe se nuk ka llogarimarrës as kontrollues tjetër përveç Allahut, i cili është i vetmi i denjë për frikërespekt. Ai i cili i frikësohet dikujt tjetër nuk u ka thënë vendosmërisht dhe me zemër "la" dmth: Jo, të gjithë atyre zotave të rrejshëm, por vazhdimisht atyre u bie në sexhde, u falet dhe kështu bën shirk (i bën shok Zotit - shën.

jonë). Ai gënjen kur i shqipton fjalët: “Lâ ilâhe il-lAllah’.

Nga domethënia e “Lâ ilâhe il-lAllah” shihet se kjo është obligim, program dhe stil i jetës, qëllimi i së cilës është puna sipas asaj çka do të thotë ajo. Dhe kush vepron sipas kësaj maksime kur’anore, me të vërtetë ajo do t’i jetë talisman me të cilin do të mund të hapë çdo derë, shpëtim në të dy botët dhe rrugë për në xhennet. Ndërsa sa i përket atij i cili e shqipton këtë maksimë vetëm me gjuhë, pa e rregulluar dhe organizuar jetën e vet sipas saj, kjo nuk do t’i sjellë kurrfarë dobie.

Mirëpo, fjalët “Lâ ilâhe il-lAllah” do të thonë edhe më shumë se kjo. Ato kanë edhe nocionin e tyre të caktuar filozofik. Dr. Zeki Nexhib Mahmudi thotë: “Maksima “Lâ ilâhe il-lAllah” përmban të pranuarit e ekzistimit të atij që e shqipton këtë maksimë dhe jeton sipas saj, ekzistimin e asaj që kjo maksimë e thotë si dhe ekzistimin e atyre para të cilëve kjo maksimë shqiptohet. Shkurt, ajo konfirmon ekzistimin e vërtetë të individit, Allahut dhe të atyre para të cilëve individit përkatës e pranon ekzistimin e Zotit. Nga kjo shihet se Islami e hedh poshtë idealizmin në filozofi sikur që këtë e bën njësoj edhe me materializmin. Ai merr një pozitë të mesme.

E refuzon idealizmin sepse ai nuk e pranon ekzistimin e të tjerëve dhe të botës objektive, faktin e jashtëm jo të varur nga arsyeja. Çdo gjë në sytë e idealistëve rrjedh sikur të ishte ëndërr, çdo gjë është në tru, çdo mendim del nga mendja. Edhe ti, edhe radioja, rruga, shoqëria, shtypi, lufta, të gjitha këto janë ndodhi, figura dhe ëndrra të cilat zhvillohen në mendje, ndërsa bota e jashtme nuk ka ekzistimin e saj të vërtetë.

Islami, sikur që këtë e theksuam, e refuzon këtë qëndrim idealist-ekstrem dhe maksima e tij “Lâ ilâhe il-lAllah”, sikur që këtë e ka vërejtur dr. Zeki Nexhib Mahmudi, e vërteton ekzistimin e atij që deklaron, ekzistimin e asaj që deklarohet dhe ekzistimin e atyre

para të cilëve atë e deklaroi, dmth. që individi, Allahu dhe të tjerët (njerëzit), janë të vërteta të konfirmuara.

Maksima “Lâ ilâhe il-lAllah” pra do të thotë stil i jetës dhe qëndrim i caktuar filozofik.

Dhe ja, tash e ke të qartë se shqiptimi yt i maksimës së lartpërmendur kur’anore nuk do të të ndihmojë, sepse ti atë e ke shqiptuar josinqerisht.

E ke shqiptuar shehadetin, ndërsa nuk punon, nuk e organizon dhe nuk e rregullon aspak jetën tënde sipas maksimës kur’anore të cilën e ke shqiptuar.

Sa i përket diskutimit për harfet (shkronjat): elif-lâm-mîm, kâf-hâ-jâ-ajn-sâd, hâ-mîm, elif-lâm-râ, më lejo që para kësaj të të pyes për shkronjat “sîn” dhe “sâd”, llogaritmin dhe formulën e energjisë, gjë që tërë kjo është fshehtësi për atë i cili nuk e njeh matematikën, gjeometrinë dhe fizikën, ndërsa për ata që i njohin këto dituri secila nga këto “fshehtësi” e ka domethënien e saj të thellë.

Ashtu është edhe me harfet të cilat ti i përmend. Domethënien e tyre e njeh vetëm ai të cilit i është zbuluar.

Përktheu: Muhidin Ahmeti

MBI MU'XHIZEN

Miku tha:

- Nuk e kuptoj se si Zoti Mëshirues, për të cilin ju thoni se është i butë, i mëshirshëm, fisnik, se shumë fal etj., i lejon vetes, një Krijues dhe Zot i tillë, t'i urdhërojë Të dërguarit të Tij, Ibrahimit, që ta therë fëmijën e vet. A nuk do të pajtohesh së bashku me mua se në mbarë këtë është shumë vështirë të besohet?

- Nga konteksti i të rrëfyerit kur'anor për Ibrahimin a.s. dhe birin e tij Ismailin, qartë shihet se qëllimi i Zotit nuk ka qenë që Ibrahimit ta therë birin e vet, sepse po ta dëshironte këtë Allahu xh.sh. pa dyshim ajo edhe do të ndodhte. Mirëpo, është e njohur se Ismaili nuk ka qenë i flijuar si kurban. Nga Ibrahim a.s. është kërkuar që të ngadhënjejë dashurinë e tij të flakët ndaj fëmijës së tij të lindur, që të jetë zot i ndjenjave të tij, që të lirohet nga lidhshmëria e tepruar me Ismailin, sepse nuk është e lejuar që zemra e Të dërguarit të Zotit të jetë e lidhur për dikë tjetër në atë masë sa është e lidhur për Allahun xh.sh. Zemra e Të dërguarit të Zotit duhet patjetër të jetë e përmbushur me dashuri të pafundshme ndaj Allahut xh.sh. Çdo gjë tjetër, si bota, fëmijët, autoriteti, mundimi, janë me rëndësi të dorës së dytë. Ismaili, siç është e ditur, është lindur kur ati i tij ka qenë në pleqëri të thellë. Nga ky shkak ndoshta ajo dashuri e flakët e babait ndaj tij. Atëherë Allahu xh.sh. e vë në sprovë Të dërguarin e vet në mënyrë që të hulumtohet saktësia e tij e interpretimit të këtillë. Dhe ç'ndodhi. Mjaftonte që I dërguari i Zotit vetëm ta pranonte urdhrin e Zotit dhe menjëherë t'i qasej ekzekutimit të tij. Mirëpo, atëherë vjen urdhri i Zotit për zëvendësimin e sakrificës.

- E ç'mendoni për mu'xhizet e Ibrahimit a.s. - për hyrjen e tij në zjarr i cili nuk e djeg, për shkopin e Musaut a.s. të cilin ai e shndërron në gjarpër dhe me të cilin e çan detin, pastaj për dorën

e tij të bardhë... Vallë a nuk të përngjet e gjithë kjo në programin akrobatik të ndonjë cirku. A thua ka nevojë Zoti që fuqinë dhe madhërinë e Vet ta dëshmojë me diç që vetvetiu është absurd dhe paraqet prishje të rendit dhe rregullit në natyrë. A thua, a nuk janë pikërisht rendi, sistemi, arsyeja, disiplina, me një fjalë ligjet të cilat zotërojnë në natyrë, dëshmitë më të fuqishme të madhërisë dhe fuqisë së Zotit?

- Më duhet patjetër të të them se mu'xhizen e ke kuptuar gabi- misht. Ajo, sipas mendimit tënd, është akrobatizëm (pehlivanllëk), kundërshtim i rendit dhe absurd. Mirëpo, mu'xhizja është krejtësisht diç tjetër.

Më lejo që këtë të ta shpjegoj me shembuj! Të supozojmë që sikur ti të kishe mundësi me çfarëdo rasti të ktheheshe tre mijë vjet prapa dhe ta vizitosh faraonin egjiptian duke marrë me vete një transistor të madhësisë së një shkrepseje, i cili këndon dhe flet. Ç'mendon, çka do të bënte faraoni dhe suita e tij? S'ka dyshim se të ngurosur (habitur) do të bërtitnin se kjo është mu'xhize, magji dhe kundër çdo ligji, edhe pse ne të gjithë e dimë se në mbarë këtë s'ka asgjë të çuditshme dhe të mbinatyrshme, sepse tërë ajo që ndodh brenda transistorit ndodh sipas ligjeve të elektronikës dhe si e tillë është plotësisht normale dhe e kuptueshme. Me çfarë habie, ndërkaq, do të të shikonte mbreti i Babilonisë sikur ta vizitonte me televizor në dorë i cili emiton fotografi nga Perandoria Romake, ndërkaq mbreti asirian, krejt i çmendur, do të të duartrokiste po të dëgjonte zërin nga pllaka e gramafonit të cilin e ke lëshuar.

Edhe historia më e afërt ka shënuar reagime gati të njëjta. Kështu për shembull kur erdhën kolonialistët në Afrikë dhe kur ateroi aeroplani i parë në një pyll të pashkelur, vendasit e atjeshëm nga frika ranë duke u lutur lakuriq për tokë, pastaj filluan t'u bien daulleve dhe të flijohen duke thënë se ai është Zoti që ka zbritur nga qiejt, sepse atë që e panë me sytë e tyre ishte

kundër të gjitha ligjeve “logjike” të cilat ata i njihnin, edhe pse ne e dimë mirë se fluturimi i aeroplanit zhvillohet sipas ligjeve konsoliduese (të aerodinamikës - shën. përk.) dhe se me rastin e konstruimit të aeroplanit është dashur doemos ato të merren parasysh. Për këtë arsye mu’xhizja nuk është prishje e rendit por respektim i rendit. Uji ngjitet nëpër trungun e hurmës përkundër gravitacionit. Fjala është për ligjin e kompaktësisë së shtyllës ujore, ligjit të fijeve të veçanta (rrënjore) dhe ligjit të shtypjes osmotike të cilët e tërheqin ujin lart.

Ne asnjëherë nuk dalim nga suazat e arsyes, as jashtë të të kuptuarës. Mahnitja e vendasve pason nga mosnjohja e ligjeve në natyrë. E tillë është edhe mahnitja jote para çarjes së detit që e bëri Musau a.s. dhe shndërrimi i shkopit në gjarpër, para ngjalljes së të vdekurve të Isaut a.s., hyrjes së Ibrahimit në zjarr që s’mund ta djegë etj. Për ty kjo është e pamundur sepse i then ligjet. Ti këtë e konsideron akrobatizëm, edhe pse e gjithë kjo zhvillohet sipas ligjeve të Zotit që i tejkalojnë ligjet të cilat deri tash i kemi zbuluar. Fjala është vetëm për një ndodhi më të lartë dhe një rend më të lartë, i cili është krejtësisht logjik, edhe pse mendja jonë ende nuk e arrin. Zoti xhel-le-shanuhu nuk e prish këtë rend me mu’xhize por me ato na i zbulon nivelet e tij më të larta.

Behaijët kanë gabuar gjithashtu duke i mohuar mu’xhizet sikur edhe ti, sepse i kanë konsideruar mospërfillje dhe përçmim i mendjes. Ata i kanë refuzuar kuptimet e fjalëpërfjalshme të tekstit kur’anor, dhe sipas të kuptuarit të tyre Musau, a.s. me shkopin e tij nuk e ka çarë detin, por shkopi i tij e ka simbolizuar sheriatin i cili e ndanë të vërtetën, dora e tij e bardhë, sipas tyre, është mishëruar në dorë të së mirës; Isau i ka ngjallur shpirtat e jo trupat, ia ka hapur pamjet mendjes, e nuk ua ka kthyer pamjen të verbërve. Për ata mbarë kjo ka qenë vetëm alegori dhe simbolikë kur’anore, sepse tërë këtë s’kanë mundur ta kuptojnë. Ne sot jetojmë në kohën në të cilën aspak nuk është vështirë të kuptohen

mu'xhizet. E pamë se si shkenca na çoi në Hënë. Nëse kjo na shkoi për dore duke iu falënderuar dijeve tona, atëherë është jashtë çdo dyshimi që dija e Zotit të na ofrojë forcë dhe fuqi më të madhe. Dëgjoje pak këtë ajet të bukur kur'anor:

“O grup i exhineve dhe njerëzve! Nëse ju mendoni se mund të depërtoni nëpër sferat e larta të qiellit dhe të Tokës, atëherë provoni! Por nuk do të mundeni të depërtoni vetëm se me fuqi të madhe.” (Err-Rrahmân, 33).

Përktheu: Muhidin Ahmeti

KUPTIMI I FESË

Miku vazhdoi:

- Dëgjo, nëse ekziston xhenneti, sikur që pohoni, atëherë unë do të jem i pari i cili do të hyj në të, sepse jam më religjioz sesa shumë propagandues tuaj me mjekra dhe tespih në dorë.

- Religjioz? Çka nënkupton me këtë?

- Mendoj, nuk e ofendoj askend, nuk vjedh, nuk vras, nuk pranoj ryshfet, nuk hipokrizoj, nuk urrej, askujt nuk ia mendoj të keqen, qëllimin e kam vetëm të bëj mirë dhe qëllimi im gjithnjë është do- bia e përgjithshme. Zgjohem dhe fle me ndërgjegje të pastër. Parimi i jetës sime është që ta rregulloj atë që mundem. A nuk është tërë kjo fe? A nuk thoni ju se feja është tërësia e marrëdhënieve të nje riut?!

- Atë që e the, nuk është fe. E tërë çka punon ti bën pjesë në fe dhe quhet edukatë dhe sjellje e mirë. Ti nuk bën dallim midis asaj ç'është feja dhe asaj çka i takon fesë. Fe do të thotë vetëm një: njohja e Allahut dhe qëndrimi ndaj Tij, të Madhit dhe Mëshiruesit, i cili është afër dhe i cili çdo gjë sheh dhe dëgjon, dhe i cili është i vetmi i denjë për lavdi dhe falënderim. Kjo, në të vërtetë është feja dhe ajo në vete i inkadron edhe të gjitha ato që i theksove.

Pejgamberi i Allahut thotë:

“Zoti e pranon sadakanë më parë se sa duart e atij që i jepet”. Kush e beson Zotin xhel-le shanuhu i do edhe krijesat e Tij dhe sillet mirë ndaj tyre...

- Më beso, nganjëherë ndiej se ekziston njëfarë Fuqie.

- Fuqi!
- Po! Njëfarë Fuqie e panjohur e cila qëndron pas tërë kozmosit. Unë plotësisht besoj se ekziston njëfarë Fuqie.
- Si e kupton ti këtë Fuqi? A e kupton si qenie e cila dëgjon, sheh, kupton, u jep premtime krijesave të Tij se do t'i mbrojë, udhëzojë, dhe drejtojë në rrugë të vërtetë, se do t'u dërgojë libra dhe pej- gamberë dhe do t'u përgjigjet lutjeve të tyre.
- Haptas të të them, unë atë fuqi nuk e mendoj ashtu, as s'e kup- toj. Edhe më tepër se kjo, e mendoj naive dhe të pahijshme ndaj asaj Fuqie madhështore.
- Do të thotë, kjo është ndonjë Fuqi e verbër e cila pa vetëdije dhe pa përgjegjësi e drejton kozmosin?
- Ndoshta!
- Sa i keq është kuptim yt për Fuqinë më të lartë. Të ka dhënë sytë e ti mendon se ajo është e verbër. Të ka dhënë mend, kurse ate e mendon të pavetëdijshme. Ti e mohove Allahun dhe kështu vetvetes i bëre mizori... ti Zotin tënd e mendon si fuqi të verbër të cilit nuk i lutesh dhe nënshtrohesh...
- Pse të falem dhe kujt t'i falem? Unë në lutjet tuaja nuk shoh kurrfarë urtësie. Për ç'arsye ato lëvizje dhe a nuk është e mjaftueshme vetëm përulësia?
- Kuptimi i faljes (së namazit) është thyerja e mendjemadhësisë. Me rënien në sexhde, me prekjen e tokës me ballë dhe me theksimin e “subhâne rabbije-l-e'alâ” e pranon vendin tënd, se ti në krahasim me Allahun je i imët dhe i asgjëshëm, se je dhe... Kurse, sa u përket lëvizjeve në fjalë dhe mosmjaftueshmërisë së vetë përuljes, më lejo të të pyes para se të të përgjigjem: për ç'arsye është krijuar trupi dhe pse ti nuk kënaqesh vetëm me dashuri abstrakte e cila nuk e inkadron në

vete edhe trupin? Allahu xhel-le-shanuhu ta krijoj trupin që të ta zbulojë zemrën. Nëse në zemrën tënde ka diç, ajo do të tregohet në trup. Nëse adhurimi yt është i singërtë, ti atë do ta manifestosh me trup, e nëse nuk është, atëherë do të mbetet vetëm në gjuhë.

- A beson ti se do të hysh në xhennet?

- Të gjithë do të shkojnë në xhehennem. Pastaj Allahu do t'i shpëtoj ata të cilët kanë vepruar atë që e ka urdhëruar Ai dhe janë ruajtur prej asaj që Ai e ka ndaluar. Unë nuk e di se a jam prej atyre të cilët do të jenë të shpëtuar. Atë e di vetëm I Gjithë- dijsmi. Vepra mund të jetë e mirë, por qëllimi i cili qëndron pas saj ndoshta nuk është i mirë. Ndoshta dikush punon diç në emër të dikujt tjetër e jo në emër të Allahut të madhëruar. Shumë ka prej atyre të cilët mashtrohen në parashikimet e tyre. Ne e lusim Zotin të na ruajë nga mashttrimet tona.

- A është e mundur që njeriu të jetë plotësisht i singërtë?

- Njeriu vetë nuk mund ta arrijë singëritetin e plotë. Singëriteti është dhuratë e Zotit dhe Zoti xhel-le-shanuhu ka premtuar se do ta drejtojë dhe orientojë në rrugë të vërtetë atë që i drejtohet. Prandaj, nuk të mbetet asgjë tjetër përpos se t'i kthehesh Atij. Tek Ai është e amshueshmja!

Përktheu: Nexhat Ibrahim

NE SENDËRTOJMË FATIN E KËSAJ BOTE, NDËRSA JU SENDËRTON ILUZIONALE

Duke konsideruar se është ngadhënjimtar, miku tha:

- Pa i marrë parasysh këto mospajtimet tona dhe kohëzgjatjen e diskutimit tonë, ne nga ato dalim si ngadhënjimtarë, sepse ne sen- dërtojmë fatin e kësaj bote ndërsa ju iluzionet. Ne kemi shumë gjëra të tilla që harami nuk i ngatërron. Ju keni agjërimin, nama- zin, duatë, frikën nga llogaria. E më thuaj, kush është në fitim?

- Ju do të ishit në fitim sikur ajo që e posedoni të ishte fati i vërtetë. Mirëpo, kjo në të vërtetë është fatkeqësi.

- Fatkeqësi?! Si kjo?

- Për arsye se kjo është robërim i epsheve të cilat janë të pangopshme. Edhe Kur'an'i e pranon se ju kënaqeni, por kjo kënaqësi nuk është e denjë për njeriun. Prandaj, kjo s'është fat. Fati i vërtetë është qetësia shpirtërore dhe çlirimi spiritual nga të gjitha robërimet përveç robërimit ndaj Zotit Një dhe të Vetmit.

Fati është pajtimi i njeriut me vetveten, me të tjerët dhe me Zotin xhel-le shanuhu. Ky pajtim arrihet me aktivitetin e njeriut. Tërë jeta e tij duhet të jetë e përshkruar me të mira dhe me të forcuarit e lidhjes me Allahun xhel-le shanuhu me anë të namazit. Në favor të kësaj janë edhe fjalët e një mistiku: “Ne jetojmë në ëmbëlsitë e atilla që mbretërit, sikur ta dinin çfarë janë, do të tentonin me shpata të na i rrëmbenin”. Ata të cilët e njohin këtë ëmbëlsi të pajtimit me Zotin dhe me vetveten, e njohin vlerën e kësaj thënieje.

- A nuk ke pirë edhe ti para disa vjetësh, je dëfryer së tepërmi dhe ke qenë i kënaqur me jetën e atillë, sikur që jemi ne

tash të kënaqur? Në librin tënd Allah we-l-insân (Allahu dhe njeriu) ke bërë herezi para një shumice të cilëve tash po ua zë për të madhe, e çka është ajo që të solli nga njëri skaj në skajin tjetër?

- Zoti është Ai i cili i ndryshon njerëzit dhe i cili është i vetmi i pandryshueshëm.

- E di. Ti thua se e tërë kjo është me mirësinë e Zotit, por cili është roli yt?

- Vdekja është ajo e cila së pari më nxiti në një përsiatje të thellë për botën rreth meje. Ajo më parë, në të vërtetë, më është dukur paradoksale dhe atë vetes kurrsesi nuk kam arritur t'ia shpjegoj, derisa bota më është dukur e rregulluar në mënyrë të përkryer dhe e kuptueshme. Sikur jeta ime me ndonjë rast të ishte rastësi e vërtetë dhe lojë, kurse mbarimi i saj asgjë, atëherë për ç'arsye dëshpërimi, animi nga e vërteta, idealet, madje edhe me çmimin e vetë jetës.

Yjet të cilat lundrojnë shtigjeve të veta, bashkësitë jashtëzakonisht të rregulluara të bletëve dhe të buburrecave, bimët të cilat ndiejnë, morali i disa llojeve të shtazëve, truri i njeriut me fijet e veta dhjetëmilionëshe të cilat në harmoni të përkryer funksionojnë, kjo më nxiti në përsiatje për Atë i cili qëndron pas të gjitha këtyre. Hijeshia e gjethit të drunjve, e bishtit të palloit, krahut të fluturës, këndimit të bilbilit, më ka folur për Krijuesin e tyre. E kam parë rregullimin e tërësishëm të natyrës e cila e ka mohuar çdo rastësi dhe jopërcaktueshmëri.

E kam lexuar Kur'anin dhe kam mbetur i magjepsur dhe i mahnitur me melodinë e tij. Mirëpo, përveç kësaj melodie në të kam gjetur përgjigje përkatëse në pyetjet të cilat shtrohen në politikë, etikë, shariat, kozmos, jetë, shpirt, shoqëri. Fakti se Muhammedi, i cili nuk ka ditur të lexojë e as të shkruajë, ka jetuar në një mjedis të prapambetur, së bashku me të gjitha që u theksuan më lart, më ka bindur se Kur'ani është prej Zotit, kurse Muhammedi

është I dërguar i Zotit.

Pasi që me vëmendje i dëgjo i fjalët e mia, miku më tha duke e shfrytëzuar rastin e fundit të cilin e kishte:

- Unë asgjë nuk po humb, sepse e kam jetuar jetën më të fatshme dhe më të pasur. Mirëpo, nëse llogaritë e mia janë të sakta, ju do të humbni shumë, kurse llogaritë dhe shpresa ime janë të vërteta dhe juve, miku im, ju pret befasi e tmerrshme.

E shikova mikun derisa ende fliste, dhe në thellësitë e syve të tij zbulova frikë, atë frikë të rëndë nga e cila qepallat vezullojnë dhe dridhen. Edhe pse frika në sy ka shndritur vetëm një çast, ai ka qenë mjaft i gjatë të tregojë se dyshimi e ka prekur verbërinë dhe mendjemadhësinë e mikut. Me tonin të cilit orvatej t'i japë ash-përsi më tha:

- Do të shohish se toka është ajo që na pret edhe ty edhe neve.

- A je i sigurt?

Duke e fshehur dyshimin me theks të forcuar ai tha:

- Po!

- Nuk ke të drejtë - i thashë, - se në atë që ti e pohon, kurrë nuk mund të jemi të sigurt.

Duke mbetur vetëm, atë natë, pas dialogut tonë të gjatë, kam qenë i sigurt se miku im në shpirt ka lëndim. Thashë në veten time, duke u lutur për të: mbase kjo frikë do ta shpëtojë, sepse kush ia mbyll vetes me krenarinë e tij shtigjet deri te e vërteta, frika është rrugëdalje e vetme. Mirëpo, e kam ditur se përudhja nga rruga e drejtë dhe nga e vërteta nuk është në duart e mia. A nuk po i thotë Allahu xhel-le-shanuhu Të dërguarit të Tij:

“Ti, me të vërtetë, nuk do ta udhëzosh drejt atë që do ti, por Allahu e udhëzon drejt atë që do Ai...” (El-Kasas, 56).

Por, kam bërë lutje për mikun, sepse kam dëshiruar të përudhet dhe të shpëtojë nga mëkati më i madh.

Përktheu: Nexhat Ibrahimi

BIBLIOGRAFIA E SHKURTËR

Në mënyrë që libri Dialogu me mikun ateist të përcillet sa më lehtë, ju rekomandojmë leximin e veprave në gjuhën shqipe dhe serbokroate siç vijojnë:

1. Ahmed Behd`et, Allah - islamsko poimanje i vjerovanje, Sarajevo, 1987.
2. Ahmed Deedat, Kur'ani – mrekullia më e përsosur, Shkup, 1985.
3. Ahmed Hurshid, Jeta familjare në Islam, Prishtinë, 1994.
4. Ebu'l A'la El-Mewdudi, Osnovne pretpostavke za razumijevanje Kur'ana, Sarajevo, 1984.
5. Ebu'l A'la El-Mewdudi, Misioni i pejgamberisë (nga: Mebadiul-islam), Dituria islame nr. 6 e tutje.
6. Ebu'l Fajd El-Menufi, Filozofija islama, Sarajevo, 1983.
7. Ebu Hamid El-Gazali, Ballsami i lumturisë, Romë, 1959.
8. Enes Kari}, Uvod u tefsirske znanosti I, Sarajevo, 1988.
9. Fazlur Rahman, Duh Islama, Beograd, 1983.
10. Grup autorësh, Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu, Sarajevo, 1987.
11. Hi {am D`ait, Evropa i islam, Sarajevo, 1986.
12. Nedim el-D`isr, Vjerovanje u Boga u svijetlu filozofije i Kur'ana, botimi II, Sarajevo, 1984.
13. Husein Djozo, Islam u vremenu, Sarajevo, 1976.
14. Malik ibn Nebi, Kur'anski fenomen, Sarajevo, 1985.

15. Maurice Bucaille, Biblija, Kur'an i nauka, Sarajevo, 1979.
16. Muhammed Ikbāl, Obnova vjerske misli u islamu, Sarajevo, 1979.
17. Muhammed Hamidullah, Hyrje në Islam, Shkup, 1985.
18. Muhammed Hamidullah, Muhammed a.s. (I-II), botimi II, Sarajevo, 1983.
19. Mustafa Mahmud, Prej dyshimit deri në besim, Prishtinë 1987, Shkup 1995.
20. Mustafa Mahmud, Kur'an - poku{aj savremenog razumijevanja, Sarajevo, 1981.
21. Mustafa Mahmud, Allah, Sarajevo, 1980.
22. Nerkez Smailagi}, Klasi~na kultura islama, I, 1973, II, 1976, Zagreb.
23. Nerkez Smailagi}, Uvod u Kur'an, Zagreb, 1975.
24. Osman Nuri-Had`i}, Muhammed a.s. i Kur'an, botimi III, Sarajevo, 1986.
25. Ro`e Garodi, Islam, kultura i socijalizam, Sarajevo, 1981.

Përmbajtja

PARATHËNIE	3
<i>PERSONALITETI DHE VEPRA E DR. MUSTAFA MAHMUDIT</i>	3
<i>ZHVILLIMI IDEOR I DR. MUSTAFA MAHMUDIT</i>	5
“ALLAHU NUK KA LINDUR AS S'ËSHTË I LINDUR” (KUR'AN).....	11
NËSE ALLAHU I KA CAKTUAR VEPRAT E MIA, PËRSE ATËHERË MË THËRRET NË PËRGJEGJËSI?!	16
PSE ALLAHU KRIJOI TË KEQEN?	24
ÇFARË ËSHTË MËKATI I ATIJ TEK I CILI NUK KA ARRITUR KUR'ANI?	28
XHENNETI DHE XHEHENNEMI	34
A ËSHTË FEJA OPIUM?	41
QËNDRIMI I ISLAMIT NDAJ FEMRËS.....	53
SHPIRTI.....	61
NDËRGJEGJJA.....	71
A PËRMBAJNË ELEMENTE TË IDHUJTARISË CEREMONITË E HAXHXHIT?.....	75
PSE TË MOS JETË KUR'ANI VEPËR E MUHAMMEDIT?	79
KUR'ANI ËSHTË SHPALLJE E ZOTIT	95
DYSHIMET	104
QËNDRIMI ISLAM NDAJ EVOLUCIONIT	112
MAKSIMA KUR'ANORE: “LÂ ILÂHE IL-LALL-LLAH” (NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALLAHUT)	117
MBI MU'XHIZEN	121
KUPTIMI I FESË	125

NE SENDËRTOJMË FATIN E KËSAJ BOTE, NDËRSA JU SENDËRTON	
ILUZIONE	128
BIBLIOGRAFIA E SHKURTËR.....	132